


TIRANË
2019



PARLAMENTI NË KOHËN E KRIZËS

Monitorimi i Kuvendit Janar-Gusht 2019



Kingdom of the Netherlands

DEPUTETIM.al







Kingdom of the Netherlands



PARLAMENTI NË KOHËN E KRIZËS

MONITORIM, ANALIZË, PROBLEMATIKA

TIRANË

GUSHT 2019



Projekti për monitorimin e Kuvendit (shtator 2017-shtator 2020) realizohet nga Instituti i Studimeve Politike www.isp.com.al me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta. Në funksion të projektit është realizuar aplikacioni online www.deputetim.al ku reflektohen të dhënat e vazhdueshme të monitorimit. Ky është raporti i katërt i monitorimit në kuadër të projektit. Pikëpamjet e shprehura në raport janë përgjegjësi e grupit monitorues.

BOTUES

Instituti i Studimeve Politike

EKIPI REALIZUES

Drejtues i projektit

Afrim Krasniqi

Kontribues

Rudina Niklekaj

Brunilda Duriçi

Juljana Bilbilaj

Borana Elezi

Kristos Bratja

Xhovana Cenga

Elsa Kepi

Kopertina

M&P Studio

ISBN 978-9928-4418-8-1

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2019

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

web: www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë



PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. HYRJE

2. GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT

2.1 REKOMANDIMET KRYESORE

3. PARLAMENTI 2019 DHE PROBLEMATIKA TË FUNKSIONIMIT

- 3.1. DORËZIMI I MANDATEVE DHE PASOJAT
- 3.2. VENDIMARRJA POLITIKE PËR DORËZIM KOLEKTIV TË MANDATEVE
- 3.3. TRE DEPUTETËT “REBELË” DHE DEBATI MBI “OPOZITËN”
- 3.4. “PARLAMENTI I RI” – NDRYSHIMET NGA 2017 DHE GRUPET PËRBËRËSE
- 3.5. PRAKTIKA E ZËVENDËSIMIT TË DEPUTETËVE: PROCEDURË PËRKUNDREJT AKTIT POLITIK
- 3.6. PRAKTIKA E DEBATUAR E VERIFIKIMIT TË MANDATEVE NGA KUVENDI
- 3.7. RASTI “HOXHA” SI TREGUES I TRANZICIONIT PROBLEMATIK NË KUVEND
- 3.8. PESË DEPUTETË BRAKTISIN PARLAMENTIN PËR BASHKINË

4. PARLAMENTI DHE VENDIMARRJA: RISI DHE PROBLEMATIKA

- 4.1. AKTET E KUVENDIT: MË TË RËNDËSISHMET, LIGJET E REFORMËS NË DREJTËSI
- 4.2. SESIONI (I) 2019 - I NGJASHËM NË VENDIME ME PERIUdhËN E NJËJTË 2018
- 4.3. AKTET E KUVENDIT 2019: REKORD NË MUAJT PA OPOZITËN PD-LSI
- 4.4. AKTE NË PROCEDURË? 5 AKTE PRESIN PREJ VITIT 2016-2018
- 4.5. ANGAZHIMI POLITIK: MAZHORANCA RRETH 22% MË SHUMË DEBATE SE NË 2018
- 4.6. NISMAT LIGJORE, QEVERIA RUAN MONOPOLIN
- 4.7. NISMAT LIGJORE TË DEPUTETËVE ... 75% E TYRE NUK JANË TË DEPUTETËVE
- 4.8. NISMAT LIGJORE TË PD E LSI? ANULLIMI NË BLOK VS RAST PAS RASTI
- 4.9. MBLEDHJET: KOMISIONI I LIGJEVE ZË VENDIN KRYESOR
- 4.10. AKTE LIGJORE TË SHQYRTUARA NË KOMISIONE
- 4.11. KOMISIONI I POSAÇËM I REFORMËS: ROTACION KRYETARËSH, POR PA REZULTATE
- 4.12. DOMINUESE PROCEDURAT PËR EMËRIME TË DEPUTETËVE NË KOMISIONE
- 4.13. SESIONI (I) 2019: VETËM NJË MOCION ME DEBAT... DHE NGA MAZHORANCA
- 4.14. KONFLIKTI PRESIDENT – MAZHORANCË DHE NDIKIMI NË PARLAMENT
- 4.15. NISMA PËR SHKARKIMIN E PRESIDENTIT: RISI E PROBLEME
- 4.16. ZGJEDHJA E PËRFAQËSUESVE NË INSTITUCIONE: VONESA DHE PROBLEMATIKA
- 4.17. 2019: SHKARKIMI I PARË I NJË ZYRTARI PËR KONFLIKT INTERESI
- 4.18. INTERPELANCA REKORD ME QEVERINË: 14 DEPUTETË TË RINJ DHE 4 “TË VJETËR”
- 4.19. KËRKESA PËR INFORMACION: 58 KËRKESA NGA 13 DEPUTETË

5. PARLAMENTI DHE TRANSPARENCA: RISI DHE PROBLEMATIKA

- 5.1. RREGULLORJA E RE, NJË PREMTIM I MBAJTUR
- 5.2. HAPJA E KUVENDIT: RISI DHE PROBLEME
- 5.3. PROBLEMATIKA TË ADRESUARA NGA ISP NË PARLAMENT
- 5.4. RISIA E KUVENDIT: PUBLIKIMI I TË ARDHURAVE FINANCIARE PËR DEPUTETËT
- 5.5. ELEMENTE TË ZBATIMIT FORMAL TË KODIT TË SJELLJES
- 5.6. STANDARDI: NUK JANË PUBLIKUAR 29-30% E PROCESVERBALEVE TË KOMISIONEVE
- 5.7. DREJTIMI I KOMISIONEVE, RISI DHE PROBLEMATIKA
- 5.8. NËNKOMISIONET: NGA 6 TË TILLA, 3 NUK KANË AKTIVITET GJATË 2019
- 5.9. PARREGULLËSI: NË TË NJËJTËN ORË DEPUTETËT NË DY MBLEDHJE
- 5.10. HETIMET DHE PRAKTIKA E INTERESIMIT PËR DEPUTETËT
- 5.11. VETËM 17 NGA 45 DEPUTETËT E RINJ U TRAJNUAN NË KUVEND
- 5.12. RASTI PALOKA, INCIDENTI ME “BOJË” NDAJ KRYEMINISTRIT
- 5.13. TRE DEPUTETË NË REGJISTRIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT
- 5.14. BONUSI FINANCIAR, - 23 DEPUTETËT PËRFITUES PËR 2019



6. KLASIFIKIMI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE (JANAR - GUSHT 2018)

- 6.1. DEPUTETËT MË EFEKTIVË MË 2019? KRYESOJNË HYSI, MURRIZI, BEQAJ DHE HAJDARI
- 6.2. DEPUTETËT MË EFEKTIVË DHE JO EFEKTIVË: POLITIKANË APO BIZNESMENË?
- 6.3. PRURJET E REJA, DEPUTETËT QË KRYESOJNË LISTËN
- 6.4. DEPUTETËT E PD: DY DEPUTETË NDAJNË SË BASHKU KRYESIMIN
- 6.5. JASHTË PARLAMENTIT: DEPUTETËT MË AKTIVË TË OPOZITËS
- 6.6. LSI PA SURPRIZA: HIERARKIA PARTIAKE KA EFEKTIVITET MË TË LARTË
- 6.7. GRUPI “DEMOKRAT” – MURRIZI DHE HAJDARI FIGURAT DOMINUESE
- 6.8. DEPUTETËT PA GRUP PARLAMENTAR: VETËM 50% AKTIVË
- 6.9. GRUPI I “PAVARUR”: DY TË TRETAT E TYRE MBETEN AKTIVË

7. DISKUTIMET PARLAMENTARE: KLASIFIKIMI DHE OBJEKTI I LIGJËRIMIT

- 7.1. FJALIMET: DOMINUESE POLITIKA E DITËS, VETËM 23 FJALIME PËR ELEKTORATIN
- 7.2. REKORD FJALIMESH NË SEANCË, - BALLA, MURRIZI DHE DHIMA
- 7.3. DEPUTETËT QË NUK FLASIN: LISTA E PLOTË ME 22 EMRAT E “HESHTUR”
- 7.4. FJALIMET NË EMËR TË GRUPEVE, SI SPONSORIZIM POLITIK
- 7.5. GRATË DEPUTETE: 8% DERI NË 19% MË AKTIVE SE PËRQINDJA QË ZËNË NË KUVEND
- 7.6. FJALIMET PERSONALE: SUPRIZOJNË MURRIZI, DHIMA, BEQJA DHE 7 DEPUTETËT E RINJ
- 7.7. FJALIMET E PD? BASHA DHE BERISHA ISHIN FOLËSIT KRYESORË
- 7.8. GRUPI I TË DJATHTËVE: ALIMADHI E PAPA, MË TË SUKSESHMIT
- 7.9. FJALIMET E LSI: KRYESOJNË KRYEMADHI DHE VASILI
- 7.10. PRURJET E REJA, REKORD I VOTËS KONSENSUALE NË KUVEND
- 7.11. KRYEMINISTRI VOTOI VETËM 12% TË LIGJEVE TË QEVERISË SË TIJ
- 7.12. SIPAS MUAJVE: DEPUTETËT QË NUK VOTUAN ASNJË AKT PARLAMENTI
- 7.13. QEVERIA: REKORD FJALIMESH SPIROPALI E GJONAJ
- 7.14. MINISTRAT MË EFEKTIVË NË RAPORT ME AKTET LIGJORE

8. SHTOJCA ME TË DHËNA TË DETAJUARA

- 8.1. TABELA ME RENDITJEN E PLOTË DHE TË DETAJUAR MBI KLASIFIKIMIN E EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE NË SESIONIN PARLAMENTAR 2019
 - 8.2. TABELA ME RENDITJEN E PLOTË DHE TË DETAJUAR MBI KLASIFIKIMIN E EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE TË OPOZITËS QË DORËZUAN MANDATET NË SHKURT 2019
-



1. HYRJE

Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë vijon të realizojë monitorimin e Kuvendit të Shqipërisë dhe të aktivitetit parlamentar. Ky është raporti i katërt që përmbledh periudhën janar – gusht 2019. Raporti është shkruar nga 15-21 gusht 2019. Monitorimi do të vijojë edhe gjatë sesioneve të tjera deri në shtator 2020.

Instituti i Studimeve Politike ka përvojë të gjatë në proceset monitoruese të Kuvendit, pasi krahas monitorimit të aktivitetit parlamentar bën edhe monitorimin e ligjërimit politik të reformës në drejtësi si dhe monitorimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes, me fokus Konfliktin e Interesit në aktivitetin parlamentar. Bazuar në këtë përvojë, raportet tona janë të vetmet që kanë në fokus 100% parlamentin dhe përbëjnë kontribute profesionale në drejtim të rritjes së standardeve të mirë-qeverisjes, për një parlament sa më përfaqësues, transparent, efektiv dhe llogaridhënës.

ISP ka realizuar edhe platformën online të monitorimit, www.deputetim.al ku janë të pasqyruara raportet tona të monitorimit, aktiviteti parlamentar, të dhënat për deputetët, treguesit e efikasitetit të tyre, fjalimet e mbajtura dhe të dhëna të tjera specifike. Gjatë vitit 2019 vijuan të pasqyrojmë në faqen e internetit edhe të dhënat mbi deputetët e rinj që erdhën në parlament në procesin zëvendësues të deputetëve që dhanë dorëheqje nga mandati.

ISP vijon praktikën pozitive dhe sfidën profesionale të nisur më 2016 për të bërë klasifikimin e nivelit të efikasitetit të aktivitetit të deputetëve, nisur nga përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre funksionale. Klasifikimi bazohet në një metodologji të qëndrueshme dhe përfaqësuese dhe mundëson rifreskimin e të dhënave pas çdo sesioni parlamentar. Në fund të legjislaturës qytetarët do të kenë mundësi të njihen me klasifikimin e deputetëve sipas nivelit të efikasitetit të punës së tyre.

Raportet monitoruese të ISP janë pritur shumë mirë nga kryetari i Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme stafi ynë ka marrë vlerësime nga deputetë, kryetarë komisionesh apo punonjës e drejtues të administratës së Kuvendit. Raportet janë publike dhe nga pozita të tilla kanë marrë vlerësime të larta nga të gjitha institucionet kryesore ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, si dhe nga mediat kryesore në vend, të cilat u kanë dedikuar emisione të posaçme gjetjeve të tyre.

ISP falënderon të gjithë deputetët që u janë përgjigjur ftesave të ISP për monitorimin, shkëmbimin e informacioneve dhe përvojës, për sqarime dhe për pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta. Qëllimi ynë është krijimi i një sistemi vlerësimi dhe një bashkëpunimi transparent e konstruktiv, duke njohur e respektuar përgjegjësitë kushtetuese të parlamentit dhe të deputetëve, si përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve shqiptarë.

ISP do të vijojë monitorimin e Kuvendit dhe raportimin publik deri në shtator 2020. Raporti i radhës do të jetë publik në fillim të janarit 2020, si pasqyrim i punës së Kuvendit në sesionin e vjeshtës, shtator-dhjetor 2019.





1. GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIMET

- ❖ Sesion i parlamentar janar – korrik 2019 u dominua nga procesi i zëvendësimit të deputetëve të opozitës, pas vendimit kolektiv të tyre për dorëzim mandatesh. I gjithë procesi u shoqërua me protesta dhe kontestime, si dhe dobësoi ndjeshëm peshën dhe rolin e parlamentit. Dorëzimi i mandateve ishte veprim i skajshëm dhe joracional i opozitës, ndërkohë që mazhoranca përfitoi nga situata e krijuar. Dy palët nuk u investuan për asnjë moment në evitimin e krizës, secila palë u përpoq të fitojë maksimalisht prej saj.
- ❖ Kuvendi arriti të ketë 122 deputetë nga 140 në total, pasi 40 deputetë të rinj morën mandate nga lista proporcionale e opozitës. Lista proporcionale e PD u konsumua dhe personat e tjerë nuk e pranuan mandatin. Për pasojë, qarqe si Lezha apo Kukësi kanë respektivisht vetëm 57% dhe 67% të deputetëve të zgjedhur më 2017, ndërsa nga 12 qarqe, vetëm Gjirokastra, Berati e Korça kanë të njëjtin numër deputetësh në parlamentin aktual si më 2017. Në këto rrethana, debati mbi legjitimitetin dhe kapacitetin për të funksionuar mori më shumë kohë e energji sesa debati mbi axhendën parlamentare.
- ❖ Kriza politike e vazhdueshme, debati dhe protestat politike e dobësuan fuqinë dhe ndikimin e parlamentit në vendimmarrjen politike. Gjatë vitit 2019 Kuvendi nuk ka zhvilluar asnjë debat të dedikuar mbi krizën dhe rrugëzgjdhjet, por ka zgjedhur të jetë shtojcë e akteve politike që vijnë nga partitë në qeveri ose në opozitë. Dobësimi i parlamentit dhe procesi kompleks i zëvendësimit të një pjese domethënëse të deputetëve arriti të sigurojë numerikisht funksionalitet normal të parlamentit dhe shumicë absolute në votime.
- ❖ Nga deputetët e opozitës vetëm 3 deputetë refuzuan vendimin politik për dorëzimin e mandatit. Gjatë pranverës u krijuan tri grupe të reja në parlament në përpjekje të deputetëve të rinj për t'u organizuar dhe për të rritur nivelin e përfaqësimit. Pavarësisht krijimit të grupeve dhe deklarimeve publike, nuk është ende e qartë diferenca midis “mazhorancës” dhe “opozitës” dhe sa është numri i deputetëve mbështetës për qeverinë / opozitën, kryesisht për shkak të paqartësisë në qëndrimet politike dhe larmisë së bindjeve e formimit politik që përfaqësojnë prurjet e reja në Kuvend. Ardhjet e reja i dhanë legjitimitet dhe funksionalitet parlamentit, por cilësia e aktivitetit të tyre ligjor e politik ishte shumë larg nevojës përfaqësuese që ka parlamenti dhe vendi.
- ❖ Gjatë sesionit të fundit Kuvendi ishte larg të përmbushurit të funksionit kontrollues ndaj qeverisë dhe institucioneve të tjera. Të gjitha nismat e qeverisë morën lehtësisht miratimin e Kuvendit. Përpjekjet e deputetëve të rinj për të zhvilluar interpelanca, apo për të ushtruar instrumente kontrolli kushtetues, nuk patën ndikim në këtë proces. Kuvendi e mbylli sesionin duke iniciuar një proces më shumë politik sesa kushtetues për shkarkimin e Presidentit të Republikës, i pari proces i iniciuar prej vitit 1991 në Shqipëri.
- ❖ Në aspektin e miratimit të akteve Kuvendi ia arriti të ruajë nivel pothuajse të njëjtë me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Ai miratoi ligjet e fundit të paketës së reformës në drejtësi dhe



jetësoi në legjislacion vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me ligjin mbi organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë dhe për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

- ❖ Muajt me “opozitën e re” shënuan edhe numrin më të madh të akteve të Kuvendit në të gjithë sesionin parlamentar. Qeveria vijoi të ketë monopolin e inicimit të ligjeve me 87% të akteve. Aktet ligjore të propozuara nga deputetët në shumicën e tyre ishin akte *de facto* të qeverisë ose aktorëve të tjerë joparlamentarë, ndërkohë që vetëm dy deputetë iniciuan propozime konkrete për ndryshim ligji, të dy deputetë të mazhorancës. Pasi opozita u largua nga parlamenti, shumica parlamentare i konsideroi të pavlefshme të gjitha propozimet ligjore të saj ende në axhendë dhe i hoqi ato nga procesi parlamentar.
- ❖ Parlamenti miratoi më 18 korrik Rregulloren e re të Kuvendit, një zhvillim pozitiv për rritjen e funksionalitetit, transparencës dhe përgjegjësi të strukturave të Kuvendit, të grupeve parlamentare, të deputetëve dhe e të gjithë procesit ligjvënës. Rregullorja, në tërësi, reflekton ndryshime pozitive, pjesë të rëndësishme e të cilave kanë qenë produkt konsensual përpara se opozita të largohej përfundimit nga përfaqësimi parlamentar. Vetëm një pjesë e rekomandimeve të ISP dhe të shoqërisë civile janë marrë në konsideratë. Në raport citohen çështje të tjera si : procesi i zëvendësimit të mandateve, i emërimit “opozitë”, i trajtimit të nismave ligjore nga deputetë që janë larguar apo që i përkasin legjislativave të mëparshme, i praktikave të Konfliktit të Interesit, bonusi financiar, etj, , të cilat nuk kanë marrë zgjidhje të plota dhe duhet rishikuar në të ardhmen.
- ❖ Komisionet parlamentare vijuan të kenë rol të rëndësishëm në aktivitetin parlamentar. Aktiviteti i tyre shpesh u dominua nga nevoja procedurale për sigurimin e kuorumit dhe nga drejtimi i personalizuar i tyre. Në disa raste u konstatuan deputetë që “zyrtarisht” figurojnë të kenë marrë pjesë në të njëjtën ditë dhe orë në dy ose më shumë mbledhje komisionesh. Ndryshimet e vazhdueshme në përbërjen e komisioneve e dobësuan efektivitetin e aktivitetit të tyre.
- ❖ Gjatë 2019 pati vetëm dy komisione hetimore, i pari i anuluar pas ikjes së opozitës dhe i dyti i iniciuar nga mazhoranca për shkarkimin e Presidentit. Nuk pati asnjë komision të ri të posaçëm dhe Komisioni mbi Reformën Zgjedhore vijoi të mos jetë produktiv. Ndryshimi i vazhdueshëm i drejtimit dhe plotësimi me grupet e reja në parlament e vonoi jetësimin e reformës zgjedhore dhe aktualisht, në kontrast me premtimet dhe nevojat e vendit, ende nuk ka një produkt paraprak publik të tij.
- ❖ Gjysma e nën-komisioneve patën aktivitet dhe ishin aktive, ndërkohë që disa prej tyre, përfshirë nënkomisione që kanë të bëjnë me fusha të rëndësishme prioritare për vendin, sic janë pushteti vendor, administrata publike, vetingu në polici, migracioni, etj, nuk zhvilluan asnjë mbledhje, duke mbetur organizime fiktive edhe për këtë sesion parlamentar.
- ❖ Kuvendi luajti rol aktiv dhe pozitiv në procesin e seancave dëgjimore me institucionet që raportojnë, por vijoi të ketë probleme në përmbushjen e funksionit të vet zgjedhor në disa institucione, përfshirë kryetari i Bordit të Autoritetit Mbikqyrës Financiar, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, disa anëtarë të Këshillit Drejtues të TVSH, anëtarë të Bordit Drejtues të



Autoritetit të Dosjeve, anëtarë të Autoritetit të Mediave Audiovizive, etj. Shkarkimi i një zyrtari të AMA shënoi rastin e parë të shkarkimit me akuzën e konfliktit të interesit, megjithatë një praktikë emërimi ende e papërfunduar në AMF u shoqërua me akuza publike se është gjithashtu në konflikt interesi.

- ❖ Kuvendi bëri progres në respektimin e Kodit të Sjelljes, sidomos me katër deklaratimet e para në Regjistrin e Konfliktit të Interesit. Këto deklarime meritojnë vlerësim, gjithsesi i njëjti standard nuk u reflektua edhe në deklarime të njëjta në Regjistrin e Dhuratave apo në aplikimin e detyrimeve etike e formale të Kodit të Sjelljes në aktivitetin parlamentar.
- ❖ Deputetët e rinj shënuan numër rekord interpelancash ndaj ministrave dhe qeverisë, në përpjekje për të rritur imazhin e tyre publik dhe për të përfaqësuar shqetësimet qytetare. Në tërësi interpelancat u zhvilluan sipas procedurës, por nuk arritën të ofrojnë ndonjë zgjidhje efektive për problematikat mbi të cilat ato u kërkuan.
- ❖ Deputetët adresuan mbi 58 kërkesa për informacion tek institucionet ekzekutive dhe kushtetuese, një tregues pozitiv për përdorimin efektiv të kompetencave dhe të drejtave të deputetëve.
- ❖ Gjatë 2019 u konstatuan raste kur drejtues të strukturave parlamentare përdorën autoritetin e Kuvendit për të denigruar raportet kritike të ardhura nga shoqëria civile. Megjithatë, në tërësi Kuvendi bëri përpjekje të tjera në drejtim të rritjes së transparencës dhe të partneritetit me shoqërinë civile dhe publikun. Të gjitha kërkesat mbi të drejtën e informimit morën përgjigje në kohë, pavarësisht cilësisë së përgjigjeve dhe Kuvendi rriti numrin e subjekteve të ftuara për seanca dëgjimore dhe konsultime në aktivitetet e tij.
- ❖ Sistemi i transparencës që lidhet me publikimin e dokumentacionit, sidomos të procesverbaleve të seancave plenare, të komisioneve dhe të mbledhjeve të strukturave të tjera të Kuvendit, vijoi të ishte me probleme, sidomos pas largimit të opozitës nga parlamenti. Nga monitorimi rezulton se rreth 30% e procesverbaleve nuk janë publikuar ende, përfshirë mbledhje të seancave plenare dhe të komisioneve të rëndësishme.
- ❖ Kuvendi vijoi të publikojë rregullisht online të dhënat financiare të trajtimit të deputetëve, një risi e rëndësishme në kuadër të transparencës, por nuk arriti të trajtojë dhe as t'i japë zgjidhje të qëndrueshme problemeve që lidhen me përfitimet edhe abuzimet e bonusit të strehimit për deputetët, ngritur edhe në raportet e mëparshme të monitorimit të ISP.
- ❖ Klasifikimi i deputetëve sipër nivelit të efektivitetit 2019, tregon se deputetët më efektivë në këtë sesion parlamentar ishin Vasilika Hysi (PS), Myslim Murrizi (DEM), Ilir Beqaj (PS) dhe Rudina Hajdari (DEM). Në tërësi deputetët e karrierës politike patën më shumë aktivitet dhe ishin më efektivë sesa shumica e atyre që vijnë nga biznesi apo që përbëjnë prurje të reja më 2017 dhe 2019. Nga prurjet e reja ishin më aktivë Ralf Gjoni dhe Lefter Maliqi, ndërkohë që një pjesë e madhe e tyre nuk arritën të lënë gjurmë në memorien parlamentare.



- ❖ Rreth 29 akte parlamentare u miratuan me konsensus dhe 5 akte u miratuan me shumicën absolute të votave të të gjithë deputetëve, shifrat më të larta të konsensusit parlamentar prej vitit 2016 kur u miratuan ndryshimet kushtetuese për reformën në drejtësi.
- ❖ Gjatë sesionit janar - korrik 2019 pati deputetë që nuk morën pjesë në asnjë nga votimet e akteve ligjore në seancat plenare, si dhe që nuk morën pjesë në asnjë mbledhje komisioni. Gjithashtu Kryeministri nuk mori pjesë dhe për pasojë nuk votoi shumicën absolute të akteve ligjore të iniciuara nga qeveria në parlament, si dhe nuk iu përgjigj një kërkesë për interpelancë.
- ❖ Nga deputetët e opozitës që dorëzuan mandatet edhe këtë vit më të suksesshmit ishin Albana Vokshi dhe Jorida Tabaku. Zonja Tabaku edhe në aktivitetin politik të opozitës jashtë parlamentit, gjatë periudhës shkurt-gusht 2019, rezultoi se mbetet ish-deputetja më aktive edhe në aktivitetin partiak.
- ❖ Fakti se në 10 deputetët më efektivë shumica janë gra dhe në krye të deputetëve të opozitës vijnë të kryesojnë dy gra deputete është tregues domethënës i nivelit profesional të përfaqësimit të grave deputete në parlament. Gjatë deputete ishin nga 8% në 19% më shumë aktive në debatet parlamentare sesa në sesionet e kaluara të legjislaturës.
- ❖ Pavarësisht nga mungesa e opozitës efektive, mazhoranca vijoi të konsumojë një numër të madh fjalimesh, 22% më shumë sesa në të njëjtën periudhë të vitit 2018. Deputetët më me shumë fjalime në parlament ishin Balla (PS), Murrizi (DEM) dhe Dhima (PS), ndërkohë që 22 deputetë nuk patën asnjë artikulum në debatet apo seancat parlamentare.
- ❖ Ligjërimi politik në diskutimet parlamentare u dominua nga retorika e ditës dhe nga çështje procedurale. Numri i deputetëve që folën mbi probleme të zonave zgjedhore ishte minimal dhe paradoksisht një pjesë e madhe e ligjërimit në parlament iu adresua opozitës që ndodhej jashtë parlamentit, gjë që ndikoi në dobësimin e efektivitetit të debateve parlamentare.
- ❖ Nga kabineti qeveritar, ministrat më aktivë në parlament ishin Elisa Spiropali (Ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin) dhe Etilda Gjonaj (Ministre e Drejtësisë). Megjithatë, në mungesë të presionit dhe adresimit kritik nga deputetët e rinj në parlament, të gjithë ministrat u ndjenë në pozita komode dhe nuk patën raste të përballjes reale me funksionin kontrollues të parlamentit.

2.1. REKOMANDIMET KRYESORE

- ❖ Kuvendi përballlet me sfidën e rritjes së efikasitetit dhe të funksionalitetit të tij në rrethanat kur opozita më e madhe politike në vend nuk është më pjesë e jetës dhe aktivitetit parlamentar. Pa opozitën kryesore mbetet sfidë fuqia dhe potenciali real i parlamentit për të mbetur organi kryesor i vendimmarrjes politike dhe për të përmbushur përgjegjësitë kushtetuese e ligjore.



- ❖ **Kuvendi duhet të investohet më shumë në funksion të kontrollit kushtetues të institucioneve të tjera, sidomos të pushtetit ekzekutiv. Një numër aktesh të miratuara gjatë viteve nga Kuvendi ende nuk janë shoqëruar me akte nënligjore nga institucionet ekzekutive, ndaj edhe Kuvendi mund të investohet më shumë në ndjekjen e nivelit të zbatimit të ligjit.**
- ❖ **Kuvendi mund dhe duhet të shmangë përqendrimin e vendimmarrjeve të tij në një numër relativisht të vogël deputetësh, të sigurojë një proces sa më të rregullt ligjvënës dhe të nxisë mekanizmat ligjore për rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies publike.**
- ❖ **Kuvendi mund dhe duhet të investohet më shumë në jetësimin e institucioneve të reja të reformës në drejtësi, si dhe garantimin e një standardi të ri më cilësor, profesional dhe me integritet në praktikën e komisioneve hetimore, apo nismat për shkarkim të drejtuesve të lartë, përfshirë Presidentin e Republikës.**
- ❖ **Funksionimi dhe drejtimi i komisioneve të përhershme parlamentare mund e duhet të realizohet përmes standardeve më të larta të përfshirjes, profesionalizmit dhe të respektimit të mendimeve të pakicës parlamentare ose të sugjerimeve të tjera në adresë të parlamentit.**
- ❖ **Kuvendi mund e duhet të sigurojë përmbushjen e detyrimit ligjor për publikimin në kohë të të gjitha të dhënave që lidhen me aktivitetin e vet, sidomos të dokumenteve parlamentare mbi seancat dhe komisionet, mbi proceset e kandidimit dhe të zgjedhjes që burojnë nga parlamenti, si dhe mbi të dhënat financiare të vetë kuvendit dhe mbi monitorimin e kryer mbi institucionet raportuese në Kuvend.**
- ❖ **Kuvendi mund e duhet të organizojë trajnim të vazhdueshëm për deputetët, sidomos për deputetët e rinj, si dhe të reflektojë kërkesat e Kodit të Sjelljes, për parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe respektimin e tij në secilën etapë të procesit ligjvënës, përfshirë edhe në procesin e zgjedhjes dhe emërimit të funksionarëve të lartë me burim Kuvendin.**
- ❖ **Grupet parlamentare mund e duhet të kenë rregulla publike të funksionimit të tyre, të sigurojnë pjesëmarrje aktive të deputetëve në komisione dhe në seanca dhe të promovojnë zbatimin integral të parimeve dhe standardeve që burojnë nga Kodi i Sjelljes për të gjithë deputetët e tyre.**





3. PARLAMENTI 2019 DHE PROBLEMATIKA NË FUNKSIONIMIT

Viti 2019 përfaqëson më shumë sesa një sesion të ri parlamentar. Kriza politike e vitit 2019 e dobësoi rolin e Parlamentit, por nuk arriti ta zëvendësojë fuqinë dhe rolin e tij nga ndonjë institucion tjetër. Duke qenë një vit zgjedhor (zgjedhjet lokale), qeveria u angazhua për muaj me radhë në funksion të fushatës dhe paralelisht në funksion të legjitimitetit të zgjedhjeve e të institucioneve përfaqësuese pa opozitë politike.

Në këto rrethana pushteti ekzekutiv nuk arriti të përfitojë nga dobësia e parlamentit për të krijuar një pikë referimi mbi politikën. Institucionet e tjera, përfshirë edhe institucioni i Presidentit, për shkak të bazës së kufizuar kushtetuese, por edhe specifikave të presidencës aktuale, nuk mund të ishin gjithashtu pikë referimi e vendimmarrjeve politike. Në mungesë të dialogut politik dhe të ndërmjetimit për krizën, nuk pati asnjë pikë tjetër referimi mbi politikën dhe për rrjedhojë, Kuvendi, megjithë dobësitë, vijon të jetë institucioni që ka kapacitetet për të ndikuar më shumë se çdo institucion tjetër në jetën politike dhe institucionale.

BE dhe partnerët ndërkombëtarë, në kohezion me qëndrimet e mëparshme ndaj zhvillimeve në Shqipëri, i japin përparësi nevojës për stabilitet dhe funksionim të institucioneve. Në raportin e BE 2019, pasi konkludohet se bojkoti i opozitës dhe polarizimi politik çuan në vonesat në reformën zgjedhore dhe në miratimin e ndryshimeve në legjislacionin për statusin e gjykatësve dhe prokurorëve, arrihet në përfundimin se pas plotësimeve të mandateve nga KQZ, parlamenti ka arritur kuorumin dhe është funksional.

RAPORTI I BE MBI KUVENDIN

Në maj 2019 Raporti i Komisionit Evropian mbi Shqipërinë vlerëson punën e Kuvendit gjatë një viti dhe krahas vlerësimeve pozitive, siç janë rritja e transparencës publike dhe e numrit të konsultimeve me grupet e interesit, përpjekja për të mbuluar fusha specifike përmes nënkomisionesh të dedikuara, roli i strukturës parlamentare në monitorimin e raporteve vjetore dhe aktivitetit të institucioneve të pavarura, etj, nënvizon edhe elementë kritikë e sugjerime për përmirësime në të ardhmen. Të tilla janë: sugjerimet për efektivitet më të madh të komisioneve parlamentare dhe nxitjes së nismave ligjore, forcimi i komunikimit midis deputetëve dhe zgjedhësve, forcimin e kapaciteteve për mbikëqyrje dhe përfshirje në procesin e integritetit, reformimi i Rregullores së Parlamentit, dobësitë dhe polarizimi në punën e komisioneve hetimore, etj.

3.1. DORËZIMI I MANDATAVE DHE PASOJAT

Gjatë sesionit aktual zhvillimet politike jashtë parlamentit dhe polarizimi politik çuan në krijimin e një situatë të jashtëzakonshme me vendimin politik të opozitës për dorëzimin e mandateve parlamentare. Gjatë tranzicionit ka pasur raste të shumta dhe periudha të shkurtra kohore, gjatë të cilave parti të caktuara politike kanë vendosur bojkotin e përkohshëm të parlamentit edhe pas periudhës kohore 6 mujore të parashikuar në Rregullore, por asnjëherë nuk ka ndodhur që forca e dytë dhe e tretë më e madhe politike në vend të vendosë heqjen dorë nga jeta parlamentare dhe dorëzimin kolektiv të mandateve.



Procesi i dorëheqjes së opozitës nga parlamenti dhe i zëvendësimit të deputetëve me emrat pasues të listave proporcionale e dobësoi besimin publik tek parlamenti dhe zhvendosi vëmendjen nga vetë parlamenti, tek emrat dhe surprizat me ata që pranuan mandatet.

Tradicionalisht në pjesën fundore të listave proporcionale të partive politike nuk ka pasur emra të njohur dhe me përvojë politike, por kryesisht emra që plotësojnë mozaikun e përfaqësimit, kryesisht drejtues të partive të vogla, përfaqësues të komuniteteve të veçanta kulturore, përfaqësues nga krahina të papërfaqësuara, etj. Hyrja e tyre në parlament, siç ndodhi me listën e qarkut Lezhë për PS në legjislaturën e kaluar, e dëmtoi cilësinë e jetës parlamentare dhe imazhin publik për deputetin.

- Vëmendjen kryesore të debatit dhe të aktivitetit parlamentar nuk e mori më vetë axhenda e parlamentit, por debati nëse ai ka legjitimitetin e duhur për të vijuar të funksionojë dhe nëse ekziston mundësia për ta bërë funksional përmes procesit të zëvendësimit të deputetëve të larguar. Gjatë muajve shkurt-maj 2019 nuk ka asnjë ligj të rëndësishëm të kaluar në parlament, derisa procesi i zëvendësimeve përfundoi dhe mbështetja ndërkombëtare ndaj parlamentit i dha atij mundësinë të votojë tashmë me mbështetje të gjerë ligjet e fundit të paketës së reformës në drejtësi.
- Aspekti i dytë negativ në aktivitetin parlamentar u bë problematika e krijuar me protestat e opozitës dhe klima e tensionuar në mjediset e Kuvendit, sidomos në zonën e seancave plenare. Një numër incidentesh dhe roli i protestuesve apo i policisë në to, solli zëvendësimin e lajmeve mbi parlamentin me lajmet mbi gjendjen rreth parlamentit.
- Mazhoranca u sforcua ndjeshëm për të siguruar kuorumin e nevojshëm të votave për mbledhjet e komisioneve dhe seancat plenare, si dhe për të pasur një axhendë normale aktiviteti. Në këto përpjekje, ajo shpeshherë injoroi praktikën e mira parlamentare dhe procedurat e Rregullores dhe në mungesë të zërave të brendshëm kritikë, nuk kishte mekanizëm reagimi dhe reflektimi më vetë strukturat drejtuese të Kuvendit.
- Në situatën e krijuar, mungesës së opozitës reale dhe përpjekjeve për të krijuar një pakicë parlamentare me të pakënaqurit e opozitës, mazhoranca në Kuvend krijoi hapësirë për disa nga deputetët me përvojë politike të sapo hyrë në parlament ose nga ata që refuzuan dorëzimin e mandatit. Deputetët e pakicës së re u promovuan në postet drejtuese në parlament, në komisione, në delegacione dhe në strukturat e tjera parlamentare. Deputetë si Myslim Murrizi apo Rudina Hajdari, Ralf Gjoni apo Lefter Maliqi ishin mjaft aktivë në debatet parlamentare në seanca dhe në komisione, sidomos në debatet publike në media, një tregues edhe i aftësisë së tyre për të shfrytëzuar hapësirën e re të lënë bosh dhe për të përfaqësuar të papërfaqësuarit në parlament.

PASOJAT E KUVENDIT NGA KRIZA POLITIKE

Gjatë ditëve, javëve dhe muajve të parë pas dorëzimit të mandatit nga opozita dhe zhvillimit të protestave kryesisht paralel me seancat parlamentare, parlamenti pati vështirësi serioze funksionimi normal në procedurat parlamentare, në standardet e transparencës dhe në rolin e vet vendimmarrës e të kontrollit mbi pushtetet e tjera. Parlamenti u ndesh me vështirësi shumëfishe, kur protestat e opozitës dhe reagimet e autoriteteve ndaj tyre zhvendosën vëmendjen nga axhenda parlamentare dhe ndikuan në dobësimin e rolit të parlamentit si institucion kryesor vendimmarrës në sistemin qeverisës të Shqipërisë.



- Ndaj deputetëve të rinj pati një valë të skajshme sulmesh denigruese në mediat e ndryshme sociale dhe televizive, kryesisht nga mbështetësit politikë apo protagonistë të opozitës së larguar dhe të paktën dy incidente publike ndodhen ndaj dy prej këtyre deputetëve.
- Pranimi i mandateve nga një pjesë e deputetëve zëvendësues, të cilët publikisht e kishin refuzuar marrjen e mandatit (një deputet pati dhënë dorëheqje publike nga lista gjatë fushatës elektorale 2017, pesë të tjerë organizuan konferenca shtypi ose dhanë deklarata zyrtare publike në emër të partive të tyre se mbështesnin dorëzimin e mandateve, dy deputetë përfitues mbajtën fjalime publike në protestat e opozitës pas dorëzimit të mandateve duke deklaruar aty se edhe ata i bashkohen listës së refuzojnë mandatet), la shije të hidhur mbi standardet dhe vlerat që përçon politika dhe parlamenti.
- Integrimi i deputetëve të rinj në politikë u shoqërua gjithashtu me shqetësime dhe shpesh edhe me investim në dëm të imazhit të parlamentit dhe të vetë politikës. Disa deputetë nga prurjet e reja u keqpërdorën nga media dhe vetë ata preferuan të ishin viktimë e titujve kryesore në media dhe e debateve spekulative. Kjo pjesë e deputetëve demonstroi mungesë të theksuar profesionalizmi, të njohurive politike dhe të integritetit në angazhimin e ri parlamentar.
- Disa nga deputetët e rinj, sidomos në listën e atyre që pranuan mandatin në muajt mars dhe prill, megjithëse deklaruan se duan të respektojnë elektoratin dhe ta përfaqësojnë atë, pavarësisht kohës së kufizuar në dispozicion kanë një bilanc minimal pune në aktivitetin e deritanishëm, kanë nivel kritik të efikasitetit dhe nuk kanë arritur, as të iniciojnë nisma, as të ngrenë çështje që mund të kenë vleratë impakt për zgjedhësit e supozuar.

3.2. VENDIMARRJA POLITIKE PËR DORËZIM KOLEKTIV TË MANDATEVE

Praktika e bojkotit parlamentar e sesionit të kaluar shtator-dhjetor 2018 vijoi edhe në fillimin e sesionit aktual parlamentar. Pas muajit janar opozita lajmëroi zhvillimin e protestave të reja, të cilat në fazën e parë të tyre përfunduan në incidente të shumta midis protestuesve dhe policisë. Pas protestës së datës 16 shkurt 2019 u bë publike për herë të parë nisma për dorëzimin e mandateve parlamentare nga opozita. Veprimi i dorëzimit të mandateve është unik në historinë e parlamentarizmit në Shqipëri dhe krijoi gjithashtu një situatë unike në parlament dhe më pas edhe në pushtetin lokal.

Fillimisht propozimi për dorëzimin e mandateve gjeti mbështetje të gjerë tek strukturat e opozitës, të cilat mendonin se pakënaqësitë në rritje, protesta e studentëve dhe rënia e besimit publik tek parlamenti e qeveria, do të përktheheshin në mbështetje për nismën e pazakontë të opozitës. Në deklaratën zyrtare të PD për dorëzimin e mandateve thuhet midis të tjerash se *“për shkak të kapjes së kësaj qeverie në flagrancë duke vjedhur votat e qytetarëve shqiptarë, siç dëshmojnë edhe dosjet gjyqësore të publikuara nga mediat ndërkombëtare; për shkak të kapjes së kësaj qeverie në afëra flagrante korruptive dhe kriminale; të eliminimit të parlamentit si një forum i demokracisë; të eliminimit të Gjykatës Kushtetuese, etj, “vendosi unanimisht djegien e mandateve parlamentare të Partisë Demokratike në Kuvendin e dalë me votat e krimit dhe mafias në zgjedhjet e manipuluar të 25 qershorit 2017”*. Deklarata ka më shumë vlera dokumentare historike, sesa impakt politik në momentin e vendimit.



Në të njëjtën kohë, nismës së PD iu bashkuan edhe partitë e vogla aleate, PR, PAA, PBDNJ e PDK, të cilat kishin deputetë në parlament, si dhe LSI, partia e tretë e rëndësishme politike në vend. Në deklaratën zyrtare të LSI theksohej midis të tjerash se *“me shqetësimin kritik dhe në rritje për rrënimin dhe asgjësimin e funksionimit të Kuvendit, si institucioni themelor i Republikës së Shqipërisë për shkak të arrogancës dhe paligjshmërisë së mazhorancës parlamentare...duke vlerësuar të qëllimshme sjelljen e mazhorancës përpara detyrimit për të realizuar reformën zgjedhore, për të garantuar një proces zgjedhor të lirë e të ndershëm në zgjedhjet e ardhshme, demonstrimi i mungesës së plotë të vullnetit nga mazhoranca për të kthyer në normalitet ligjor dialogun politik dhe funksionimin e kuvendit, si dhe injorimi, bullizimi dhe dhunimi i opozitës parlamentare nga ana e saj...LSI vlerëson se djegia e mandateve është rruga e vetme për të rikthyer shtetin e së drejtës dhe legjitimitetin e qeverisjes përmes votës së lirë”*.

Siç shihet, në të dyja deklaratat ka referenca për parlamentin dhe jetën parlamentare, duke shprehur dukshëm qëndrime kritike për mungesën e hapësirës për opozitën, denigrimin e opozitës dhe formalizmit në vendimmarrjen parlamentare. Duket ironike, por pas dorëzimit të mandateve 58 nga 140 dhe zëvendësimit të tyre nga mandate të tjera nga listat shumëmemërore të dy partive opozitare, parlamenti ka më shumë deputetë (122), por ka vendimmarrje dhe aktivitete shumë më formal, sesa në momentin kur opozita deklaroi qëndrimin e saj akuzues ndaj formalitetit.

Vendimi i opozitës për dorëzimin e mandateve solli reagime kritike publike nga SHBA, BE, si dhe institucionet e shtetet kryesore partnere me Shqipërinë. Dalja nga institucionet në mënyrë kolektive dhe në vitin e dytë të mandatit 4-vjeçar krijon një precedent të ri në politikën shqiptare, solli dhe vijon të sjellë pasoja në të gjithë sistemin politik dhe përfaqësues.

3.3. TRE DEPUTETËT “REBELË” DHE DEBATI MBI “OPOZITËN”

Ndaj vendimit politik të PD dhe të LSI pati tri reagime përjashtimore, Rudina Hajdari e Myslim Murrizi në PD dhe Lefter Koka në LSI. Të tre deputetët deklaruan se nuk pranojnë vendimin e imponuar nga partitë e tyre, e cilësuan të gabuar dorëzimin e mandateve dhe u angazhuan të mbeten në parlament në respekt të mandatit dhe kontratës së tyre politike me zgjedhësit. Një rast të tillë të ngjashëm kemi pasur edhe më 1996 me një deputet të PS, por në secilin rast, si më 1996 dhe pas 23 vitesh partitë e tyre politike mbajtën qëndrim të ashpër, ato deklaruan përjashtimin e deputetëve nga grupi parlamentar dhe partia.

Në aspektin e institucionit të deputetit në partitë politike vlen të theksohet se në tre rastet e vitit 2019 nuk kemi mbledhje të grupeve parlamentare për të përjashtuar kolegë të tyre dhe as ftesë ndaj kolegëve për t'u dëgjuar përpara vendimit. Përjashtimi vlen nga strukturat e larta drejtuese dhe në formë ultimative, ndërkohë që referuar statuteve të partive, përjashtimet nuk duhet të vijnë nga titullarët e partive por nga Komisioni Disiplinor/Gjykata/Komisioni i Apelit. Nga komunikimi me deputetët apo partitë respektive nuk rezulton të ketë ndonjë komunikim zyrtar statutor, siç nuk ka pasur ndonjë shpresë zyrtare adresuar Kuvendit, me detyrimin, që Kuvendi të bëjë çregjistrimin e deputetëve nga partitë politike respektive. Për më tepër, nga PD e LSI pati individë që pranuan më pas mandatin e deputetit për shkak të listës shumëmemërore, por për asnjë prej tyre nuk pati më ndonjë vendim politik përjashtimi apo formë tjetër të penalizimit.



- Natyrisht që rregullimi i marrëdhënieve midis deputetëve dhe partive të tyre politike është çështje më shumë politike e partiake sesa parlamentare. Megjithatë, parlamenti do të duhej të kishte përcaktuar në Rregullore praktika standarde mbi komunikimet detyruese midis partive e deputetëve, sidomos për vendimmarrjet e njëanshme që reflektohen edhe në aktivitetin parlamentar.
- Të njëjtat praktika do të duhet të jenë të cilësuar dhe të specifikuar edhe në vlerësimin dhe rrethanat kur një deputet ose grup deputetësh quhet “mazhorancë” apo “opozitë”. Për shembull, një prej deputetëve të rinj “opozitar” në parlament në vend të mandateve të PD-së është Krenar Rryçi, i cili njëherësh si kryetar i Partisë së Reformave Demokratike ka nënshkruar në maj dhe ka marrë pjesë në zgjedhjet vendore si pjesë e koalicionit qeveritar Aleanca për Shqipërinë Evropiane. Në raste të tilla apo të ngjashme me to, “cilësimi” në bllok “opozitë e re” për deputetët që morën mandatet e opozitës për shkak se ishin pjesë e listave proporcionale të tyre më 2017, është më shumë spekulim politik sesa fakt i provuar.
- Po ashtu, vendimi i Kuvendit për të lëshuar vërtetimin që e konsideronte “Bindjen Demokratike” si parti parlamentare të mbështetur nga dy deputetë (vendim i kritikuar edhe në raportin e ODIHR mbi zgjedhjet) meriton trajtim për përmirësim në Rregullore në të ardhmen. Në thelb Kuvendi duhet të demonstrojë në raste të tilla cilësi të larta profesionale dhe të ndërmarrë akte shterruese, duke evituar krijimin e normave të reja të pashkruara apo interpretimin e debatueshëm të normave ekzistuese.


3.4. “PARLAMETI I RI” – NDRYSHIMET NGA 2017 DHE GRUPET PËRBËRËSE

“Parlamenti i ri” i vitit 2019 ka diferenca të dukshme në përbërje nga parlamenti i zgjedhur më 2017. Tabela bashkëngjitur tregon edhe ndryshimet në përbërjen reale të Kuvendit midis shtatorit 2017 dhe shtatorit 2019.

Konkretisht,

- PS ka pasur 74 deputetë dhe aktualisht ka 75, pas bashkimit me dy deputetë (një nga LSI dhe një nga PDIU) dhe përjashtimit të një deputeti nga grupi.
- PD ka pasur 45 deputetë dhe aktualisht nuk ka përfaqësim parlamentar.
- LSI ka pasur 19 deputetë dhe aktualisht nuk ka përfaqësim parlamentar.
- PDIU ka pasur 3 deputetë, 1 shkoi tek PS, dy të tjerë i shprehën mbështetjen publike PS, por nuk janë bashkuar edhe zyrtarisht me të, për pasojë, aktualisht nuk ka përfaqësim parlamentar.
- PSD vijon të ketë një deputet si në vitin 2017 edhe tani në vitin 2019.


Deputetë të tjerë që kanë ndryshuar parti janë 46 dhe janë deputetët që refuzuan urdhrin politik për dorëzimin e mandateve parlamentare ose pranuan marrjen e mandatit nga lista shumëmemërore e PD dhe



LSI. Mandate të pa konsumuara, pra bosh, janë 18 mandate nga 140 deputetë, në total 12% e të gjithë parlamentit. Debatit nëse pjesa e mbetur vakante përbën devijim nga përcaktimi kushtetues është më shumë debat politik sesa juridik. Kushtetuta dhe legjislacioni mbështetës në Shqipëri nuk përcaktojnë detyrimin për të pasur gjithnjë 140 deputetë në parlament dhe në vetë tranzicionin shqiptar ka pasur vakanca për një periudhë shumë të gjatë edhe në ndonjë legjislaturë tjetër.

Pas dorëzimit të mandateve nga partitë opozitare dhe hyrjes në parlament të disa prej deputetëve të listave të tyre shumëemërore, ka ndryshuar rrënjësisht edhe përbërja e parlamentit. Ndryshimi nuk ndodhi menjëherë, por gradualisht dhe se aktualisht pritet të ketë edhe të tjera nisma për grupime të reja në Kuvend. Le të kujtojmë se në maj Kuvendi konfirmoi se dy deputetë, Andi Përmeti dhe Lefter Koka, janë mbështetës të partisë më të re politike Bindja Demokratike.

PËRBËRJA E KUVENDIT 2017- 2019		
PARTITË POLITIKE	SHTATOR 2017	SHTATOR 2019
PS	74	75
PD	43	0
LSI	19	0
PDIU	3	0
PSD	1	1
TË TJERË	0	46
VAKANTË	0	18
TOTAL	140	122



Konkretisht, në gjendjen aktuale parlamenti përbëhet nga:

- Grupi i Partisë Socialiste me 61% të përbërjes së parlamentit me 122 deputetë. PS ka rreth 10-11% më shumë deputetë në përqindje në parlament sesa në shtator 2017 kur u zgjodhën deputetët e kësaj legjislature. Në grupin e PS vijon të jetë kryetar Taulant Balla me zëvendëskryetarë deputetët Ilir Beqaj, Elisa Spiropali, Evis Kushi e Vilma Bello.
- Grupi i dytë më i madh janë deputetët ende “pa grup” parlamentar, në total 19% e të gjithë parlamentit. Aty bëjnë pjesë edhe ishdeputetë të PDIU apo të PS, si dhe deputetë të rinj që nuk kanë ende një përcaktim mbi përkatësinë politike. Ata nuk kanë përfaqësim dhe strukturë, ndaj edhe nuk përfitojnë cilësimet dhe privilegjet e të qenit grup parlamentar.

- Grupi i tretë është Grupi “Demokrat” ku bëjnë pjesë kryesisht deputetë të PD. Në grupin “Demokrat” kryetare është Rudina Hajdari dhe zëvendëskryetarë deputetët e rinj Halil Valteri dhe Arlind Çaçani.
- Grupi i “Pavarur” përbëhet kryesisht nga disa deputetë që vijnë nga ishlista proporcionale e LSI. Në Grupin e “Pavarur” kryetar është deputeti i ri Nimet Musaj dhe zëvendëskryetar Edlira Hyseni.
- Grupi më i ri është ai i “Partive të djathta” ku bëjnë pjesë disa prej kryetarëve të partive të vogla ishaleate me PD në zgjedhjet e fundit parlamentare. Kryetar i grupit është deputeti i ri Adriatik Alimadhi dhe zëvendëskryetar deputeti Kostaq Papa.

3.5. ZËVENDËSIMI I DEPUTETËVE: PROCEDURA PERKUNDREJT AKTIT POLITIK

Pothuajse të gjithë deputetët e opozitës dorëzuan mandatet e tyre në gati të njëjtën kohë, por vendimi për secilin prej mandateve nga ana e KQZ u mor në periudha kohore të ndryshme. Shpresa e Kuvendit për shpalljen e vakancës parlamentare u bë në të njëjtën datë për të gjithë deputetët, më 25.02.2019, kurse vendimet e KQZ për shqyrtim dhe dhënie mandatesh nuk u bënë sipas të njëjtës radhë.

Shkresat me numrin e parë të protokollit nga Kuvendi lidhen me mandatet parlamentare të emrave të njohur të opozitës, si: Sali Berisha, Lulzim Basha, Edmond Spaho, Jorida Tabaku, Albana Vokshi, etj, kurse vendimet në KQZ lidhur me mandatet e tyre datojnë me diferencë të dukshme kohore, nga 11 mars 2019 deri më 8 maj 2019, ndërkohë që me prioritet u trajtuan disa prej rasteve të LSI ose të PD, ku ishte lehtësisht e pritshme pranimi i mandatit nga kandidati pasues në listën shumemërore të këtyre partive.

Kur u bë e qartë se nga lista proporcionale e LSI do të kishte plotësim të mandateve vakante apo se disa prej emrave të listës së PD do të praninin mandatin, ritmi dhe praktika e zëvendësimit u përshpejtua duke dëmtuar solemnitetin dhe transparencën e kësaj praktike unike ligjore dhe administrative.

Kapërcime të tilla, ndonëse duken procedurale dhe përdoret si argument, koha që kërkon çdo listë proporcionale për përgjigje nominale, krijon dyshime tek standardet e ndjekura, tek mbivendosja e interesit politik dhe motivimi i kandidatëve për të pranuar mandatin edhe pasi mbi 90% e tyre kishin nënshkruar më parë një deklaratë dorëheqjeje nga mandati i mundshëm parlamentar. Në këtë rast Kuvendi ishte korrekt me qëndrimin dhe korrespondencën e tij, por për të evituar praktika selektive të vendimmarrjeve të organeve të tjera që lidhen me Kuvendin, do të ishte më e dobishme krijimi i një manuali me praktika transparente dhe të standardizuara.

3.6. PRAKTIKA E DEBATUAR E VERIFIKIMIT TË MANDATEVE NGA KUVENDI

Praktika e verifikimit të mandateve u bë formalisht nga mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Që në mbledhjen e parë të Këshillit doli në pah boshllëku ligjor dhe mungesa e praktikave të njësuara për raste të zëvendësimit të një numri të madh deputetësh.

Konkretisht: Deputetët depozituan dorëheqjet në Kuvend; kuvendi informoi me shkresë KQZ për vendet vakante; KQZ vijoi me dhënien e mandatit për kandidatët vijues në listën proporcionale; vendimi kaloi në Kuvend tek Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe kjo strukturë e kaloi raportin e verifikimit të mandatit në seancën plenare, ku deputetët vijues bënë betimin.



- Së pari, vetë Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ka qenë edhe është organ i balancuar politik, ku 5 anëtarë janë nga mazhoranca dhe 5 nga opozita. Mungesa e një pale, siç ndodhi në muajt mars - prill 2019 krijon debat nëse mbledhjet kanë kuorum dhe nëse Këshilli ka fuqi të marrë vendime. Kjo çështje u diskutua edhe nga vetë 5 deputetët e mazhorancës në mbledhjen e datës 5 maj 2019, ku u pranua standardi i mosvotimit, por i kalimit të një raporti direkt në seancë.
- Së dyti, në Këshill pati edhe debate nëse deputetët e shpallur me vendim të KQZ duhej të thirreshin paraprakisht për verifikim fakti, apo të kalohej verifikimi vetëm mbi bazën e shkresës së KQZ. Këshilli u shpreh për variantin formal të verifikimit të shkresës, pra kalimit formal të shkresës në vendim parlamentar në seancë.
- Së treti, vetë Kuvendi nuk bëri asnjë verifikim ligjor dhe as procedural, nëse praktika e dorëzimit kolektiv të mandateve ishte konform ligjit dhe sesi parlamenti duhet të silltet në raste të tilla. Kalimi shkresor tek KQZ nuk përbën zgjidhje standarde dhe efektive, pasi Kuvendi është autoritet më i madh (i lartë) kushtetues e ligjor sesa KQZ, sidomos kur flitet për deputetët.
- Së fundi, praktika e dorëzimeve kolektive të mandateve krijon probleme në përcaktimin e kuorumeve në Kuvend, në seancë plenare dhe në Komisione. Kuvendi në aktet e tij nuk ka rregulla të standardizuara për raste të tilla.

3.7. RASTI “HOXHA” SI TREGUES I TRANZICIONIT PROBLEMATIK NË KUVEND

Sipas axhendës, më 8 maj 2019 do të duhej të kryhej betimi i disa deputetëve të rinj, përfshirë deputetin Indrit Hoxha, ardhur nga lista shumemërore e PD në Tiranë. Rregullorja e parlamentit parashikon se deputeti kryen betimin në seancën më të parë parlamentare, por kur Hoxha duhej të kryente betimin, ai nisi të mbajë një deklaratë politike. Përmes saj ai, pasi sulmoi ashpër mazhorancën, parlamentin, etj, deklaroi se *“refuzoj të marr mandatin në këtë parlament ilegjitim ... Ky nuk është parlament, por galeri e krimi. Fundi i kësaj farse kriminale është afër. Unë refuzoj të betohem dhe të marr mandatin e deputetit, sepse ai i takon popullit”*.

Pas deklaratës ai u largua nga salla dhe konfirmoi jashtë saj, skenarin e përgatitur më përpara për një veprim të tillë. Ndaj deklaratës pati dy reagime të kryetarit të seancës, Gramoz Ruci, fillimisht duke kujtuar praktikën e parlamentit se nuk lexohen deklarime në betim, dhe pas deklaratës, se *“ju e keni bërë kërkesën me vullnetin tuaj dhe keni kërkuar mandatin e deputetit. Pra, është e drejta juaj kushtetuese që të mos betoheni”*. Në të njëjtën seancë edhe betimi i deputetit tjetër Kujtim Gjuzi kaloi me incidente, pasi ai filloi një deklaratë tjetër politike pavarësisht se në aktin e betimit nuk lexohej deklarime të tilla.

Rasti në fjalë është një prej treguesve simbolike të problematikave me të cilat u ndesh parlamenti aktual gjatë sesionit të fundit, por mbetet si një rast unik ku një deklaram i një deputeti (i pabëtur si deputet) bëhet në seancë, publikohet në procesverbalet e seancës plenare, pra mbetet dokument publik dhe zyrtar, ndërkohë që individi nuk ishte zyrtarisht deputet pa kryer aktin e betimit.

Siç theksohet edhe në paragrafët që lidhen me praktikën e ndjekura nga parlamenti për verifikimin e mandateve të reja parlamentare, edhe në këtë rast vlen rekomandimi se Kuvendi mund e duhet të krijojë praktika pune standarde që evitojnë skena e incidente të tilla dhe që i japin aktivitetit parlamentar solemnitetin ligjor e kushtetues që meriton.



3.8. PESË DEPUTETË BRAKTISIN PARLAMENTIN PËR BASHKINË

Në zgjedhjet e fundit lokale rezultoi se pesë deputetë të mazhorancës vendosën të japin dorëheqje nga angazhimi i tyre parlamentar dhe të konkurrojnë në zgjedhjet lokale. Nga të dhënat e votimit historik në zonat ku ata kandiduan në rastin më të mirë mund të ndodhte që tre prej tyre të fitonin mandatet drejtuese lokale, por në rastin konkret, në mungesë të kandidatëve alternativë dhe të opozitës, të pesë deputetët morën mandatet e kryetarit të bashkisë. Konkretisht, Rakip Suli është kryetar në Kamëz, Pjerin Ndreu është kryetar në Lezhë, Ilir Xhakolli është kryetar në Pogradec, Nuri Belba është kryetar në Përrenjas dhe Flamur Golemi është kryetar në Gjirokastrë.

Vlen të theksohet fakti se shumica e tyre kanë pasur më parë përvojë të jetës parlamentare, pra përfaqësojnë investime të partive të tyre në politikën qendrore. Për rrjedhojë, vendimi për ndërprerjen e mandatit parlamentar dhe kalimit në pushtetin lokal lidhet më shumë me rënien e rëndësisë së pozitës së deputetit në procesin vendimmarrës dhe publik, krahasuar me kryetarët e bashkive, të cilët me ndarjen e re administrative kanë më shumë ndikim publik, ekonomik e politik sesa një deputet. Analiza e të dhënave të pesë deputetëve në angazhimin e tyre parlamentar gjatë sesionit aktual në parlament, tregon se kanë pasur koeficiente në mesatare ose nën mesataren e kolegëve të tjerë të tyre në grupin parlamentar.

Pra, në tërësi nuk kemi të bëjmë me politikanë të suksesshëm në nivelin qendror që delegohen si modele në qeverisjen vendore, sesa kemi të bëjmë me politikanë që kanë ndikim në zonat lokale ku kandidojnë dhe që ndikimi i tyre aty mund të jetë më efektiv për partinë e tyre politike, sesa pjesëmarrja e sforcuar në jetën parlamentare.

3.9. DORËZIMI I MANDATEVE DHE DORËHEQJET, 46 EMRAT E RINJ NË KUVEND

Procesi i dorëzimit të mandateve nga partitë opozitare dhe më pas edhe i dorëheqjeve të disa deputetëve që kandiduan për zgjedhjet vendore, solli ndryshime të rëndësishme në përbërjen e parlamentit. Asnjë legjislaturë tjetër parlamentare nuk ka pasur më shumë ndryshime në përbërje sesa legjislatura aktuale.

Tabela e mëposhtme paraqet emrat e deputetëve të rinj, listën proporcionale të partisë prej nga erdhën, emrat e deputetëve që zëvendësuan dhe datën e marrjes së mandatit. Nga 46 emra deputetësh të rinj, njëri prej tyre e refuzoi mandatin në momentin e betimit në Kuvend (Indrid Hoxha), por zyrtarisht mandati i tij nuk u zëvendësua për shkak të konsumimit të listës shumëmemërore. Për statistike vlen të citohet se Kostaq Papa në Tiranë ka marrë mandatin e ish-kryeministrit Sali Berisha, Majlinda Halili në Tiranë ka marrë mandatin e kryetarit të PD Lulzim Basha, Suzana Topi në Elbasan ka marrë mandatin e kryetares së LSI Monika Kryemadhi, etj. Po ashtu për statistikë vlen të shënohet se katër deputetët e parë që pranuan mandatin i përkasin listës shumëmemërore të LSI, nga lista proporcionale e PD pranuan mandatin 23 deputetë dhe nga lista proporcionale e LSI e pranuan mandatin 17 deputetë.

DEPUTETI REFUZON MANDATIN!?

Interesant është fakti se një prej deputetëve që duhej të merrte mandatin në qarkun Gjirokastrë (lista proporcionale e PS), e refuzoi atë duke preferuar të mbajë një post të lartë një prej institucioneve e ekzekutive në Tiranë. Përzgjedhja e variantit të dytë midis përfaqësimit parlamentar dhe postit ekzekutiv jo politik ngre debat mbi perceptimin që kanë vetë kandidatët për deputet për parlamentin dhe aksesin e ndikimit publik përmes tij apo pushtetit ekzekutiv.



LISTA E DEPUTETËVE “TË RINJ” QË MORËN MANDATET ZËVENDËSUESE MË 2019

NR.	EMRI / MBIEMRI	LISTA	QARKU	ZËVENDËSOI	VENDIMI	BETIMI
01	YLLI SHEHU	LSI	TIRANË	FLOIDA KERPACI	04.03.2019	05.03.2019
02	ENVER ROSHI	LSI	ELBASAN	EDMOND HAXHINASTO	04.03.2019	05.03.2019
03	AURORA MARA	LSI	DIBER	PERPARIM SPAHIU	04.03.2019	05.03.2019
04	EDMOND RRUSHI	LSI	TIRANË	ENDRIT BRAIMLLARI	04.03.2019	05.03.2019
05	LEFTER MALIQI	PD	BERAT	ASTRIT VELIAJ	11.03.2019	13.03.2019
06	ELDA HOTI	LSI	LËZHË	VIKTOR TUSHA	11.03.2019	13.03.2019
07	EDLIRA HYSANI	LSI	DURRËS	NORA MALAJ	11.03.2019	13.03.2019
08	EDIOLA BRAHA	LSI	GJIROKASTER	VANGJEL TAVO	11.03.2019	13.03.2019
09	MAJLINDA HALILAJ	PD	TIRANË	LULZIM BASHA	11.03.2019	13.03.2019
10	ALBAN ZENELI	PD	KUKËS	FLAMUR NOKA	12.03.2019	13.03.2019
11	LIGORAQ KARAMELO	PD	KORÇË	ERVIN SALIANJI	12.03.2019	13.03.2019
12	RALF GJONI	LSI	TIRANË	KLAJDA GJOSHA	20.03.2019	21.03.2019
13	NIMET MUSAJ	LSI	FIER	PETRIT VASILI	20.03.2019	21.03.2019
14	ENADA KAPLLANI	LSI	VLORË	SEZAI ROKAJ	20.03.2019	21.03.2019
15	ARBEN ELEZI	PD	ELBASAN	EDMOND SPAHO	27.03.2019	28.03.2019
16	AMRA BAROVA	LSI	SHKODER	AGRON CELA	27.03.2019	03.04.2019
17	ADRIATIK ALIMADHI	PD	VLORË	AGRON SHEHAJ	27.03.2019	28.03.2019
18	KORAB LITA	PD	TIRANË	ORJOLA PAMPURI	04.04.2019	11.04.2019
19	ARLIND ÇAÇANI	PD	KORÇË	VALENTINA DUKA	09.04.2019	11.04.2019
20	HALIL JAKIMI	PD	DIBER	DHURATA CUPI	09.04.2019	11.04.2019
21	FATJONA DHIMITRI	PD	GJIROKASTER	TRITAN SHEHU	18.04.2019	25.04.2019
22	ANDI PËRMETI	PD	KORÇË	HEKURAN HOXHALLI	18.04.2019	25.04.2019
23	EUGEN BOJAXHI	LSI	BERAT	NASIP NACO	18.04.2019	25.04.2019
24	ERJON PICIRI	PD	TIRANË	GRIDA DUMA	18.04.2019	08.05.2019
25	ARTUR RROSHI	PD	TIRANË	ALBANA VOKSHI	23.04.2019	25.04.2019
26	ZEF SHTJEFNI	PD	SHKODER	ROMEO GURAKUQI	23.04.2019	25.04.2019
27	NIKOLIN STAKA	PD	SHKODER	IZMIRA ULQINAKU	23.04.2019	25.04.2019
28	KLAJDI QAMA	LSI	BERAT	SILVI CAKA	27.04.2019	08.05.2019
29	KUJTIM GJUZI	PD	DURRËS	OERD BYLYKBASHI	07.05.2019	08.05.2019
30	KOÇI TAHIRI	PD	KORÇË	KLEVIS BALLIU	07.05.2019	08.05.2019
31	INDRIT HOXHA	PD	TIRANË	JORIDA TABAKU	07.05.2019	-
32	KRENAR RRYÇI	PD	DURRËS	FATBARDHA KADIU	08.05.2019	16.05.2019
33	KOSTAQ PAPA	PD	TIRANË	SALI BERISHA	08.05.2019	16.05.2019
34	SUZANA TOPI	LSI	ELBASAN	MONIKA KRYEMADHI	14.05.2019	16.05.2019
35	BESNIK TROPLINI	PD	TIRANË	GENT STRAZIMIRI	14.05.2019	16.05.2019
36	SELAMI JENISHEHRI	PD	TIRANË	HALIM KOSOVA	14.05.2019	16.05.2019
37	HALIT VALTERI	PD	TIRANË	FATMIR MEDIU	15.05.2019	16.05.2019
38	VASIL STERJOVSKI	LSI	KORÇË	EDMOND PANARITI	15.05.2019	16.05.2019
39	EDMOND STOJKU	LSI	TIRANË	KEJDI MEHMETAJ	15.05.2019	16.05.2019
40	FLORENC SPAHO	PS	ELBASAN	NURI BELBA	15.05.2019	16.05.2019
41	ARDIT KONOMI	PS	KORÇË	ILIR XHAKOLLI	15.05.2019	16.05.2019
42	ADRIANA JAKU	PS	LËZHË	PJERIN NDREU	15.05.2019	16.05.2019
43	ELJO HYSKO	PS	TIRANË	RAKIP SULI	15.05.2019	16.05.2019
44	ERVIS MEÇO	PD	VLORË	NADIRE MEÇORAPAJ	16.05.2019	23.05.2019
45	ARTEMIS MALO	PS	GJIROKASTER	FLAMUR GOLEMI	21.05.2019	23.05.2019
46	RAMAZAN GJUZI	LSI	TIRANË	LUAN RAMA	30.05.2019	13.06.2019



4. PARLAMENTI DHE VENDIMARRJA: RISI DHE PROBLEMATIKA

Viti 2019 nuk duhej të ishte një vit tjetër tranzicioni dhe krizash për vendin dhe institucionet, por një prej viteve të pjekurisë politike dhe të maturimit institucional. Me këtë të fundit kuptohet edhe nevoja e madhe që parlamenti të bëhet institucion i besueshëm, funksional, përfaqësues dhe sa më cilësor në ushtrimin e kompetencave dhe të përgjegjësive të veta kushtetuese dhe ligjore.

Në të dhënat e mëposhtme paraqiten bilancet e punës së parlamentit, raporti me transparencën dhe llogaridhënien, raporti me institucionet dhe me vetë funksionin e tij kryesor, miratimin e ligjeve dhe ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj ekzekutivit. Për marrjen e të dhënave kanë kontribuar i gjithë stafi monitorues i ISP në Kuvend, por gjithashtu dhe vetë Kuvendi me vendimin e vet pozitiv për të publikuar online statistika të secilit sesion parlamentar.

4.1. AKTET E KUVENDIT: MË TË RËNDËSISHMET, LIGJET E REFORMËS NË DREJTËSI

Sesioni i fundit i parlamentit ka lënë gjurmë referimi për vetëm disa prej akteve të veta, si psh, reflektimin ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese lidhur me ligjet bazë të paketës së reformës në drejtësi, si dhe miratimin e ligjeve të fundit të paketës së kësaj reforme. Me kalimin e ndryshimeve kushtetuese lidhur me ligjet organike të reformës në drejtësi, Kuvendi përmbylli detyrimin kushtetues për miratimin e të gjithë paketës së reformës në drejtësi, nisur më 2016. Procesi në Kuvend zgjati shumë më tepër sesa ishte parashikuar, me të paktën 1,5 vjet vonesë, gjë që erdhi qoftë për shkak të bojkotit politik dhe mungesës së konsensusit politik për votimet që kushtëzohen nga konsensusi, qoftë edhe për shkak të vonesave në shqyrtimin dhe kalimin e ligjeve.


Reflektimi i vendimmarrjeve të Gjykatës Kushtetuese u bë i mundur vetëm falë mbështetjes së akteve nga deputetët dhe nga grupet e reja që u krijuan në parlament me prurjet e pranverës 2019, ndërkohë që edhe disa prej ligjeve që kërkonin votë të shumicës së deputetëve morën shumë më tepër kohë sesa duhej dhe ishte parashikuar, provë tjetër e ndikimit të dy faktorëve të mësipërm.

Të gjitha aktet e tjera kanë vlerën e tyre, por nuk përbëjnë ndonjë hap të rëndësishëm drejt ndonjë reforme sektoriale apo ndryshimi në ndonjë sektor të shtetit ose shoqërisë. Për më tepër, edhe procese që duhej të kishin tashmë bilancet e veta finale, siç ishte vetingu në Policinë e Shtetit, gjatë 2019 jo vetëm që vijuan me vonesat, por parlamenti u detyrua të ndërhyjë për ndryshime në ligjin përkatës, një rast tipik i ligjeve të nxituara dhe të motivuara politikisht, ku e njëjta mazhorancë e ndryshon ligjin pa e zbatuar ende atë që kishte miratuar vetëm pak kohë më parë.

4.2. SESIONI (I) 2019 - I NGJASHËM NË VENDIME ME PERIUdhËN E NJËTË 2018

Në disa elementë të bilancit të punës së parlamentit aktual konstatohen ngjashmëri me produktin e parlamentit edhe gjatë sesionit të të njëjtës periudhë të vitit 2018. Tabela e mëposhtme ilustron përqindjet e seancave plenare në rrafsh krahasues midis dy viteve të kësaj legjislature. Gjatë 2019 u zhvilluan 24 seanca plenare, të cilat të krahasuara me sesionet e mëparshme 2017-2018 rezultojnë se zënë 29% të të gjithë numrit të seancave. Në të njëjtën periudhë të vitit 2018 kishte 30% seanca, ndërkohë që në sesionet e vjeshtës gjithnjë numri i seancave është më i vogël edhe për shkak të kohës së kufizuar 3-4 mujore.






Gjatë sesionit aktual parlamentar u morën 86 vendime në parlament ndaj 89 vendimeve të marra në të njëjtën periudhë kohore të vitit 2018. Gjithashtu gjatë sesionit të parë të vitit 2019 u realizuan 13 procese zgjedhore në parlament, numër i krahasueshëm vetëm me sesionin e vjeshtës 2018 dhe rreth 9 zgjedhje më pak sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Pjesa më e madhe e akteve që bënë diferencën midis sesionit aktual dhe sesioneve të tjera parlamentare lidhet me aktet rregullatore në Kuvend, siç janë caktim deputetësh në komisione, ndryshime në komisione, ndryshime në delegacione dhe në strukturat e parlamentit, etj, kjo nxitur edhe nga ndryshimet që ndodhën në përbërjen e parlamentit.

Konkretisht gjatë sesionit aktual 2019 u morën 47 vendime lidhur me organizimin e brendshëm të Kuvendit, 10 më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në total gjatë këtij sesioni parlamentar u miratuan rreth 173 vendime (rezoluta, vendime, organizim i brendshëm e procese zgjedhore), 3 më shumë sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, por mbi 40 vendime më shumë sesa në sesionin e vjeshtës 2018 apo rreth tre herë më shumë sesa në sesionin e vjeshtës të vitit 2017.

SESIONI	VENDIME	ZGJEDHJE	SHKARKIME	ORG.KUVENDI	REZOLUTA	TOTAL
2017 (I)	34	5	1	22	2	64
2018 (I)	89	22	0	37	22	170
2018 (II)	49	12	0	27	2	90
2019 (I)	86	13	2	47	25	173


Në aktet e Kuvendit 2019 bëjnë pjesë edhe të dhënat për mocionet, komisionet hetimore, komisionet e posaçme, nënkomisionet, etj. Referuar këtyre kategorive, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, rezulton se në vitin 2019 ka një mocion më pak, janë numra të njëjtë të komisioneve hetimore (duke mos llogaritur nismën e opozitës për rastin e MPJ, komision që nuk funksionoi asnjë ditë), gjatë 2019 nuk ka komisione të posaçme të krijuara dhe as nënkomisione të reja.



Në referimet krahasuese për mbledhjet e strukturave të Kuvendit, siç janë: Konferenca e Kryetarëve, Byroja e Kuvendit, Këshilli i Legjislacioni, (struktura këto që kanë një rol të rëndësishëm në vendimmarrjen e Kuvendit dhe në administrimin politik të aktivitetit të parlamentit), të dhënat tregojnë se 2019 kishte dukshëm më shumë mbledhje, sidomos të strukturës së Këshillit për Rregulloren. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të nevojës së Kuvendit për të trajtuar të gjitha rastet e vakancave parlamentare.

Midis periudhës shkurt dhe prill 2019 vendimmarrja në këto struktura u bë e vështirë dhe gati e pamundur për shkak të mungesës së përfaqësuesve të opozitës, por me plotësimin në muajt në vijim të vendeve me prurje nga grupet e reja parlamentare dhe deputetët e rinj, strukturat u bënë formalisht funksionale.


Një krahasim i debateve në këto struktura, sidomos në Konferencën e Kryetarëve, me periudhën e viteve 2017 dhe 2018, tregon se ka shumë më pak debate politike dhe mosmarrëveshje. Mbledhjet në tërësi trajtojnë problematika procedurale dhe se vetëm në pak raste (p.sh, Rudina Hajdari) ka kritika e kërkesa nga opozita aktuale në parlament, ose raste të veçuara (p.sh, Gramoz Ruçi – Arben Ahmetaj) ka debate midis drejtuesve të mazhorancës mbi problematika të axhendës parlamentare.



4.3. AKTET E KUVENDIT 2019: REKORD NË MUAJT PA OPOZITËN PD-LSI

Në totalin e tyre, duke hequr dekretet për shkarkim dhe emërim ministrash, Kuvendi i vitit 2019 miratoi 102 akte ndaj 88 të miratuara në të njëjtën periudhë kohore të vitit 2018. Rritja e numrit të akteve ka ardhur edhe për shkak se debati i gjatë politik dhe parlamentar i vitit 2018 është në nivele më simbolike më 2019 dhe se mazhoranca ka të gjitha votat e nevojshme për të kaluar aktet e saj pa pasur shqetësim për bllokim seance apo protestë nga deputetët e pakicës.

Nga të dhënat e vitit 2019, rezulton se Kuvendi, numrin më të madh të akteve e ka kaluar në muajin korrik dhe maj, 19 dhe 20 akte, ndërkohë që periudha e konfliktit politik me opozitën (janar dhe shkurt) ka numrin minimal të akteve të kaluara.



4.4. AKTE NË PROCEDURË? 5 AKTE PRESIN PREJ VITIT 2016-2018

Në axhendën parlamentare vijojnë të jenë në procedurë shqyrtimi të paktën 20 akte parlamentare, midis të cilave edhe nismat e fundit të qeverisë lidhur me mediat audiovizive dhe komunikimet elektronike, nisma të kritikuara gjerësisht nga shoqëria civile dhe disa organizata ndërkombëtare. Ajo që bën dukshëm dallim nga nismat e qeverisë në procedurë, janë aktet e mbetura pa shqyrtim e vendim prej vitesh.

Akti “më i vjetër” daton në qershor 2016 dhe lidhet me nismën e PS për krijimin e Institutit të Studimeve për Kujtesën e Luftës së Dytë Botërore, nismë e marrë në kuadër të nevojave politike të ditës dhe e “harruar” në parlament. Akti i dytë më i vjetër në pritje është projektligji për gjuetinë, propozuar në shtator 2017, për të vijuar më pas me një nismë ligjore mbi pronësinë (nëntor 2018), projektligji mbi censusin (dhjetor 2018) apo ndryshimet në Kodin Zgjedhor (dhjetor 2018).

4.5. ANGAZHIMI POLITIK: MAZHORANCA, 22% MË SHUMË DEBATE SE MË 2018

Në 24 seancat plenare u mbajtën 616 diskutime (sipas Kuvendit) ose 598 diskutime (sipas të dhënave të ISP). Stafi ynë konsideron diskutimet e bëra jo më shumë se njëherë nga një person për seancë dhe nuk përfshihen në to pyetje, replika të shkurtra apo ndërhyrje që nuk përbëjnë diskutim. Pavarësisht nga kriteret e ndryshme të vlerësimit të “diskutimeve” diferenca midis përfundimeve/të dhënave të ISP dhe Kuvendit është e vogël (18) dhe thelbi nuk janë numrat, por përmbajtja e tyre.

SESIONE	DISKUTIME	SEANCA - ORË	D-MAZHORANCA	D-OPOZITA
2017 (I)	684	135	285	399
2018 (I)	673	141	312	361
2018 (II)	302	66	257	45
2019 (I)	616	126	408	208


Të dhënat krahasuese midis diskutimeve në seanca në katër sesionet e fundit parlamentare tregojnë se më 2019 ka pasur një shifër relativisht të lartë diskutimesh. Numri i lartë i tyre vjen në kontrast me faktin se gjatë periudhës janar-prill opozita nuk ishte fare e pranishme ose pjesërisht e pranishme në parlament, dhe për më tepër, pas dorëzimit të mandateve prej saj, mazhorancë “diskutonte” e vetme në seancat plenare.

Si rregull më shumë se 50% e diskutimeve fokusohet në politikën e ditës, dhe kur nuk ka palë tjetër politike përballë, është e vështirë të ketë justifikim për harxhim të kaq shumë energjive për një monolog që nuk përbën debat. Përdorimi i transmetimit live në media i seancave, nevoja për të qenë sa më aktiv



midis deputetëve, liria për të folur sipas dëshirës pa patur shqetësim nga pjesa tjetër bosh e sallës, por edhe synimi për të arritur tregues sa më të lartë në numrin e fjalimeve në Kuvend janë faktorët kryesorë që kanë çuar në shifrën e mësipërme.

Kuvendi ka bërë edhe krahasimin midis mazhorancës dhe opozitës, duke arritur në përfundimin se gjatë 2019 opozita ka mbajtur 33% të kohës së diskutimeve ndaj 66% të mazhorancës. Kjo shifër, në të njëjtën periudhë kohore të vitit 2018 ishte 53% opozita ndaj 47% mazhoranca, pra ka një përmbyse totale të raporteve për shkak të mungesës së opozitës parlamentare (PD e LSI).




Vetëm për informim më teknik, seancat plenare sipas Kuvendit zgjatën 126 orë më 2019 nga 141 orë në të njëjtën periudhë kohore të vitit 2018 kur parlamenti ishte 100% funksional.

4.6. NISMAT LIGJORE, QEVERIA RUAN MONOPOLIN

Funksioni ligjvënës i Kuvendit gjatë dekadës së fundit është ushtruar kryesisht përmes dy burimeve: përmes nismave të Këshillit të Ministrave dhe përmes nismave ligjore të vetë deputetëve. Të dhënat e detajuara të nismave të vetë deputetëve dëshmojnë se shumica e tyre janë më shumë akte formale partiake sesa nisma personale, megjithatë statistikisht Kuvendi i trajton ato si merita individuale. Duke i konsideruar të tilla, në rrafshin krahasues 2017-2019 që i përket punës së Kuvendit aktual, rezulton se numri i akteve ligjore në tri sesionet e fundit parlamentare ka qenë realisht i njëjtë: 55, 58 dhe 57 akte më 2019.

Referuar raportit midis nismave të ardhura zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave dhe atyre nga deputetët, rezulton se më 2019 ka diferencë rekord për legjislaturën: 81% nga Këshilli i Ministrave dhe 19% e nismave u regjistruan nga deputetët. Ky raport në sesionin e parë të vitit 2017 ishte 92% me 8%, në sesionin e parë parlamentar të vitit 2018 ishte 96% qeveria dhe 4% deputetët, kurse në sesionin e dytë të vitit 2018 ishte 90% me 10%.



Në rrafshin krahasues, të dhënat e Kuvendit, dëshmojnë se raportet midis nismave ligjore të qeverisë dhe të deputetëve kanë mbetur në kufijtë e njëjtë me dy sesionet parlamentare të vitit 2018.

Konkretisht, nëse gjatë 2017 raporti ishte përafërsisht 60% me 40% në favor të nismave ligjore të ndërmarra nga qeveria, gjatë dy sesioneve të vitit 2018, kurse gjatë sesionit të vitit 2019 raportet janë përafërsisht 82% deri në 89% të nismave nga qeveria ndaj 11% deri në 18% nisma nga deputetët. Gjatë sesionit aktual parlamentar përqindja e nismave të ardhura nga deputetët ishte vetëm 13%, ku një përqindje i përket deputetëve që dorëzuan mandatet në shkurt 2019.

4.7. NISMAT LIGJORE TË DEPUTETËVE: 75% E TYRE NUK JANË TË DEPUTETËVE

Nga tetë (8) nisma ligjore të deputetëve në parlament gjatë periudhës janar-korrik 2019, de facto vetëm 2 janë nisma të deputetëve, 6 të tjerat janë nisma ligjore të organeve të tjera, të cilat formalisht janë iniciuar në parlament përmes nënshkrimeve të disa deputetëve.

- Konkretisht, deputeti Ilir Beqja (PS) ka propozuar nismën ligjore “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Në relacionin e tij thuhet se nisma është iniciuar “të stimulojë me fort prodhimin vendas duke e ulur më tej nga 25 lekë/kg në 10 lekë/kg, pra -60 % nivelin e taksës, si dhe të përjashtojë nga taksa një sërë lëndësh të para dhe artikuj plastikë”, të cilët përdoren në disa sektorë të industrisë. Nisma e tij ka kaluar procedurat parlamentare dhe konsiderohet e miratuar, pavarësisht raportit midis përmbajtjes së nismës dhe formës finale të saj.
- Nisma e dytë i përket kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj, “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Në relacion thuhet se deputeti propozon që shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 %, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, të

aplikohet edhe për ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike, duke siguruar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues midis ofruesve të shërbimeve audiovizive dhe elektronike. Nisma është ende në procedurë, megjithëse është ndërmarrë në shkurt 2019, rreth tre muaj përpara nismës tjetër të deputetit Beqja.

- Gjashtë nismat e tjera ligjore nga deputetët, në fakt nuk përbëjnë nisma ligjore të tyre, por vendim të tyre për të formalizuar nismat e ardhura nga institucione e drejtime të tjera. Konkretisht, gjashtë deputetë (Adnor Shameti, Myslim Murrizi, Rudina Hajdari, Alket Hyseni, Bashkim Fino dhe Ermonela Felaj) kanë ndërmarrë nismat për dy ligjet e rëndësishme, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”*, si dhe *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*. Në fakt, siç theksohet edhe në relacion, dy aktet nuk janë nisma të tyre individuale apo kolektive, por janë produkt dhe vendimmarrje të Këshillit të Legjislacionit në Kuvend. Ky i fundit ka mbajtur mbledhje në datat 19.1.2018, 30.1.2018, 6.2.2018, 13.2.2018, 27.2.2018, 14.5.2019 dhe 28.6.2019 për të shqyrtuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese që kanë krijuar vakum ligjor në paketën e ligjeve të reformës në drejtësi. Në relacion thuhet se *“në përfundim të analizës dhe diskutimeve, si dhe bazuar në opinionin e paraqitur nga ekspertët, të caktuar nga anëtarët përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare, Këshilli për Legjislacionin vendosi të ndërmarrë nismën ligjore për të bërë disa amendamente”*. Pra Këshilli vendosi, Kuvendi i përfshiu ato në rend dite dhe i kaloi me votim konsensual në maj 2019, kurse deputetët nënshkruan nga PS (4) dhe ish PD (2) janë thjesht nënshkruan formalë të kalimit të akteve në procedurën parlamentare në komision dhe në seancën plenare.
- Nisma ligjore *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”* është një nismë tjetër e mbështetur zyrtarisht nga një numër i madh deputetësh (Alket Hyseni, Spartak Braho, Elena Xhina, Jurgis Çyrbja, Ediola Braho, Aurora Mara, Bashkim Fino, Edmond Leka, Damian Gjijnuri dhe Adnor Shameti), disa prej të cilëve nuk u përfshinë në debat as në komision dhe as në seancë gjatë debatit për nismën e tyre. Ata thjesht u bënë nënshkruan, ndërkohë që nisma pati motivim politik dhe erdhi pas një debati në distancë midis deputetit Spartak Braho dhe kreut të ISKK Agron Tufa. Thelbi i nismës ishte *“për të saktësuar periudhën e regjimit komunist në Shqipëri në funksion të objektivit të ligjit si dhe për të plotësuar kriteret e nevojshme për anëtarët e Bordit dhe punonjësit e ISKK”*, nismë që *de facto* nuk ndryshon dhe as zgjidh asgjë në lidhje me problematikën e studimeve të krimeve dhe pasojave të komunizmit në Shqipëri.
- Nisma tjetër ligjore *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i RSH”, i ndryshuar”* ishte gjithashtu produkt i punës së një numri të madh institucioneve dhe ekzekutivëve. Motivimi lidhej me zhvillimet politike dhe sociale në vend, siç thuhet në relacion, *“me qëllim dënimin e çdo veprimi dhune dhe parandalimin e dhunës në shoqëri, propozohet ashpërsimi i dënimeve për veprat e dhunës ndaj policit, mjekut, sportistit, arbitrit, ndërmjetësit dhe trajnerit, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve, apo atyre që shërbejnë në shërbimin publik”*. Për nismën madje disa ministri e institucione ekzekutive zhvilluan konsulta publike me shoqërinë civile dhe strukturat e tyre, si dhe kryeministri pati takime zyrtare me drejtues të institucioneve sportive në vend. Megjithatë, nisma zyrtarisht nuk erdhi në emër të Këshillit të Ministrave (siç *de facto* është), por si nismë e një grupi të madh deputetësh, përfshirë Taulant Balla, Ulsi Manja, Blerina Gjylameti, Damian Gjijnuri, Klotilda Bushka, Ervin Bushati, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Klodjana Spahiu, Adnor Shameti dhe Alket Hyseni, ku asnjë prej tyre nuk është anëtar i Komisionit për Edukimin dhe



Mjetet e Informimit Publik, komision që mbulon edhe çështjet sportive në parlament. Interesant është fakti se nismës iu bashkua edhe propozimi i një deputeti (Ervin Bushati) *“ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë jepet nga gjykata për një kohë nga pesë deri në dhjetë vjet ndaj personit që kryen një vepër penale që cënon zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”*, propozim që u tërhoq gjatë debatit në seancë nga PS dhe për të cilën vetë *“iniciuesi”* nuk pati as ankesë dhe as diskutim.

- Nisma tjetër e debatueshme ligjore, Ligji *“Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”*, siç thuhet në relacion, *“u hartua nga grupi i punës i ngritur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe nga komisioni ad hoc i ngritur nga Asambleja e Akademisë së Shkencave”*. Megjithatë Ministria dhe as Qeveria nuk e ndërmorën vetë nismën ligjvënëse për ta paraqitur draftin final në parlament, por procesi u iniciua përmes një numri të madh deputetësh të mazhorancës (Englantina Gjermani, Anastas Angjeli, Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Andrea Marto, Elena Xhina, Vilma Bello, Besnik Baraj, Senida Mesi, Evis Kushi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Fatmir Velaj dhe Elona Hoxha), prej të cilëve vetëm deputetja Bello i përket Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, komision që mbulon edhe çështjet e arsimit dhe të shkencës. Për më tepër, në aktin zyrtar të kësaj nisme ligjore njëri prej deputetëve nuk ka nënshkruar me emrin zyrtar të tij, por me emrin që përdor në komunikimin e përditshëm, praktikë që duhet të evitohet nga parlamenti në të ardhmen, për t'i dhënë të gjithë seriozitetin që meriton akteve zyrtare të parlamentit.

Gjatë 2019 pati edhe një nismë tjetër projektligji *“Për rininë”*, iniciuar nga gjashtë deputetë të LSI përpara se kjo parti të vendoste dorëzimin e mandateve parlamentare. Edhe në këtë rast nisma vjen si inicim nga deputetët Nora Malaj, Floida Kërpaçi, Kejdi Mehmetaj, Klajda Gjoshja, Endrit Braimllari dhe Silva Caka, ndonëse në relacion pranohet se nisma është më shumë produkt i disa organizatave të shoqërisë civile.

4.8. NISMAT LIGJORE TË PD E LSI? ANULLIM NË BLOK VS RAST PAS RASTI

Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, më 26 shkurt, drejtuesja e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Milva Ekonomi ngre shqetësimin se çfarë duhet të ndodh kur në programin e komisionit janë dy nisma ligjore të LSI, madje njëra prej nismave është diskutuar ndërkohë në parim. Përgjigjia e dhënë nga kryetari i grupit parlament të PS Taulant Balla është e prerë: *“të gjitha nismat të propozuara nga deputetë që kanë dhënë dorëheqjen nga mandati nuk qëndrojnë më dhe nuk janë pjesë e punës së Kuvendit. Rregullorja e Kuvendit dhe Kushtetuta e përcaktojnë qartë që, kur propozuesi nuk është më pjesë e parlamentit të gjitha këto projekt-akte të propozuara nga deputetë që nuk e gëzojnë më mandatin e deputetit, nuk janë më pjesë e shqyrtimit të punës së komisioneve dhe seancave plenare”*. Në fakt Kushtetuta e RSH nuk ka përcaktim në lidhje me këtë tematikë, gjithashtu edhe Rregullorja e Kuvendit (në fuqi deri në korrik 2019) nuk ka një dispozitë dhe trajtim të qartë të kësaj problematike.

Kuvendi aplikoi praktikën, sipas të cilës, nismat e deputetëve që nuk janë më deputetë (PD, LSI dhe partitë e vogla aleate të tyre) hiqen automatikisht nga rendi i ditës dhe nga procedura parlamentare. Vendimi nuk është marrë në Byro, Konferencën e Kryetarëve dhe as në Këshillin për Legjislacionin, por as në seancën plenare. Në Rregulloren e re të miratuar në korrik kjo temë është trajtuar më gjerësisht për praktikën vijuese parlamentare, por deri në korrik, baza referuese paraqet disa problematika.



- E para, disa prej nismave të deputetëve të opozitës mund të kenë rëndësi për vendin, legjislacionin, politikën dhe shoqërinë, ndaj për shkak të rolit të parlamentit në vendimmarrjen politike, zgjidhje me optimale do të kishte qenë trajtimi i tyre sesa refuzimi në bllok. Argumenti se ata nuk janë më deputet mbetet relativ, përse kohë nuk janë hequr të gjitha mandatet në një ditë dhe nuk është bërë zëvendësimi i të gjithë deputetëve në të njëjtën kohë. Për më tepër, edhe nga mazhoranca ka pasur dhe ka nisma që janë iniciuar nga deputetë gjatë debateve në komisionet parlamentare, të cilët nuk janë më deputetë në momentin që trajtohen në seancë plenare. Gjithashtu ka pasur dhe ka raste kur deputetë nënshkruar të nismave të ndryshme në kuadër të grupeve parlamentare kanë ndryshuar grup, por kanë qëndruar në parlament dhe çështja është nëse firma e tyre merr vlerë juridike të njëjtë për ta mbajtur aktin në procedurë. Një debat i zhvilluar më 2009 mbi vlefshmërinë e akteve të deputetëve që nuk janë më, mazhoranca aktuale e pati vlerësuar legjitim vijueshmërinë e akteve të paraardhësve, por në një situatë të re dhe të paprecedentë si ajo që u krijua në shkurt-mars 2019 në parlamentin tonë, u mbajt një pozicion tjetër.
- E dyta, një prej akteve të iniciuara nga deputetët e opozitës (PD dhe LSI) ishin: projektligji për rininë, kërkesa për interpelancë, kërkesa për informacion apo edhe nisma për komisione hetimore. Në total ishin 7 nisma të opozitës, ku më e njohura ishte kërkesa për krijimin e një komisioni hetimor *“Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me “certifikatë të sigurisë” dhe zbatimi i ligjit për administrimin dhe përpunimin e informacioneve pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument në cilësinë e tij si zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, apo detyra të tjera shtetërore”*. Me dorëzimin e mandateve kjo kërkesë ra automatikisht dhe për rrjedhojë, objekti i hetimit mbetet pa hetim.

Kuvendi në faqen e tij zyrtare ka publikuar listën e kërkesave për informacion të deputetëve adresuar institucioneve dhe datat për përgjigjet e ardhura, ku bie në sy fakti se janë shënuar përgjigjet edhe për deputetët që nuk janë më deputetë dhe madje në data kur ish deputetët e kishin dorëzuar mandatin parlamentar. Për shembull sipas të dhënave të Kuvendit rezultoi se ishdeputetëve Tabaku, Vokshi, Salianji apo Duma u kanë ardhur përgjigje në muajin mars, kohë kur ata nuk ishin më deputetë.


4.9. MBLEDHJET: KOMISIONI I LIGJEVE ZË VENDIN KRYESOR

Komisioni i Ligjeve mban shifrën rekord të mbledhjeve të zhvilluara gjatë sesionit parlamentar 2019. Konkretisht, ky komision ka pasur 58 mbledhje, në total shumë më tepër mbledhje sesa tre komisione të tjera së bashku, siç janë politika e jashtme, integrimi dhe ekonomia. Numri i madh i mbledhjeve që zhvillon Komisioni i Ligjeve i dedikohet natyrës së komisionit dhe detyrimit që të gjitha aktet parlamentare të kalojnë përmes këtij komisioni, por edhe faktit se nismat emergjente politike të mazhorancës janë ndërmarrë përmes këtij komisioni.

Një numër relativisht të madh mbledhjesh ka edhe Komisioni për Tregtinë dhe Veprimtarinë Prodhuese, një komision i cili vazhdimisht rivalizon me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për volumin e madh të punës që kryen në parlament në të gjitha sesionet e legjislaturat parlamentare. Komisioni i tretë me më shumë mbledhje është ai i Medias dhe Mjeteve të Informimit Publik, komision që mori vëmendje të madhe kryesisht edhe për shkak të debatit disamujor për Akademinë e Shkencave dhe më parë edhe për protestat e studentëve dhe problematikat e tyre.



MBLEDHJE E KOMISIONEVE NË KUVEND 2019



4.10. AKTE LIGJORE TË SHQYRTUARA NË KOMISIONE

Të dhënat e Kuvendit për punën e komisioneve dhe vendimmarrjen e tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme. Sipas Kuvendit të gjitha komisionet kanë qenë të përfshira në procesin e diskutimit të nismave ligjore, të ndryshimeve të ndryshme në legjislacion, në vlerësimin e marrëveshjeve dhe dhënien e miratimit për ratifikimin e tyre, për vendime që lidhen me përgjegjësi të komisioneve, si dhe për procese zgjedhjesh edhe emërimesh.

KOMISIONET PARLAMENTARE	NISMA LIGJORE	NDRYSHIME NË LIGJ	MARRËVESHJE TË VOTUARA	VENDIME TË MARRA	ZGJEDHJE & EMËRIME
KOM. I LIGJEVE	13	13	16	10	2
KOM. I INTEGRIMIT	4	2	2	0	0
KOM. POL. JASHTME	1	1	16	0	0
KOM. I EKONOMISË	3	6	7	0	8
KOM. I SIGURISË	4	4	2	8	0
KOM. I TREGTISË	2	13	9	0	3
KOM. ÇESH. SOCIALE	4	3	0	0	0
KOM. I EDUKIMIT	3	2	1	8	8
TOTAL	34	44	53	26	21

Shifrat vlejshme vetëm për të kuptuar shpërndarjen e sasisë së punës në Kuvend, por jo cilësinë dhe rëndësinë e tyre. Për shembull, lidhur me ratifikimet, pothuajse të gjitha aktet e ardhura nga qeveria kanë kaluar menjëherë në Kuvend pa pasur debate politike dhe as ndryshime e diskutime. Kuvendi në këtë rast luan rolin e “noterit” dhe komisionet janë pjesë formale e këtij mekanizmi. Ndërkohë që për çështje që kanë të bëjnë me ligje të fushave specifike që mbulojnë komisionet apo me dhënien miratimi për kandidatë, zgjedhje e emërime, komisionet kanë rol të rëndësishëm dhe mund të bëjnë ndryshime dhe të marrin vendime të ndryshëm edhe nga opinioni i palës propozuese.

4.11. KOMISIONI I POSAÇËM I REFORMËS: ROTACION KRYETARËSH, POR PA REZULTATE

Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore vijoi traditën e tij negative edhe në këtë sesion parlamentar. Pas konsultimeve dhe dakordësisë midis PS e PD në periudhën e mëparshme (deri në gusht 2018), Komisioni dështoi të adresojë rekomandime dhe ndërhyrje përmirësuese në tetor-dhjetor 2018. Në janar 2019 bashkëkryetari i Komisionit, Blendi Çuçi mori funksion ministror, dhe vendin e tij më 31 janar 2019 e zuri deputetja Blerina Gjylameti, e cila qëndroi në këtë angazhim më pak se tre muaj, deri në prill 2019, pa zhvilluar asnjë mbledhje komisioni.

Më 3 prill 2019, Kuvendi mori vendim për të bërë ndryshime në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore, konkretisht, caktimin e deputetit Damian Gjijnuri bashkëkryetar të Komisionit në vend të Blerina Gjylametit dhe caktimin e kësaj të fundit anëtare në Komision. Vetëm 22 ditë më vonë, i njëjti parlament merr një vendim tjetër më të thellë, *“Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore”*, me 12 anëtarë dhe me afat deri më 28 nëntor 2019. Në vendimin e ri, u ndryshua struktura dhe përbërja e Komisionit, duke e riformatuar atë në kushtet e mungesës së opozitës kryesore në parlament, PD e LSI. Bashkëkryetare e komisionit u caktua Rudina Hajdari (grupi Demokrat). Komisioni zhvilloi vetëm dy takime, ku njëri ishte prezantues dhe ende nuk ka asnjë rezultat megjithëse mandati i tij është deri në nëntor 2019. Vlen të theksohet se në mbledhjen e dytë të zhvilluar pa praninë e medias dhe as të organizatave monitoruese të shoqërisë civile, Komisioni vendosi të zhvillojë konsultime publike dhe një tryezë të madhe debati në korrik mbi sistemin zgjedhor dhe reformën, por premtimi edhe këtë herë nuk u mbajt.

Në qershor një ndër mediat më të njohura në Gjermani, *Bild Zeitung*, dhe më pas media të tjera në Shqipëri, publikuan të dhëna nga dosja hetimore që lidhet me fushatën zgjedhore të vitit 2016 në bashkinë Dibër, në të cilat përfshihej edhe deputeti Gjijnuri, aktualisht bashkëkryetar i Komisionit të Reformës Zgjedhore. Në praktikatat e mira parlamentare në rastet e tilla deputeti vetë ose forca politike mbështetëse kërkojnë evitimin e çdo paragjykimi ndaj punës së një komisioni me kaq rëndësi në axhendën prioritarë të vendit, duke vendosur minimalisht zëvendësimin e tij nga një personalitet tjetër politik nga mazhoranca.

Vlen të theksohet gjithashtu se në vendimin e datës 25 prill 2019, Kuvendi vendosi që *“pranë Komisionit caktohet, në cilësinë e vëzhguesit, përfaqësuesi i partisë më të madhe të opozitës (PD), sipas rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, i cili gëzon të drejtat e plota që u përkasin bashkëkryetarëve të Komisionit”*. Pavarësisht qëllimit politik në praktikatat parlamentare nuk është tipike emërimi i një personi jodeputet si anëtar në një Komision Parlamentar, duke i njohur atij/asaj të drejtën e vetos. Vetë ky fakt, më shumë sesa akt bujarie ndaj opozitës jashtë parlamentit, është tregues i dobësisë së vetë parlamentit dhe i pranimit të faktit se një reformë elektorale nuk mund të realizohet nga brenda parlamentit edhe kur në përbërje të tij janë më shumë se 120 deputetë.



4.12. DOMINUESE PROCEDURAT PËR EMËRIME TË DEPUTETËVE NË KOMISIONE

Zgjedhja e deputetëve të rinj dhe zgjatja e procesit të zëvendësimit të tyre rreth 3 muaj çoi në detyrimin e parlamentit për të ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme përbërjet e komisioneve parlamentare. Në disa raste u ndryshuan edhe drejtuesit e Komisioneve, në funksion të raporteve të deputetëve brenda grupit parlamentar të PS ose krijimit të grupeve të reja parlamentare në Kuvend. Ajo që përbën risi nga praktikat e mira parlamentare është ndryshimi deri në 2-3 herë nga deputetë të veçantë i anëtarësisë në Komisione të Përherëshme parlamentare brenda një kohe jo më të gjatë sesa 2-3 mujore.

Ndryshime të tilla jo vetëm se dobësojnë vetë Komisionet parlamentare dhe cilësinë në trajtimin e axhendës së tyre të punës, por edhe mund të jenë tregues të pasigurisë së deputetëve të veçantë për angazhime në komisione apo i interesave jo politike të ndonjë prej tyre për t'u angazhuar në komisione të veçanta.

2019: REKORD LINDJESH “NË PARLAMENT”

Katër deputete kanë lindur fëmijë gjatë 7 muajve të fundit të sesionit parlamentar 2019. Dy prej tyre janë ish-deputete pasi dorëzuan mandatet parlamentare në shkurt (Jorida Tabaku dhe Klajda Gjasha), si dhe dy janë deputete të reja në parlament (Enada Kapllani dhe Elda Hoti). Ky është një lajm i gëzueshëm, i veçantë dhe që meriton urimet më të mira për fëmijët e lindur dhe prindërit e tyre.

- Më 16 maj Kuvendi vendosi të pranojë grupin “Demokrat” si opozitë parlamentare dhe sipas Rregullores, të zgjedhë deputetin Myslim Murrizi si zëvendëskryetar i Kuvendit dhe deputetin Alban Zeneli si Sekretar për Buxhetin. Gjithashtu në këtë datë Kuvendi caktoi deputeten Rudina Hajdari si kryetare në Komisionin për Integrimin Evropian, deputeten Fatjona Dhimitri si Kryetare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, deputetin Enver Roshi si kryetar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, deputetin Alban Zeneli zëvendëskryetar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, deputetin Halil Jakimi zëvendëskryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, deputetin Korab Lita si zëvendëskryetar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe deputetin Ralf Gjoni si zëvendëskryetar në Komisionin për Politikën e Jashtme. Po ashtu pati pesë emërime të tjera në anëtarësi në Komisione, përfshirë edhe caktimin e tre deputetëve të “opozitës” së re në nënkomisionin parlamentar “Për ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
- Më 30 maj Kuvendi bëri 8 emërime në Komisione ose nën Komisione nga deputetët e rinj në parlament, më 23 maj Kuvendi vendosi 17 emërime si anëtarë të rregullt të deputetëve të rinj në Komisione, në disa raste edhe ikje nga një komision dhe emërim në një tjetër, si dhe të paktën 9 emërime si anëtarë zëvendësues në komisione.
- Më 20 qershor Kuvendi cakton dy deputetë të rinj në Komisione dhe tre deputetë zëvendësues në komisione nga radhët e deputetëve të grupit “Demokrat”, si dhe zëvendëskryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave po nga ky grup. Vendimi më i Kuvendit për ndryshime në komisionet



parlamentare daton më 18 korrik 2019, kur tre deputetë të rinj, Staka, Topi e Gjuzi emërohen në Komisione të reja, dy të parët duke ndryshuar anëtarësinë në një komision tjetër të mëparshëm.

4.13. SESIONI (I) 2019: VETËM NJË MOCION, AI VJEN NGA MAZHORANCA

Gjatë sesionit të fundit parlamentar pati vetëm një kërkesë për mocion me debat, ajo lidhur me dekretin e Presidentit të Republikës mbi zgjedhjet lokale. Si rregull mocionet me debat iniciohen nga opozitat parlamentare, por në rastin konkret kemi një situatë konflikti në hirarkinë e pushtetit. Nisma u motivua në debatin politik konfliktual midis mazhorancës dhe Presidentit dhe është një prej instrumenteve kushtetuese dhe ligjore që ka në kompetencë një grup i caktuar deputetësh.

Në dallim nga praktikat e mëparshme të mocioneve me debat në këtë rast debati ishte thujse “pa debat”, për shkak se të gjithë deputetët ishin në pozita thujse të njëjta ndaj Presidentit, përfshirë edhe deputetët që nuk përfaqësojnë PS-në në parlament. Më shumë se dakordësi për vlerën dhe natyrën e aktit, kjo tregon për një situatë të re në parlament, ku pjesa opozitare e konsideron opozitën jashtë parlamentit, përfshirë edhe ish-forcën politike të Presidentit, si jolegjitime, ndërkohë që edhe Presidenti, përmes deklarimeve publike të përsëritura e ka cilësuar si jolegjitime plotësimin e parlamentit me deputetët e rinj.

4.14. KONFLIKTI PRESIDENT – MAZHORANCË DHE NDIKIMI NË PARLAMENT

Raportet institucionale dhe më pas edhe personale midis Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit, për rrjedhje edhe të kabinetit qeveritar dhe mazhorancës në parlament, kanë njohur përshkallëzim atipik gjatë këtij sesioni parlamentar. Pothuajse të gjithë presidentët pas miratimit të Kushtetutës më 1998 kanë pasur konflikte të ndryshme politike dhe mosmarrëveshje me mazhorancat, sidomos kur kryeministrat dhe partitë e tyre kanë kontrollin e plotë të qeverisë dhe të parlamentit. E njëjta situatë u përsërit edhe në rastin aktual, por me tri ndryshime të rëndësishme.

- E para, viti 2019 filloi me vendimin e Presidentit për të mos dekretuar Ministrin e ri të Jashtëm, konflikt që më pas u zgjidh përmes një formule të sforcuar dhe marrjes së postit nga kryeministri dhe kalimin e kandidatit për ministër si ushtrues të detyrës së MPJ.
- E dyta, viti 2019 shënoi debat institucional dhe më pas përshkallëzim institucional të konfliktit President – Parlament mbi çështjet e legjitimitetit dhe kushtetueshmërisë. Presidenti mendon se zëvendësimet e deputetëve të opozitës e kanë çenuar legjitimitetin e parlamentit dhe për pasojë kanë krijuar edhe një parlament të një partie politike. Parlamenti mendon se Presidenti ka çenuar limitet kushtetuese dhe duke përdorur argumentin e dekretit të tij për anulimin e zgjedhjeve lokale, ka nisur tashmë procedurën hetimore për iniciimin e shkarkimit të tij.
- E treta, asnjë president më parë nuk ka vendosur të kthejë kaq shumë ligje brenda një sesioni parlamentar, sa Presidenti aktual. Janë 13 ligje (tabela bashkëngjitur) të kthyera nga Presidenti. Një pjesë e tyre kanë dukshëm elementë të cënimit të parimeve kushtetuese apo dobësi të tjera që mund ta bëjnë ligjin të nevojshëm për rishikim, por në tërësi është krijuar perceptimi se Presidenti e ka ushtruar në formë të zgjeruar të drejtën e kthimit të ligjeve dhe nga ana tjetër, parlamenti pa



opozitë reale konkurruese, e ka ushtruar gjithashtu në formë të zgjeruar të drejtën e vet për miratimin e ligjeve dhe sidomos edhe për votimin ose jo të dekreteve të kthyer të Presidentit.

Ky konflikt, i cili pritet të përshkallëzohet më tej gjatë sesionit të vjeshtës 2019, ka ndikuar në dobësimin e integritetit dhe funksionimit kushtetues të tri institucioneve, të Presidentit, të Parlamentit dhe të Qeverisë. Mungesa e Gjykatës Kushtetuese ka shërbyer si katalizator për thellimin e krizës dhe se në tërësi janë dobësuar besimi publik tek institucionet, demokracia funksionale dhe kapacitet e elitës politike për të krijuar standarde reale për shtetin e së drejtës.

NUMRI	LIGJET E KTHYERA NGA PRESIDENTI NË KUVEND (JANAR-GUSHT 2019)
01	KTHIMIN E LIGJIT NR. 111/2018 “PËR KADASTRËN”
02	KTHIMIN E LIGJIT NR. 110/2018 “PËR NOTERINË”
03	KTHIMIN E LIGJIT NR. 20/2019 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 12/2018, “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME”.
04	KTHIMIN E LIGJIT NR. 26/2019 “PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT”
05	KTHIMIN E LIGJIT NR. 53/2019 “PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”
06	KTHIMIN E LIGJIT NR. 51/2019 “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PPP NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, SI AUTORITETI KONTRAKTOR, DHE “GJIKURIA”, SH.P.K., SI KONCESIONARI, DHE SHOQËRISË KONCESIONARE “RRUGA ORIKUM - LLOGARA”, SH.P.K., PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E RRUGËS
07	KTHIMIN E LIGJIT NR. 52/2019 “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PPP NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, SI AUTORITETI KONTRAKTOR, SHOQËRISË “ANK”, SH.P.K., SI KONCESIONARI, DHE SHOQËRISË “BARDH KONSTRUKSION”, SH.P.K., SI SHOQËRIA KONCESIONARE, PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E SEGMENTIT
08	KTHIMIN E LIGJIT NR. 50/2019 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 125/2013, “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”, TË NDRYSHUAR”
09	KTHIMIN E LIGJIT NR. 44/2019 ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, ‘KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”
10	KTHIMIN E LIGJIT NR. 42/2019 ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 107/2014 “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR”
11	KTHIMIN E LIGJIT NR. 36/2019 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9900, DATË 10.4.2008, “PËR REZERVAT MATERIALE TË SHTETIT”
12	KTHIMIN E LIGJIT NR. 38/2019 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”
13	KTHIMIN E LIGJIT NR. 37/2019 “PËR DISA SHTESA NË AKTIN NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 4, DATË 9.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PRIVATIZIMIN DHE DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE TREGTARE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE TË NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË VEÇANTA



4.15. NISMA PËR SHKARKIMIN E PRESIDENTIT: RISI E PROBLEME

Kuvendi gjatë periudhës qershor – korrik 2019 ndërmori nismën e Komisionit Hetimor për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Nisma është unike në historinë e parlamentarizmit në Shqipëri dhe për këtë fakt me rëndësi historike, meritonte të kishte të gjithë solemnitetin dhe integritetin e duhur në elementët përbërës, paraqitjen e nismës, trajtimin e problematikës, verifikimin e fakteve, respektin institucional, vetëpërbajtjen dhe evitimin e praktikave të konfliktit të interesit apo të abuzimit në emër të shumicës. Risia e nismës nuk është akti vetë, por edhe fakti se Presidenti, i cili është në fokus të procesit për shkarkim, e ka mirëpritur nismën në kuptimin se është i ndërgjegjshëm se Parlamenti, në mungesë të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka fuqi kushtetuese të bëjë shkarkimin real të Presidentit.

Nga ana tjetër, një analizë e detajuar e ecurisë së procesit të deritanishëm tregon se shumica e elementëve që lidhen me solemnitetin dhe integritetin e procesit nuk janë respektuar. Një numër deputetësh të mazhorancës paraqitën nismën për ngritjen e komisionit hetimor, ku njëri prej nënshkruesve ishte njëherësh edhe relator në Komisionin e Ligjeve, dhe ku disa prej nënshkruesve ishin njëherësh edhe votues në Komisionin e Ligjeve në vendimmarrjen për nismën e tyre. Nga deklaratat politike paraprake vendimmarrja u bë fakt i kryer dhe e gjithë procedura kaloi me një formalitet të skajshëm, shpesh edhe me elementë të mungesës së respektit institucional si nga ana e parlamentit ashtu edhe nga ana e Presidentit.

Më 8 korrik Kuvendi miratoi edhe Komisionin Hetimor, të përbërë nga 9 deputetë, nga të cilët, të gjithë deputetët e kanë deklaruar paraprakisht votën dhe qëndrimin e tyre, kështu që elementi “hetimor” përbën më shumë një procedurë teknike parlamentare, sesa një proces serioz hetimi dhe vlerësimi. Për efekt dokumentimi si rast unik, komisioni hetimor përbëhet nga deputetët Ulsi Manja (kryetar), Alban Zeneli (zv/kryetar) si dhe anëtarët Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Adriatik Alimadhi, Halit Valteri dhe Krenar Rryçi. Anëtarë zëvendësues janë deputetë Adnor Shameti, Spartak Braho, Arlind Çaçani dhe Zef Shtjefni.

Në komision u përfshinë kështu të paktën 4 deputetë, të cilët kanë vetëm 1-3 muaj përvojë në jetën parlamentare dhe politike, një vendim proceduralisht i rregullt, por nën standardin e një akti serioz parlamentar në nismën për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Referuar edhe praktikave të ngjashme në vende të tjera mund të evitohet përfshirja e deputetëve që nuk kanë bazë të fortë të njohurive ligjore dhe politike, por edhe e deputetëve që e kanë iniciuar apriori shkarkimin më parë ose që bëjnë pjesë në kryesinë vendimmarrëse të Kuvendit.

4.16. ZGJEDHJA E PËRFAQËSUEVE NË INSTITUCIONE: VONESA DHE PROBLEMATIKA

Një prej funksioneve klasike të parlamentit është edhe zgjedhje e organeve kushtetuese dhe institucionale me burim parlamentin, drejtues apo anëtarë të enteve të ndryshme. Parimisht përfundimi i mandatit të një autoriteti të zgjedhor shoqërohet me dorëzimin e mandatit tek pasuesi i tij/i saj duke nënkuptuar ruajtjen e vazhdimësisë institucionale dhe eliminimin e çdo hendeku kohor në procesin e zëvendësimit.

- Nga të dhënat e aktivitetit parlamentar 2019, rezulton se për pjesën më të madhe të zyrtarëve që duhet të zgjidhen nga parlamenti procesi zgjedhor përgjithësisht ka respektuar afatet, por gjithsesi, ekzistojnë edhe emërime të cilat ose nuk janë bërë ose janë trajtuar jashtë prioriteteve të axhendës



parlamentare. Për shembull, prej muajit dhjetor 2018 organi i Kontrollit të Lartë të Shtetit vijon të jetë pa Kryetar të ri të zgjedhur. Presidenti ka propozuar dy kandidatë (Vitore Tusha dhe Bahri Shaqiri), të dy janë rrëzuar nga Kuvendi dhe që nga janari 2019 deri në korrik 2019 nuk pati asnjë përpjekje të Kuvendit për të nxitur Presidentin ose për një bashkëpunim institucional për zgjedhjen e kreut pasues në KLSH. Në korrik Presidenti ka propozuar një kandidat tjetër (Petraq Milo) dhe Parlamenti pritet të marrë një vendim mbi të në rastin më të mirë në muajin shtator, pra rreth 10 muaj pas mbarimit të mandatit të drejtuesit aktual.

- Gjatë sesionit parlamentar pati raste kur zgjedhja e funksionarëve të ndryshëm nuk u bë sipas të njëjtave standarde dhe se njohjet dhe preferencat personale të kryetarëve të komisioneve ndikuan në dobësimin e konkurrencës dhe të integritetit të procesit të zgjedhjes. Tipik për këtë ishte rasti i Komisionit të Ekonomisë dhe Komisionit të Ligjeve.
- Parlamenti vonoi ndjeshëm në procedura dhe afate për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Drejtues në TVSH, në zgjedhjen e Bordit dhe kryetarit të AMF, si dhe më shumë se një vit në zgjedhjen e një anëtari në Autoritetin e Dosjeve.
- Vonesa kanë argumente të ndryshme, për anëtarët e Këshillit Drejtues të TVSH Kuvendi nuk arriti të ketë një qëndrim për kandidatët që janë propozuar më parë nga opozita tashmë jashtë parlamentit, për AMF ka pasur deklarime dhe akuza për konflikt interesi, ndërsa për Autoritetin nuk ka një artikullim të qartë të arsyeve të vonesës.
- Për disa prej tyre ka pasur edhe procese përzgjedhëse, por që nuk janë përfunduar në vendimmarrje finale. Për shembull, në shkurt 2019, vetëm dy javë përpara vendimit të opozitës për dorëzimin e mandateve Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik mbajti seancë dëgjimore me kandidatët për KD të RTSH dhe në fund me votim u miratuan tre kandidatë, Besnik Mustafaj, Edmond Tullumani dhe Helidon Haliti. Megjithatë ata nuk janë zgjedhur ende në seancën plenare, ndërkohë që në total, 6 anëtarëve të KD u ka mbaruar mandati prej shumë muajsh.

Pavarësisht se vendet vakante të paplotësuara nga parlamenti nuk kanë të njëjtën rëndësi dhe ndonjë prej tyre mund të mos ketë ndikim të madh në ecurinë e punës në institucionin përkatës, fakti se parlamenti nuk ka përmbushur detyrimet e tij edhe në rrethanat e mungesës së opozitës dhe të ekzistencës së mazhorancës së nevojshme parlamentare për çdo votim, është tregues i mbivendosjes së interesave të tjera mbi axhendën parlamentare dhe në rastin më të mirë, duke injoruar fuqinë kushtetuese të Kuvendit.

RASTI “MALAJ” – NISMË MË SHUMË POLITIKE SESA LIGJORE

Në fundin e sesionit parlamentar mazhoranca ndërmori nismën ligjore për shkarkimin e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të BSH me pretendimin se përmes deklarimeve publike ka mbajtur qëndrime politike që dëmtojnë BSH dhe cënojnë besimin publik. Nisma erdhi pas një konflikti mediatik midis zotit Malaj dhe kryetarit të bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, si dhe deklarimeve të tij lidhur me gjendjen ekonomike në vend. Praktika ligjore kërkon që nisma të vijë nga Këshilli Mbikqyrës i BSH, ndaj nisma e mazhorancës politike mund e duhet të lexohet më shumë si një nismë politike për shkak të gjendjes në PS, sesa një akt ligjor e parlamentar për shkak të gjendjes në Bankën e Shqipërisë. Me ndërhyrjen e kryetarit të Kuvendit shqyrtimi i nismës u shty për sesionin tjetër parlamentar.



4.17. MË 2019: SHKARKIMI I PARË I NJË ZYRTARI PËR KONFLIKT INTERESI


Në korrik 2019 Kuvendi për herë të parë shkarkoi një zyrtar të zgjedhur prej tij (anëtar i AMA) me akuzën e konfliktit të interesit. Vendimi i komisionit përgjegjës ishte marrë në dhjetor 2018, por procesi i kalimit të vendimit të Komisionit në seancë plenare zgjati shumë më tepër sesa ndodh normalisht në raste të njëjta. Fillimisht në seancat e para të shkurtit dhe marsit 2019 u deklarua se vendimi do të shtyhej për shkak se kandidatura i përkiste propozimeve të opozitës tashmë pa përfaqësues në parlament, por në korrik, në rrethana të reja politike, parlamenti e përfshiu në axhendë dhe mori vendimin e shkarkimit.

Vendimi pati kontestim nga gjysma e anëtarëve të AMA dhe grupe interesi, si komente të ndryshme për interesa politike apo mungesë transparence, - një çështje që mund të sqarohet edhe në të ardhmen nga të interesuarit.

Duke qënë zyrtar i zgjedhur me propozim nga opozita, tashmë jashtë parlamentit (LSI) u konsiderua i lehtë shkarkimi tij, gjë që zakonisht nuk ndodh më të zgjedhurit e vetë mazhorancës. Pavarësisht nga interpretimet, vendimi ka vlerë të shihet edhe në një këndvështrim tjetër, me këtë vendim parlamenti “shkeli” në një rrugë të re të paaplikuar më parë, shkarkimet e zyrtarëve të zgjedhur prej tij për konflikt interesi.

4.18. INTERPELANCA REKORD ME QEVERINË: 14 DEPUTETË TË RINJ DHE 4 “TË VJETËR”

Instrumenti i interpelancës është një prej mekanizmave përmes të cilave Kuvendi kontrollon pushtetin ekzekutiv. Nisma për interpelancë është e drejtë e çdo deputeti dhe detyrimi i ministrave për përgjigje është detyrim për qeverinë. Gjatë vitit 2019 u shënuan 6 interpelanca, të kërkuara nga 18 deputetë, por në 22 nënshkrime (disa deputetë ishin iniciues të interpelancave të ndryshme). Prej tyre vetëm një interpelancë i përket deputetëve që dorëzuan mandatet në shkurt 2019, dhe se vetëm një prej gjashtë interpelancave nuk është zhvilluar ende (me kryeministrin), madje për shkak të objektit tashmë të konsumuar ajo mund të mos zhvillohet asnjëherë.



Ajo që dukshëm bie në sy është nisma e 18 deputetëve midis të cilëve edhe 3 deputetëve (Rudina Hajdari, Myslim Murrizi dhe Lefter Koka), të cilët refuzuan dorëzimin e mandateve parlamentare, si dhe e 14 deputetëve të “rinj”, një tregues i përpjekjeve të këtyre deputetëve për të krijuar një profil të ri politik dhe publik.

Nga ana tjetër mazhoranca (me përjashtim të kryeministrit) u tregua e gatshme t’u përgjigjet në kohë interpelancave, pasi interesi i saj kryesor lidhej me nevojën për të krijuar idenë e debatit pluralist dhe e hapësirës demokratike për opozitën e re në parlament.

Konkretisht, nismat, adresimi dhe objekti i interpelancave ishte:

- Në fillim të muajit shkurt kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, zhvilloi interpelancë me ministren e re të Financave dhe Ekonomisë, Anila Demaj. Objekt i interpelancës ishte një problematikë e krijuar me thesarin e shtetit dhe veprimtarinë financiare të bashkisë Skrapar, të drejtuar në atë kohë nga LSI.
- Një numër i madh deputetësh iu bashkuan në prill 2019 nismës për interpelancë urgjente me Ministrin e Brendshëm z. Sander Lleshaj. Problematika e nismës lidhej me ngjarjen e rëndë kriminale të ndodhur në aeroportin e Rinasit më 9 prill 2019. Relatorë të nismës ishin deputetët Myslim Murrizi dhe Ralf Gjoni.
- Në të njëjtën kohë deputeti Lefter Maliqi inicioi një interpelancë me Ministren e Drejtësisë Etilda Gjonaj lidhur me sistemin penitenciar (burgjeve).
- Në maj deputeti Artur Roshi kërkoi interpelancë me Ministren e Infrastrukturës dhe Energjetikës Belinda Balluku lidhur me politikat dhe strategjinë e konçensioneve të rrugëve dhe të hidrocentraleve.
- Në qershor deputeti Lefter Maliqi kërkoi interpelancë me kryeministrin Edi Rama me objekt “lidhur me situatën e rëndë politike, ekonomike dhe të sigurisë publike, emërimet nepotike, shantazhimet në administratë dhe korrupsionin në vend, zgjedhjet e 30 qershorit dhe pasojat e një përplasje të mundshme civile, përgjegjësitë e këtij procesi i cili mund të pasohet me viktima”.

DEPUTETËT QË ZHVILLUAN INTERPELANCA GJATË 2019

1	ALBAN ZENELI	MINISTRIA E ARSIMIT
	ANDI PERMETI	MINISTRIA E ARSIMIT
	ARBEN ELEZI	MINISTRIA E ARSIMIT
	ARTUR ROSHI	MINISTRIA E ARSIMIT
	BESNIK TROPLINI	MINISTRIA E ARSIMIT
	EUGEN BOJAXHIU	MINISTRIA E ARSIMIT
	VASIL STERJOVSKI	MINISTRIA E ARSIMIT
	2	LEFTER MALIQI
3		LEFTER MALIQI
4	ARTUR ROSHI	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
5	EDIOLA BRAHA	MINISTRIA E BRENDSHME
	EDLIRA HYSENI	MINISTRIA E BRENDSHME
	LEFTER KOKA	MINISTRIA E BRENDSHME
	MYSLIM MURRIZI	MINISTRIA E BRENDSHME
	RALF GJONI	MINISTRIA E BRENDSHME
	RUDINA HAJDARI	MINISTRIA E BRENDSHME
	YLLI SHEHU	MINISTRIA E BRENDSHME
	HALIL JAKINI	MINISTRIA E BRENDSHME
	ARBEN ELEZI	MINISTRIA E BRENDSHME
	NIMET MUSAJ	MINISTRIA E BRENDSHME
6	LEFTER MALIQI	MINISTRIA E BRENDSHME
	PETRIT VASILI	MINISTRIA E FINANCAVE



- Në korrik 2019 shtatë deputetë kërkuan interpelancë me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Besa Shahini lidhur me problematikave përcaktimit të kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidateve në programet e studimeve universitare.

Lidhur me interpelancat, më 2019 bëhet dallim i madh nga praktika e viteve të mëparshme, pasi nëse më 2017 të gjitha interpelancat u kërkuan nga mazhoranca dhe më 2018 ka pasur gjithashtu ndërthurje midis kërkesave të mazhorancës e të opozitës, më 2019 ato janë kërkuar nga deputetët e opozitës.

4.19. KËRKESA PËR INFORMACION: 58 KËRKESA NGA 13 DEPUTETË

Të dhënat zyrtare të parlamentit referuar vetëm periudhës 1 janar – 2 maj 2019, tregojnë se gjatë këtij sesioni është rritur numri i deputetëve që kanë adresuar kërkesa për informacion në institucione të ndryshme, duke shfrytëzuar një prej mekanizmave të tjerë të kontrollit të Kuvendit mbi pushtetin ekzekutiv dhe institucionet e varësisë.

Sipas të dhënave, Albana Vokshi (PD) dhe Jorida Tabaku (PD) vijojnë prej disa sesionesh të jenë deputetët me numrin më të madh të kërkesave për informacion.

Në të njëjtin nivel me kërkesa është edhe deputetja Vasilika Hysi (PS), gjithashtu me vlerësime të njëjta pozitive edhe në sesionet e kaluara parlamentare. Tri deputetët së bashku kanë 33 nga 58 kërkesat e adresuar nga deputetët.

Në listë bëjnë pjesë edhe deputetë të tjerë të PD e LSI që kanë dorëzuar mandatet në muajin shkurt, siç janë Grida Duma me 9 kërkesa, Ervin Salianji me 5 kërkesa, Endri Hasa me 2 kërkesa, Xhemal Gjunkshi, Klevis Balliu dhe Endrit Braimllari me nga një kërkesë për informacion.

Nga deputetët e mazhorancës kërkesa për informacion kanë adresuar edhe deputetët Taulant Balla, Antoneta Dhima dhe Eglantina Gjermeni.

KËRKESAT PËR INFORMACION

NR	EMRI DHE MBIEMRI	NUMRI
01	ALBANA VOKSHI	13
02	JORIDA TABAKU	10
03	VASILIKA HYSI	10
04	GRIDA DUMA	9
05	ERVIN SALIANJI	5
06	ERMONELA FELAJ	3
07	ENDRI HASA	2
08	XHEMAL GJUNKSHI	1
09	TAULANT BALLA	1
10	ENDRIT BRAIMLLARI	1
11	KLEVIS BALLIU	1
12	ANTONETA DHIMA	1
13	EGLANTINA GJERMENI	1



5. PARLAMENTI DHE TRANSPARENCA: RISI DHE PROBLEMATIKA

Aktiviteti parlamentar nuk merr vlerë vetëm në vendimmarrjet e tij, por edhe në detyrimin kushtetues e ligjor për të përmbushur standardet e transparencës dhe kështu, për të investuar në krijimin e besimit publik. Programi i transparencës është tashmë një detyrim ligjor për çdo institucion dhe Parlament, si institucioni kryesor politik, ka edhe përgjegjësi të dyfishta për të përçuar nivel më të lartë transparence dhe llogaridhënie në aktivitetin e tij.

5.1. RREGULLORJA E RE, NJË PREMTIM I MBAJTUR

Vendimi më i rëndësishëm i Kuvendit në aspektin organizativ gjatë 2019 ishte miratimi në korrik 2019 i ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit. Procesi i rishikimit pati nisur shumë kohë më parë dhe në konsensus midis dy grupeve më të mëdha politike, PS dhe PD. Për shkak të zhvillimeve konfliktuale politike 2018 dhe 2019, procesi konsensual mbeti i papërfunduar dhe për rrjedhojë, në rrethanat e reja të parlamentit aktual, mazhoranca vendosi kalimin e draftit të ndryshimeve në seancë plenare.

Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e re të Kuvendit i jep përgjigje një numri të madh shqetësimesh që vinin nga partnerët ndërkombëtarë përfshirë raporti i progresit i BE për Shqipërinë, por edhe nga organizata vendore që janë të fokusuar tek parlamenti, përfshirë ISP.

Ndër risitë kryesore të Rregullores së re janë:

- përcaktimin më të qartë të konceptit të veprimtarisë parlamentare ;
- përcaktimin e një kalendari të ri të punimeve në seanca plenare, duke i dedikuar një ditë në muaj problematikave në zonat elektorale ;
- detyrimin e komisioneve në të gjitha nivelet për të prezantuar raporte vjetore për aktivitetin e tyre ;
- përcaktimi më i qartë i kompetencave dhe praktikave të punës në strukturat e Kuvendit ;
- praktika më të qarta për formimet e grupeve parlamentare dhe të drejtave të tyre ;
- përcaktime më të qarta për rastet e kuorumit dhe vendimmarrjen ;
- përcaktime më të qarta për praktikat e dhënies së autorizimit për deputetët nën hetim/ndalim ;
- përcaktime më të qarta të procedurave për detyrimet e Kuvendit në kuadër të integritetit ;
- përcaktime më të qarta për aplikimin integral të Kodit të Sjelljes dhe Konfliktit të Interesit ;

Rregullorja e re përmbush një premtim dhe përgjegjësi të Kuvendit, megjithatë edhe në variantin final të miratimit, sipas mendimit të ekspertëve tanë, ka elementë që nuk janë trajtuar në formë shteruese ose janë evituar nga debati në komisionin përgjegjës.

Të tilla janë edhe rekomandimet e papërfshira:

- për evitimin e praktikës së gabuar të pozitës së mundshme të konfliktit të interesit kur të njëjtët deputetë janë iniciues, relatorë, gjygues dhe vendimmarrës për nismat e tyre;
- për vendosjen e mekanizmave realë e funksionalë për aplikimin integral të Kodit të Sjelljes;
- për rishikim të konceptit “zonë elektorale/zgjedhore” ndërkohë që me sistemin aktual deputetët i kanë ndryshuar zonat e tyre edhe brenda legjislaturës, në varësi nga vendimmarrja e partisë së tyre politike;



- për dhënien fund të praktikës së abuzimit me bonusin financiar të strehimit nga disa deputetë;
- për mekanizma më funksionalë të Kuvendit në ushtrimin e kompetencës së tij për kontrollin e pushtetit ekzekutiv,
- si dhe për rritjen reale të transparencës dhe aksesit të publikut dhe shoqërisë civile në aktivitetin dhe vendimmarrjet parlamentare.

5.2. HAPJA E KUVENDIT: RISI DHE PROBLEME

Gjatë vitit 2019 Kuvendi shënoi progres në disa elementë të transparencës dhe të reflektimit ndaj raporteve monitoruese të shoqërisë civile apo kërkesave të kësaj të fundit drejt një standardi më të lartë të efikasitetit të punës së tij.

- ❖ praktika e Regjistrimit të Lobimit në parlament është një element pozitiv dhe risi ;
- ❖ praktika e deklarimit të Konfliktit të Interesit është gjithashtu risi dhe zhvillim pozitiv;
- ❖ praktika e tërheqjes së mazhorancës nga ndonjë nismë ligjore të kritikuar nga grupet civile është gjithashtu risi dhe zhvillim pozitiv ;
- ❖ praktika e trajtimit të rekomandimeve të ardhura nga shoqëria civile është risi dhe zhvillim pozitiv ;
- ❖ përpjekja për më shumë transparencë në deklaratimet financiare të parlamentit është zhvillim pozitiv ;
- ❖ përdorimi i një kanali televiziv të dedikuar nga TVSH është zhvillim pozitiv ;
- ❖ investimi në sistemin elektronik dhe avancimin e teknologjisë në parlament është zhvillim pozitiv ;
- ❖ rritja e numrit të vizitave të deputetëve dhe komisioneve në institucionet që monitoron Kuvendi është zhvillim pozitiv ;
- ❖ një sërë projektesh ndërkombëtare për forcimin e kapacitetit të Kuvendit janë gjithashtu zhvillim pozitiv ;
- ❖ pjesa më e madhe e ndryshimeve në Rregullore mbeten zhvillim pozitiv, etj.

Megjithatë, krahas risive dhe zhvillimeve pozitive, Kuvendi vijoi të shfaqë edhe elementë të sjelljes jotransparente, të arrogancës dhe të përpjekjeve për të ushtruar presion politik ndaj kritikave të ardhura nga raportime të ndryshme të shoqërisë civile.

- Instituti i Studimeve Politike ishte një prej rasteve kur Kuvendi edhe në rrugë zyrtare përdori fuqinë e vet politike dhe kushtetuese për të ushtruar presion dhe denigruar raportet kritike të ardhura nga shoqëria civile.
- Një prej komunikimeve të Kuvendit në mbështetje të një shkrese të Komisionit të Ligjeve mbetet rasti më flagrant dhe një tregues i qartë i sjelljeve, i gjuhës denigruese, i qëndrimeve dhe i kërkesave që reflektojnë standarde e mentalitete të një kohe tjetër nga ajo e një sistemi të hapur, demokratik dhe të shtetit të së drejtës.
- Në këtë rast stafi monitorues i ISP u vu nën presion të madh nga Kuvendi dhe pati vështirësi në realizimin e detyrës së vet monitoruese, megjithatë, falë përvojës profesionale por edhe bashkëpunimit institucional në tërësi të Kuvendit, ky moment negativ për raportet e Kuvendit ndaj shoqërisë civile u tejkalua përkohësisht.

Stafi ynë ka marrë të dhëna se në legjislaturën e kaluar dhe atë aktuale edhe organizata të tjera kanë pasur përvojë të njëjtë në rastet e raporteve kritike ndaj Kuvendit.



- Duke i ruajtur të drejtën secilit burim informues të japë vetë vlerësimin e tij për përvojën e bashkëpunimit, ISP ka bindjen se përvoja të tilla janë pjesë e një klime dhe panorame të përgjithshme që tregon se në tërësi sistemi i transparencës, i llogaridhënies dhe i hapjes së Kuvendit vijon të jetë i paplotë, i brishtë dhe i ndërvarur nga influencat politike të grupeve, segmenteve apo individëve me pushtet në parlament dhe në strukturën mbështetëse të tij.
- Praktika tregon se kur kritikët janë institucionale dhe lidhen me standardet ka një prirje kolektive të pranimit të tyre, por kur kritikët prekin interesa të caktuara, sidomos të individëve me pushtet partiak dhe parlamentar, prej tyre ka përpjekje jo vetëm refuzimi por edhe denigrimi pa argument të raporteve kritike, si dhe për më tepër, për përdorim të Kuvendit si mbështetës të kësaj sjelljeje jo normale.

FATMIR XHAFAJ

8 maj 2019

Kuvendi ka rolin e vet në këtë reformë pasi ai ka detyrimin e koordinimit dhe kontrollit përkatës në kufijtë e parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi. Komisioni (Komisioni i Pavarur për koordinimin dhe ndjekjen e zbatimit të reformës në drejtësi, shënimi ynë), i ngritur për këtë qëllim pranë Kuvendit, si një mekanizëm për ta lehtësuar këtë proces dhe për ta ruajtur atë nga ndikimet e jashtme, në vlerësimin tim duhet konsideruar një zgjidhje e dështuar, si për sa i përket autoritetit, ashtu edhe aftësisë së tij për ta përmbushur këtë mision të vështirë.

Gjithsesi duke tejkaluar raste si ai i mësipërmi dhe duke i parë ato si pjesë të procesit të maturimit institucional në Shqipëri, ISP vlerëson se gjatë vitit 2017-2020 ka pasur në tërësi raporte pozitive bashkëpunimi me Kuvendin, sidomos me kabinetin e Kryetarit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe zëvendeskryetarin e Kuvendit.

Raportet tona janë vlerësuar dhe mirëpritur përmes konfirmimeve zyrtare dhe përmes vlerësimeve dhe në takimet zyrtare, si dhe misioni ynë është konsideruar në tërësi si një prej përgjegjësive profesionale që kryen çdo organizatë e shoqërisë civile në një vend demokratik në monitorimin e parlamenteve.

5.3. PROBLEMATIKA TË ADRESUARA NGA ISP NË PARLAMENT

Gjatë vitit 2019 ISP ka adresuar disa kërkesa dhe rekomandime në parlament, si dhe ka bërë disa deklarata publike lidhur me zhvillimet në parlament. Ndër më të rëndësishmet dhe që marrin vlerë në një raport të tillë informativ dhe analitik janë:

- Vlerësimi pozitiv për deklaratimet e katër deputetëve në Regjistrin e Konfliktit të Interesit, praktikë që aplikohet për herë të parë dhe që përbën një standard të ri pas miratimit të Kodit të Sjelljes.
- Shqetësimi dhe rekomandimet përkatëse lidhur me faktin se psh, në rastin e nismës për hetimin e Presidentit, disa prej deputetëve janë njëherësh iniciues të nismës ligjore, janë caktuar relator të nismës në Komision, janë njëherësh vendimmarrës e gjykues për nismën e tyre në komision dhe në seancë, një sistem që krijon pikëpyetje mbi standardet etike apo të konfliktit të interesit dhe që sipas ISP bën të nevojshme ndërhyrjet plotësuese në bazën ligjore mbi të cilat funksionojnë komisionet parlamentare, komisionet hetimore dhe praktikët vendimmarrës në parlament. Kuvendi iu përgjigj në tërësi rekomandimeve të ISP, por nga varianti final i Rregullores, ekspertët tanë mendojnë se ende kjo problematikë nuk ka marrë zgjidhjen e duhur.



- Shqetësimi dhe rekomandimet që disa deputetë, sidomos kur janë kryetarë të komisioneve parlamentare, të mos jenë njëherësh edhe drejtues të mbledhjeve ku gjykohen nismat ligjore apo propozimet e paraqitura prej tyre nga pozitat e mëparshme të ministrit.
- Shqetësimi dhe rekomandimi që, sidomos në rastet e komisioneve hetimore, parlamenti të nxisë deputetët, të mos bëjnë konkluzionet e hetimit pa filluar hetimin, por t'i japin integritet procesit legjislativ dhe kompetencës kushtetuese të komisioneve hetimore, në mënyrë që produkti kushtetues e ligjor të ketë legjitimitetin e nevojshëm.
- Shqetësimi dhe rekomandimi që deputetë me rekorde negative, përfshirë emra që janë në blacklist të SHBA me akuza publike nga ana e tyre, apo që janë në proces hetimi nga Prokuroria, të mos jenë anëtarë e pjesëmarrës në komisione që monitorojnë prokurorinë dhe organet e sigurisë dhe ku këto organe raportojnë aktivitetet vjetore.
- Shqetësimi dhe rekomandimi që Kuvendi të ushtrojë monitorim dhe të garantojë transparencë ndaj rasteve të supozuara të konfliktit të interesit apo të vendimeve jotransparente të ndërmarra nga strukturat e tjera të ngritura nga Kuvendi dhe në varësi të tij.
- Shqetësimi dhe rekomandimi që të monitorohen, të nxiten dhe të mbahen premtimet e deklaruara sidomos nga komisione të posaçme, lidhur me afate për reforma që bëjnë pjesë në prioritetet e Shqipërisë në raport me procesin integruar.
- Rekomandime të ndryshme adresuar komisioneve në parlament, sidomos komisioneve të posaçme, që lidhen me ndërhyrje përmirësuese në legjislacionin mbi partitë politike, mbi zgjedhjet, mbi burimet shtetërore në fushatë elektorale, mbi Konfliktin e Interesit, mbi Kodin e Sjelljes, etj.

Për këto dhe tematika të tjera, ISP ka marrë nga Kuvendi dy përgjigje : një sugjerim që raporti ynë monitorues të konsultohet paraprakisht me Kuvendin përpara publikimit, si dhe një letër informuese përmes të cilës sqarohen ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit në raport me sugjerimet dhe rekomandimet e paraqitura nga Instituti i Studimeve Politike.

5.4. RISIA E KUVENDIT: PUBLIKIMI I TË ARDHURAVE FINANCIARE PËR DEPUTETËT

Kuvendi vijoi edhe gjatë 2019 të publikojë rregullisht të ardhurat përfituese financiare të deputetëve në faqen e vet të internetit. Ky është një zhvillim pozitiv, pavarësisht se interpretimi i të ardhurave shpesh është keqpërdorur nga lajmet e ndryshme në media dhe se nuk ka pasur analiza reale e profesionale mbi piramidën e pagesave dhe përfitimeve në strukturën shtetërore, ku bëjnë pjesë edhe deputetët.

Në disa mbledhje komisionesh në Parlament, me të drejtë, është ngritur shqetësimi se disa institucione të reja apo të pavarura kanë trajtim financiar shumë më të lartë sesa deputetët, duke disbalancuar piramidën e pagave dhe të meritave, por as parlamenti dhe as qeveria nuk kanë paraqitur ende një material analizues të situatës dhe me propozime të mundshme për ndërhyrje përmirësuese.



5.5. ELEMENTË TË ZBATIMIT FORMAL TË KODIT TË SJELLJES

Kodi i Sjelljes parashikon që deputetët, përveç detyrimeve që burojnë nga Konflikti i Interesit apo deklarime të tjera të dhuratave, përfitimeve, etj, përcakton edhe norma sjelljeve të deputetëve në mjediset parlamentare dhe në aktivitetin parlamentar. Me gjithë përmirësimet në rritje nga praktikat e viteve të kaluara, ende një numër deputetësh, përfshirë deputetët e rinj, vijojnë të paraqiten në Kuvend me elementë që vijnë në kundërshtim me Kodin e Sjelljes (veshja, përdorimi i telefonit, gjuha e komunikimit, respekti i procedurave, etj).

5.6. STANDARDI: NUK JANË PUBLIKUAR 29-30% E PROCESVERBALEVE TË KOMISIONEVE

Neni 39 i Rregullores përcakton detyrimin që procesverbali i përmbledhur i Komisioneve të paraqitet në mbledhjen më të parë pasardhëse të komisionit dhe që në çdo rast procesverbalet e përmbledhura të mbledhjes së komisioneve, me përjashtim të atyre që përmbajnë informacion të klasifikuar sekret shtetëror, bëhen publike dhe u shpërndahen përfaqësuesve të medias ose personave të tjerë. Kuvendi e realizon këtë përmes faqes së vet online.

Për shkaqe të ndryshme objektive (personeli i kufizuar dhe volumi i madh i punës, lejet vjetore apo arsye të tjera administrative), por mund të ndodh që edhe për shkaqe subjektive, si shmangia nga transparenca dhe debati publik që mund të shkaktohet nga të dhënat e debateve që kanë ndjesi publike, stafi monitorues i ISP ka konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e mbledhjeve të Komisioneve parlamentare të këtij sesi nuk janë bërë publike. Data e fundit e verifikuar në faqen e Kuvendit është 23 gusht 2019. Konkretisht nuk janë bërë publike 29-30% e procesverbaleve të komisioneve të përhershme në Kuvend dhe në total. Tabela bashkëngjitur e ilustron gjendjen e transparencës mbi këto mbledhje.

BILANCI I (MOS)PUBLIKIMEVE TË PROCESVERBALEVE TË KUVENDIT (20.08.2019)			
KOMISIONET DHE STRUKTURAT	MBLEDHJE KOMISIONI	PROCESVERBALE TË PUBLIKUARA	PROCESVERBALE TË PA PUBLIKUARA
KOMISIONI I LIGJEVE+ AP+DNJ	60	41	19
KOMISIONI PËR TREGTINË +VP+M	38	31	7
KOMISIONI PËR EDUKIMIN + MIP	31	24	7
KOMISIONI PËR PUNËN, + ÇS+SH	30	18	12
KOMISIONI PËR SIGURINË	33	21	12
KOMISIONI PËR EKONOMINË + F	29	24	5
KOMISIONI PËR INTEGRIMIN	14	4	10
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME	13	12	1
NËN/KOMISIONE NË KUVEND	8	6	2
SEANCAT PLENARE	28	24	4

Siç shihet nga të dhënat, për shkak se duhet miratimi i procesverbalit të fundit në mbledhjen më të parë të komisionit, atëherë supozohet se 8 procesverbale do të duhet të publikohen javën e parë të shtatorit,



kur rimblidhen komisionet. Megjithatë, në respekt të transparencës dhe standardeve të përcaktuar nga Rregullorja e Kuvendit, ia vlen të theksohet se tek Komisioni i Ligjeve mungojnë 19 procesverbale, tek Komisionet e Punës dhe atë për Sigurinë mungojnë nga 12 procesverbale, tek Komisioni për Integrimin mungojnë 10 procesverbale, nga 7 procesverbale mungojnë tek Komisionet e Tregtisë dhe të Edukimit, 5 tek Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, si dhe vetëm 1 procesverbal (miratohet në shtator) tek Komisioni i Politikës së Jashtme. Po ashtu mungojnë edhe një pjesë e procesverbaleve të seancave plenare, konkretisht katër seanca të periudhës qershor-korrik 2019, si dhe disa dokumente me vlerë të posaçme publike, përfshirë mbledhjet e strukturës parlamentare që koordinon proceset e integritit evropian.

Standardi i munguar i publikimit të procesverbaleve reflektohet edhe në disa struktura të tjera vendimmarrëse të Kuvendit. Nga tabela me të dhëna rezulton se dy struktura, Konferenca e Kryetarëve dhe Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin kanë publikuar 100% të dokumentacionit mbi debatet në mbledhjet e tyre, por për shembull, nuk është publikuar asnjë material prej katër mbledhjeve të Byrosë së Kuvendit dhe të paktën një material nga mbledhja e Këshillit për Legjislacionin.

BILANCI I PUBLIKIMEVE TË PROCESVERBALEVE TË STRUKTURAVE TË KUVENDIT (20.08.2019)			
STRUKTURAT E KUVENDIT	MBLEDHJE	PROCESVERBALE TË PUBLIKUARA	PROCESVERBALE TË PA PUBLIKUARA
KËSHILLI PËR LEGJISLACIONIN	2	1	1
BYROJA E KUVENDIT	4	0	4
KONFERENCA E KRYETARËVE	11	11	0
KOMISIONI I POSAÇËM PËR REFORMËN ZGJEDHORE	2	2	0
KËSHILLI PËR RREGULLOREN, MANDATET DHE IMUNITETIN	12	12	0

5.7. DREJTIMI I KOMISIONEVE, RISI DHE PROBLEMATIKA

Kryetarët e Komisioneve Parlamentare janë figura politike dhe kanë rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës në Komisione dhe në realizimin e axhendës së komisionit. Në praktikën parlamentare, përfshirë rastin shqiptar, partitë kanë deleguar në krye të komisioneve figura të rëndësishme politike, anëtarë të kryesive apo ishministra. E njëjta praktikë është ndjekur edhe në tri sesionet e mëparshme të parlamentit, përfshirë rokadën midis disa ish-ministrave të shkarkuar me kryetarë komisionesh që u emëruan ministra në janar 2019.

Në sesionin aktual ndryshimet në qeveri dhe më pas edhe ndryshimet që ndodhën në përbërjen e parlamentit çuan në ndryshime të vazhdueshme të kryetarëve dhe të zëvendëskryetarëve të komisioneve. Një pjesë e madhe e tyre janë deputetë për herë të parë dhe disa vijnë në Kuvend pa pasur fare përvojë politike, drejtimi apo angazhimi publik. Nevoja për të integruar deputetët e rinj në komisione dhe për ta bërë sa më funksional parlamentin ka krijuar edhe mangësi në standardet dhe në efikasitetin e vetë punës në komisione, në drejtimin e tyre dhe në cilësinë e debatit apo të komunikimit.



Nga ana tjetër, drejtimi i Komisionit kërkon që përveç njohurive të thelluara mbi ligjet dhe Rregulloren e Kuvendit, drejtuesi të demonstrojë edhe standarde të larta etike komunikimi dhe të jetë garant i harmonisë dhe funksionalitetit të punës në Komision. Një pjesë e komisioneve kanë arritur ta përmbushin këtë pritshmëri, sidomos tek Komisioni i Tregtisë dhe Veprimtarive Prodhuese, tek Politika e Jashtme apo Integrimi. Megjithatë ka pasur raste sidomos në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe në Komisionin e Ligjeve ku drejtimi i mbledhjeve të veçanta ka qenë i personalizuar, imponues dhe larg standardeve etike dhe profesionale. Po ashtu ka pasur raste tek Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, ku mosmarrëveshjet midis drejtuesve në komision kanë krijuar situata jonormale për më tepër për një komision të tillë, ku edukimi është objekti kryesor i vendimmarrjes.

Rregullorja e re ka zgjeruar dhe përcaktuar më mirë përgjegjësitë e komisioneve, por referuar rregullave në fuqi, ka detyrime të cilat pjesa më e madhe e komisioneve, sidomos e drejtuesve të tyre, nuk i kanë përmbushur. Për shembull, detyrimi i nenit 33, sipas të cilit kryetari i komisionit, i cili informon komisionin për çdo veprimtari që kryen në emër të tij, nuk rezulton të jetë pjesë e mbi 90% të procesverbaleve të mbledhjeve në komisione. Edhe detyrimi i nenit 34, që në procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së komisioneve të bashkëngjitet mendimit të shumicës së komisionit, nuk është bërë ende standard pune në parlament.

5.8. NËNKOMISIONET: NGA 6 TË TILLA, 3 NUK KANË AKTIVITET GJATË 2019

Të dhënat e punës dhe transparencës së nënkomisioneve vlejné për të evidentuar të paktën tre përfundime: ka nënkomisione me numër më të madh mbledhjesh sesa sesioni i kaluar parlamentar (4 mbledhje të nënkomisionit për të drejtat e njeriut), ka nënkomisione që nuk janë mbledhur asnjëherë gjatë 2019 (ai për administratën publike, për qeverisjen vendore dhe për diasporën dhe emigracionin). Edhe këtu gjithashtu ka dokumentacion të papublikuar të mbledhjeve ende nga Kuvendi.

BILANCI I PUBLIKIMEVE TË PROCESVERBALEVE TË KUVENDIT (20.08.2019)			
MBLEDHJE TË ZHVILLUARA	NUMRI	PUBLIKUAR	JO PUBLIKUAR
PËR BARAZINË GJINORE DHE PARANDALIMIN E DHUNËS NDAJ GRUAS	3	1	2
PËR TË DREJTAT E NJERIUT	4	4	0
PËR MBIKQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR VETING-UN E POLICISË	1	1	0
PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE	0	0	0
PËR DIASPORËN DHE EMIGRACIONIN	0	0	0
PËR QEVERISJEN VENDORE	0	0	0
NËN/KOMISIONE NË KUVEND	8	6	2



Për informacion publik, kryetar i nënkomisionit për barazinë gjinore është deputetja Eglantina Gjermeni (PS), nënkryetar i nënkomisionit për diasporën dhe emigracionin është deputeti Adnor Shameti (PS), kryetar i nënkomisionit për qeverisjen vendore është deputeti Bashkim Fino (PS), kryetare e nënkomisionit për të drejtat e njeriut është deputetja Vasilika Hysi (PS), kryetar i nënkomisionit për administratën publike është deputeti Alket Hyseni (PS), si dhe kryetar i nënkomisionit për vetingun në polici është deputetja Ermonela Felaj (PS).




5.9. PARREGULLËSI: NË TË NJËJTËN ORË DEPUTETËT NË DY MBLEDHJE

Një prej problematikave të mbledhjeve të Komisioneve ka qenë e mbetet diferenca ende e madhe midis standardeve që kërkon Rregullorja e Kuvendit për komisionet dhe vetë mbledhjet e Komisioneve. Në raportet e vitit 2018, ISP pati raportuar raste të shumta të deklarimeve fiktive të pjesëmarrjes së deputetëve në komisione, duke dhënë emra, data dhe të detaje të sakta. Stafi ynë është në dijeni se këto praktika nuk trajtohen në Rregullore, megjithatë dukë qenë se ato kanë kosto financiare fiktive, duhej të ishin marrë në konsideratë dhe të jenë verifikuar.


Edhe gjatë këtij sesioni parlamentar monitoruesit e ISP kanë konstatuar disa raste kur ka pasur mbledhje komisionesh në të njëjtën orë dhe datë, dhe ku të njëjtët deputetët kanë marrë pjesë në dy komisione

<p style="text-align: center;"> REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI Komisioni për Ekonominë dhe Financat PROCESVERBAL Tiranë, më 17.04.2019, ora 10:00 Drejton mbledhjen: Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit</p> <p>Rendi i ditës: 1. Miratimi i procesverbalit të datës 02.04.2019. 2. Seancë dëgjimore me kandidatët: Pajtim Melani, Ervin Mete, Olsi Coku për plotësimin e vakancës Kryetar në Bordin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.</p> <p>Marrin pjesë: Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Ilir Xhakoll, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Dritan Bicaj, Evis Kushi, Ervin Bushati, Senida Mesi dhe Arben Elezi.</p> <p>Mungojnë: Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj dhe Ambra Barova.</p> <p>Të ftuar: Pajtim Melani Ervin Mete Olsi Coku</p>	<p style="text-align: center;">KUVENDI Komisioni për Veprimtarinë Prodhuuese, Tregtinë dhe Mjedisin PROCESVERBAL Tiranë, më 17.04.2019, ora 10:00 Drejton mbledhjen: Niko Peleshi – kryetar i Komisionit</p> <p>Rendi i ditës: Prezantimi i raportit vjetor për vitin 2018 i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, nga drejtori ekzekutiv i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, zoti Janez Kopac</p> <p>Marrin pjesë: Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Boqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pellumbi, Robert Bitri, Dritan Bicaj, Halil Jakimi, Arlind Çaçani dhe Nimet Musaj.</p> <p>Mungojnë: Lefter Koka.</p> <p>Të ftuar: Janez Kopac – drejtori ekzekutiv i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë Barbora Jaksova – Gjergj Simaku – Drejtor i Politikave dhe Strategjisë së Zhvillimit të Energjisë dhe</p>
<p style="text-align: center;"> REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik PROCESVERBAL Tiranë, më 15.04.2019, ora 11:00 Drejton mbledhjen: Milva Ekonomi - nënkryetare e Komisionit</p> <p>Rendi i ditës: Seancë dëgjimore me drejtues të RTSH-së për shqyrtimin e Raportit të veprimtarisë vjetore të RTSH-së për vitin 2018.</p> <p>Marrin pjesë: Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Mirela Kumbo, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.</p> <p>Mungojnë: Enada Kapllani.</p>	<p style="text-align: center;">KUVENDI Komisioni për Mbrojtjen, Veprimtarinë Prodhuuese dhe Mjedisin PROCESVERBAL Tiranë, më 15.04.2019, ora 11:00 Drejton mbledhjen: Klodiana Spahiu – nënkryetare e Komisionit</p> <p>Rendi i ditës: Shqyrtimi në parim i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."</p> <p>Marrin pjesë: Klodiana Spahiu, Edlira Bode, Flamur Golemi, Adelina Rista, Ilir Pendavinji, Roland Xhelilaj, Klotilda Bushka, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Enver Roshi dhe Majlinda Halilaj.</p> <p>Mungon: Arben Kamami.</p> <p>Të ftuar: Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Merita Xhafaj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</p>

paralele në të njëjtën kohë, një tregues kritik i fiktivitetit në deklarime, pjesëmarrje dhe të vetë integritetit të punës në komisionet parlamentare. Konkretisht, më 11.06.2019 i njëjti deputet (A.Dhima), figuron pjesëmarrës në dy mbledhje paralele që mbahen në të njëjtën orë dhe datë, përkatësisht në Komisionin për Ekonominë dhe Financën si dhe në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.



Po ashtu me 15 prill 2019 figuron se dy deputete kanë qenë njëherësh pjesëmarrëse në dy mbledhje paralele komisionesh parlamentare, të cilat mbahen në të njëjtën datë, në të njëjtën orë dhe në mjedis të ndryshme parlamentare. Në një rast tjetër deputeti Bici figuron në të njëjtën orë dhe në të njëjtën datë pjesëmarrjes në dy mbledhje të ndryshme komisionesh, në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin si dhe në Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Të dhëna të tilla të pjesëmarrjes njëherësh në dy veprimtari paralele janë konstatuar edhe në të paktën pesë raste të tjera gjatë muajve të fundit.



Neni 32 i Rregullores përcakton detyrimin se Komisionet e Përhershme nuk mund të mbledhen gjatë kohës kur Kuvendi zhvillon punimet në seancë plenare, përveçse me miratimin e Kryetarit të Kuvendit. Në rastet e evidentuara nga ISP nuk kemi të dhëna publike nëse ka pasur miratim të kryetarit, gjithashtu në dokumentacionin e mbledhjes nuk janë përfshirë të dhëna të tilla. Për ilustrim, më 30 maj, në ora

10.00 është zhvilluar mbledhja e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në të njëjtën datë dhe orë, kanë nisur punimet e seancës plenare në Kuvend. Dokumentet ilustruese janë marrë nga faqja e internetit e Kuvendit dhe konsiderohen dokumente zyrtare.

Gjithashtu ka pasur raste debati në komisione, ku në devijim nga praktikat parlamentare, është komunikuar në debat se janë ftuar ose kanë shprehur interes për pjesëmarrje në debate të rëndësishme të komisioneve individë, të cilët komunikojnë me Kuvendin jo në rrugë institucionale, por përmes komunikimit personal, madje përmes medias sociale, më drejtues të Komisionit. Një rast i tillë konstatohet dhe nga procesverbali i mbledhjes së datës 18 prill në Komisionin e Edukimit, ku drejtuesja e mbledhjes deklaroi se ka marrë kërkesë “institucionale” përmes whatsapp nga një person për t’u ftuar në seancë dëgjimore në Komision!!! Pati gjithashtu raste kur monitoruesit e ISP konstatuan se në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, neni 27, pika 5, nuk u respektua detyrimi që “në çdo rast, rendi i ditës duhet të jetë bërë publik të paktën 2 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e komisionit ose seancës plenare”.

5.10. HETIMET DHE PRAKTIKA E INTERESIMIT PËR DEPUTETËT

Gjatë sesionit vijuan akuzat politike që përfshijnë edhe deputetë të veçantë, si dhe pati kërkesa për hetime nga ana e Prokurorisë ndaj deputetëve të caktuar. Materiale të regjistruara nga fushatat elektorale 2016 dhe 2017 të shfaqura në disa mediat tona dhe ndërkombëtare përfshinë së paku pesë deputetë, të cilët nuk ka asnjë njoftim ende nëse janë nën hetim nga Prokuroria. Një kërkesë për informacion nga ana e ISP, Prokuroria iu përgjigj se ka çështje në ndjekje, por pa specifikuar emrat e deputetëve dhe akuzat konkrete.

Nga publikimet në media nuk pati vetëm elementë që mund të përbëjnë objekt hetimi për abuzim me pushtetin (emërime, kërcënime ndaj të punësuarve në sektorin publik, biseda për favore politike me individë me lidhje kriminale, elementë të përdorimit politik të policisë, etj.), por ajo që doli si element i ri në përgjigjet, ishte gjuha vulgare e komunikimit e një pjese të madhe të deputetëve të përfshirë. Natyrisht e folura dhe komunikimi janë zgjedhje personale dhe nuk mund të kufizohen me ligj dhe as me rregulla të shkruara, por individët e zgjedhur në postin e deputetit dhe ministrit kanë disa detyrime morale dhe etike në komunikim, kanë përgjegjësi të tjera në komunikim dhe duhet të demonstrojnë minimalisht elementë të vetëpërbajtjes në raste të tilla.

Së paku dy deputetë janë thirrur nga organet e hetimit për t’u pyetur për elementë të veçantë të dosjeve të publikuara, megjithatë, në secilin rast as Kuvendi dhe as grupet parlamentare nuk kanë pasur një qëndrim apo nuk kanë dhënë deklarime mbi ngjarjet. Përkundrazi, një pjesë e deputetëve të përfshirë i justifikuan të gjitha, komunikimet pa etikë, presionet mbi administratën, abuzimin me pushtetin, etj, duke i konsideruar këto madje si merita personale dhe si gjëra normale për një deputet.

Në fazën kur partitë opozitare lajmëruan vendimin për dorëzimin e mandatave parlamentare, procesi i tyre u shoqëria edhe me protesta të organizuara gjatë periudhës së zhvillimit të seancave plenare. Axhenda politike në raste të tilla la në hije axhendën parlamentare dhe vetë Kuvendi më shumë u investua në funksionimin formal normal të Kuvendit sesa në funksionimin cilësor dhe organik të tij.



Në të paktën dy raste protestat në hyrje të seancës plenare u shoqëruan me incidente edhe fizike midis protestuesve dhe deputetëve të mazhorancës, një pjesë e protestuesve përdorën mjetet e dhunës ndaj forcave të sigurisë, por edhe Policia e ndërhyri me mjete disproporcionale, përfshirë përdorimin masiv të gazit lotsjellës në një mjedis turme dhe të mbipopulluar, ku kishte të pranishëm edhe shumë politikanë, deputetë, por edhe familjarë dhe fëmijë.

Disa deputetë të opozitës u përfshinë në deklaratat e policisë si subjekt të hetimit dhe të kallëzimit penal, edhe gjatë periudhës kur ata zyrtarisht vijonin ende të ishin deputetë, në pritje të vendimit konfirmues të KQZ për shpalljen e vakantes për mandatin e tyre. Nuk pati ndonjë interesim dhe as deklaram të Kuvendit lidhur me deputetët e opozitës të përfshirë në incidente jashtë parlamentit, të vendosur nën hetim apo të dëmtuar nga ndërhyrja e Policisë, përfshirë as rastin kur njëri prej deputetëve përfundoi për trajtim disa ditë mjekësor në spitalin shtetëror.

Nga ana tjetër, shumica në Kuvend dhe drejtuesit e institucionit përdorën praktika të vendimmarrjeve të “momentit të fundit” për të anuluar seanca plenare, për të zhvendosur orët e zhvillimit të tyre, etj, në përpjekje për të evituar konfrontimin me protestuesit e opozitës. Kjo zgjedhje procedurale rezultoi e suksesshme në funksion të evitimit të konfrontimit të mëtejshëm të situatës, por gjithsesi ajo ishte njëherësh pjesë e një procesi kompleks që çënoi funksionin normal të parlamentit dhe sidomos funksionimin cilësor të tij.

Një pjesë e procedurave të ndjekura në këtë periudhë, qoftë në mbledhjet e Komisioneve në parlament, qoftë në seancat plenare, etj, ishin të motivuara më shumë nga nevoja për konsumimin e praktikave parlamentare sesa nga sensi i respektit për standardet dhe praktikat e përcaktuara në Rregullore.

Nga ana tjetër pati raste kur deputetë, që dorëzuan mandatet në shkurt 2019, të cilët kanë qenë ministra e zyrtarë të lartë dhe deri në shkurt edhe deputetë në parlament, u bënë protagonistë të sjelljeve të dhunshme, në thirrje publike apo me veprime konkrete, në protesta apo në mjedise të policisë së shtetit, një tregues tjetër i një niveli problematik, shqetësues dhe shpeshherë edhe zhgënjyes ku ka qenë dhe është politika dhe përfaqësimi i saj në institucionin me të rëndësishëm kushtetues, parlamentin e vendit.

5.11. VETËM 17 NGA 45 DEPUTETËT E RINJ U TRAJNUAN NË KUVEND

Parlamenti bëri përpjekje për të ndikuar pozitivisht në situatën e krijuar, duke organizuar dy trajnime me deputetët e rinj, një detyrim në Rregulloren e Kuvendit, por edhe një nevojë emergjente për një pjesë të deputetëve pa përvojë politike. Sipas të dhënave të Kuvendit, në dy trajnimet e organizuara me 9 maj dhe 14 qershor morën pjesë 17 deputetë, pra pak më shumë se një e treta e deputetëve të rinj. Fokusi i trajnimit ishte deklarimi i pasurisë, Kodi i Sjelljes, Konflikti i Interesit, Rregullorja e Parlamentit, dhe elementë të tjerë informues në kuadër të detyrimeve ligjore dhe nevojës për më shumë transparencë.

Si rregull, në trajnime do të duhej të merrnin pjesë të gjithë deputetët e rinj, ose do të duhej të kishte një trajnim të tretë ku të merrnin pjesë edhe deputetët e zgjedhur rishtas, por kjo nuk ndodhi. Rregullat në Kuvend parashikojnë detyrimin për organizimin e trajnimeve për deputetët, por nuk parashikojnë detyrimin e deputetëve për të marrë pjesë në to.



Gjatë sesionit, ISP me stafin e tij, hartoi dhe publikoi një broshurë profesionale informative mbi Konfliktin e Interesit dhe Kodin e Sjelljes në Kuvend, botim që iu shpërnda falas të gjithë deputetëve përmes shërbimit për deputetët në Kuvend. Botimi përbën një prej materialeve më konkrete dhe më cilësore mbi këtë tematikë dhe tenton të përmbushë sadopak nevojën e madhe që parlamenti dhe deputetët kanë për botime cilësore, profesionale dhe funksionale në lidhje me punën e tyre.

5.12. RASTI PALOKA, INCIDENTI ME “BOJË” NDAJ KRYEMINISTRIT

I vetmi deputet i penalizuar me masë disiplinore nga Kuvendi gjatë sesionit të kaluar parlamentar është zëvendëskryetari i Kuvendit Edi Paloka. Deputeti i PD u përjashtua në seancën e 12 shkurtit 2019 pasi hodhi bojë mbi kryeministrin Rama. Incidenti i paprecedent zuri vend në të gjithë mediat dhe rezultoi të ishte përgjigje e deputetit ndaj një sjellje denigruese të kryeministrit ndaj deputetit në seancën e mëparshme.

Megjithatë, incidenti mbetet shkelje e praktikës dhe etikës parlamentare dhe me të drejtë Byroja e Kuvendit, me vendim nr.34, datë 12 shkurt vendosi përjashtimin 10 ditor të deputetit Paloka nga pjesëmarrja në seancat plenare dhe në komisionet parlamentare. Vendimi e humbi vlerën kur vetëm disa ditë më pas opozita vendosi dorëzimin e mandateve dhe ikjen kolektive nga Kuvendi, përfshirë edhe deputetin e penalizuar.

5.13. TRE DEPUTETË NË REGJISTRIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Gjatë sesionit parlamentar janar – korrik 2019 Kuvendi shënoi për herë të parë një rezultat pozitiv në praktikën e deklarimit paraprak të rasteve të deputetëve në Konflikt Interesi. Tre deputetë (Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi dhe Anastas Angjeli) në katër raste deklaruan se janë në gjendje të konfliktit të interesit ndaj deklaruan mospjesëmarrjen në procesin e votimit të akteve të cituara në deklaratë.

Deklarimet e tyre janë gjithashtu rasti i parë zyrtar në historinë 28 vjeçare të parlamentit në Shqipëri, si të tilla meritojnë vlerësim dhe janë tregues se normat e Kodit të Sjelljes, miratuar më 2018 dhe që përfshijnë praktikën e parandalimit të Konfliktit të Interesit kanë filluar të marrin jetë.

Fakti se tre deputetët e deklaruar në Regjistrin e Konfliktit të Interesit në Kuvend janë njëherësh politikanë me karrierë të gjatë politike e parlamentare, është edhe një tregues nxitës për deputetët e rinj të legjislaturës së fundit, të cilët ende nuk kanë demonstruar nivel të tillë llogaridhënie dhe transparence.

5.14. BONUSI FINANCIAR, 23 DEPUTETËT PËRFITUES PËR 2019

Bazuar në Statutin e Deputetit, Rregulloren e Kuvendit dhe aktet e tjera rregullatore në Kuvend, deputetët e ardhur nga bashki me largësi nga Tirana dhe që nuk kanë banesë në Tiranë bëhen përfitues të bonusit financiar për strehimin.

Gjatë sesionit të kaluar ka pasur një numër të kufizuar deputetësh përfitues, megjithatë ISP ka ngritur vazhdimisht shqetësimin se një pjesë e përfitimeve të bonusit të strehimit është abuzive dhe duhej verifikuar nga Kuvendi. Ky i fundit nuk ka ndërmarrë masa verifikuese, por vetëm ka zyrtarizuar kërkesën e deputetit dhe dokumentacionin plotësues të ardhur nga institucione e tjera. Edhe në listën



bashkëngjitur ka emra raste kur një deputet, i cili ka organizuar emision të posacëm televiziv për të treguar banesën e tij luksoze në Tiranë, “zyrtarisht” figuron i pastrehë dhe trajtohet nga Kuvendi me bonusin e strehimit.

Në listën e përfituesve të bonusit të strehimit bëjnë pjesë një numër më i madh deputetësh, kryesisht deputetët e rinj të betuar gjatë muajve të pranverës 2019 në parlament.

Në listë janë përfshirë edhe ish-ministra (Senida Mesi, Niko Peleshi), të cilët më parë nuk trajtoheshin me bonusin e strehimit nga Kuvendi dhe që vijnë nga qytete të largëta si Korça e Shkodra, si shumica e listës, por ka edhe deputetë të tjerë, midis të cilëve edhe një deputet, i cili në formularët e deklarimit paraprak në KQZ ka deklaruar se banon në Tiranë, duke dhënë edhe adresën përkatëse.

Bonusi financiar nuk ka ndonjë vlerë të lartë, por megjithatë, më shumë sesa çështje financiare është çështje transparence, respekt ndaj ligjit dhe çështje integriteti. Bazuar në këto parime, Kuvendi mund e duhet të rishikojë praktikën dhe aktet rregullatore për të garantuar transparencë maksimale për 122 deputetët e tij aktualë dhe për të krijuar një bazë të qëndrueshme referimi edhe për të ardhmen.

DEPUTETËT PËRFITUES TË QIRASË SË BANIMIT NË TIRANË		
01	NARD NDOKA	JANAR-SHKURT
02	IZMIRA ULQINAKU	JANAR-SHKURT
03	NADIRE MEÇORAPAJ	JANAR-SHKURT
04	SENIDA MESI	NË VIJIM
05	EDLIRA BODE	NË VIJIM
06	FADIL NASUFI	NË VIJIM
07	LUAN HARUSHA	NË VIJIM
08	EDMOND LEKA	NË VIJIM
09	XHEVIT BUSHAJ	NË VIJIM
10	NIKO PELESHI	NË VIJIM
11	EDIOLA BRAHA	NË VIJIM
12	ARLIND ÇAÇANI	NË VIJIM
13	NIKOLIN STAKA	NË VIJIM
14	HALIL JAKIMI	NË VIJIM
15	SELAMI JENISHEHRI	NË VIJIM
16	ENADA KAPLLANI	NË VIJIM
17	KOSTAQ PAPA	NË VIJIM
18	ARTEMIS MALO	NË VIJIM
19	DRITAN BICI	NË VIJIM
20	VASIL STERJOVSKI	NË VIJIM
21	NIMET MUSAJ	NË VIJIM
22	ILIRJAN PENDAVINJI	NË VIJIM
23	FATMIR VELAJ	NË VIJIM





6. KLASIFIKIMI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE

(JANAR - GUSHT 2019)

Kuvendi i Shqipërisë, sipas Kushtetutës dhe praktikës së qeverisjes demokratike, kryen tri funksione bazë: funksionin legjislativ, funksionin zgjedhor dhe funksionin kontrollues. Në ushtrimin e këtyre funksioneve Kuvendi ka përgjegjësinë jo vetëm të ketë funksion përfaqësues, por edhe të shërbejë si mekanizëm nxitës i demokracisë si parandalues/zgjidhës i mosmarrëveshjeve politike. Këto përcaktime teorike janë të njohura për deputetët e publikun, por në tërësi zbatimi i tyre realizohet në varësi nga niveli i demokracisë funksionale ku parlamenti zgjidhet, punon dhe konsumon legjislaturën.

Për shkak të kulturës së brishtë politike dhe sistemit zgjedhor në Shqipëri (proporcional me lista të mbyllura), roli i deputetëve në jetën parlamentare është shumë më i (vet)kufizuar sesa në modelet e demokracive funksionale dhe në sisteme të tjera elektorale. Deputetët nuk kanë zona fikse zgjedhore. Ata caktohen nga partia e tyre të përfaqësojnë zona, mandat që mund të ndryshojë disa herë gjatë së njëjtës legjislaturë. Megjithatë deputetët përfaqësojnë prurje politike të ndryshme, mbrojnë e promovojnë programe politike dhe kanë të drejtë të propozojnë ligje, të bëjnë amendamente ligjore, të zhvillojnë interpelanca dhe seanca pyetjesh, të krijojnë lidhje të forta me elektoratin dhe të diskutojnë lirshëm për çdo tematikë në interes të tyre. Ata kanë të drejtë të votojnë, të abstenojnë, të refuzojnë vendimmarrjen politike, por edhe kanë detyrimin të jetë transparent në aktet dhe sjelljen e tyre, si dhe t'i përgjigjen sistemit të munguar të llogaridhënies.

Për qytetarin shqiptar, votues ose jo, perceptimi për deputetët mbetet i njëjtë: miratojnë e propozojnë ligje, janë zgjedhur kryesisht nga vullneti i liderëve politikë të partive të tyre, kanë fuqi politike dhe vendimmarrëse, mund të artikulojnë çështje e problematika që janë gati të pamundura për qytetarin e thjeshtë, si dhe kanë mekanizma të shumtë përmes të cilëve mund t'u ofrohet zgjidhje sa më optimale problemeve dhe sfidave ndaj shtetit, shoqërisë dhe qytetarëve.

Në funksion të nevojës për transparencë e llogaridhënie, Instituti i Studimeve Politike vijoi të bëjë jo vetëm monitorimin e aktivitetit të deputetëve, por edhe vlerësimin e nivelit të efikasitetit të tyre, bazuar në treguesit bazë të aktivitetit parlamentar. Konkretisht, është përdorur kjo metodologji vlerësimi: vlerësimi i nismave ligjore me 10 pikë, vlerësimi i amendimeve ligjore në seancë ose në komision me 10 pikë, vlerësimi i interpelancat në seancë me 10 pikë, votimi i ligjeve dhe akteve në seancë me 10 pikë, kërkesa për pyetje ose kërkesa për informacion adresuar institucioneve me 10 pikë, aktiviteti publik që lidhet edhe me zonën elektorale me 10 pikë, angazhimi në fjalime dhe në seancat plenare me 20 pikë, si dhe angazhimi në formë pjesëmarrjeje dhe diskutimesh në komisionet parlamentare me 20 pikë. Në total janë 100 pikë, por dhe vlerësimi zbritës negativ (përfashtim nga seancat ose komisionet – nga 5 në 10 pikë në varësi nga niveli i masës penalizuese, heqje imuniteti apo hetime zyrtare ndaj deputetit nga -20 pikë, si dhe heqje mandati -50 pikë). Në total pikët penalizuese janë gjithashtu 100 pikë.

Sistemi i vlerësimit është aplikuar në të gjitha raportet periodike të ISP dhe është pranuar nga deputetët. Të gjithë deputetët i janë referuar dhe ka pasur përpjekje nga deputetët për të "fituar" pikë në vlerësim. Në thelb, kriteret e vendosura nuk janë kriteret e ISP, por janë kriteret bazë të aktivitetit parlamentar në një sistem politik e zgjedhor si ai i Shqipërisë. Kritika e vetme e ardhur nga deputetët në



vlërësimet e mëparshme lidhej me nevojën e harmonizimit të vlerësimit të deputetëve duke marrë parasysh rastet kur deputeti është kryetar grupi ose deputet i thjeshtë, kur deputeti merr pjesë në më shumë se një komision parlamentar, kur deputetët kanë angazhime parlamentare në delegacione të ndryshme jashtë vendit apo kur deputetët kanë funksione të tjera drejtuese dhe protokollare në parlament ose në krye të partive politike.

Stafi i ISP është përpjekur të gjejë një zgjidhje të pranueshme për secilin prej këtyre pretendimeve. Prezenca në mbledhjet e ndryshme të komisioneve janë konsideruar në tërësi dhe më pas është bërë vlerësimi në përqindje për secilin deputet, prezencë dhe diskutim, duke dhënë vlerësimin më realist të mundshëm për secilin prej tyre. Gjithashtu është marrë në konsideratë hierarkia e grupeve parlamentare dhe krijimi i grupeve të reja parlamentare gjatë sesionit parlamentar të vitit 2019.

Veçoria dhe vështirësia kryesore gjatë 2019 lidhej jo me elementët e klasifikimit të aplikuar gjatë raporteve të mëparshme 2017-2019, por me faktin se parlamenti u ndesh me një dukuri të re. Opozita parlamentare dorëzoi mandatet në fillim të sesionit parlamentar dhe më pas procesi i zëvendësimit të mandateve mori kohë të gjatë, duke krijuar flukse të reja në parlament, të cilat nuk mund të ketë të njëjtin standard sasior vlerësimi. Gjithashtu disa deputetë të mazhorancës dhanë dorëheqje nga mandati duke kandiduar në zgjedhje lokale, dhe për pasojë, nuk e ushtruan mandatin e plotë parlamentar. Po ashtu, kishte deputetë që ndryshuan grupet parlamentare ose grupe parlamentare që u krijuan rishtas në parlament.

KRITERET E VLERËSIMIT	PIKËT
NISMA LIGJORE	10
AMENDIME (SEANCË-KOMISION)	10
INTERPELANCA NË SEANCË	10
ANGAZHIMI NË SEANCË	20
ANGAZHIMI NË KOMISION	20
VOTIMI I AKTEVE NË KUVEND	10
ADRESIM PYETJE – INFORMACION	10
AKTIV NË ZONË / PUBLIK	10
MASA DISIPLINORE	-5 deri -10
HETIME NDAJ DEPUTETIT	-20
HEQJE TË IMUNITETIT	-20
HEQJE MANDATI	-50

ISP në këto raste ka ndjekur të njëjtën metodikë vlerësimi: secili prej deputetëve është vlerësuar për periudhën kur ka qenë deputet, pra në raport me ushtrimin e mandatit dhe jo në raport me të gjithë sesionin parlamentar janar – korrik 2019. Për rrjedhojë treguesit për secilin deputet janë në përputhje proporcionale me mandatin dhe angazhimin e tij në parlament, duke evituar keqkuptimet dhe kalkulimet në totalin kohor të sesionit parlamentar.

6.1. DEPUTETËT MË EFEKTIVË? KRYESJNË HYSI, MURRIZI, BEQAJ DHE HAJDARI

Nga të dhënat e tabelës përmbledhëse të aktivitetit parlamentar për deputetët që ushtruan plotësisht mandatin parlamentar gjatë periudhës janar-gusht 2019, rezultojnë se në 10 deputetët më efikasë janë Vasilika Hysi me 72 pikë, ndjekur nga Myslim Murrizi me nga 63 pikë, Ilir Beqaj, Ermonela Felaj dhe Rudina Hajdari me nga 62 pikë, Arben Ahmetaj me 60 pikë, Antoneta Dhima me 58 pikë, Englantina Gjermani me 56 pikë, Blerina Gjylameti me nga 53 pikë, si dhe Ulsi Manja e Ervin Bushati me nga 52 pikë. Deputetja Vasilika Hysi është e shkëputur nga deputetët e tjerë në vlerësim, kurse diferencat midis deputetëve të tjerë janë minimale. Nga dhjetë deputetët më efektivë në parlament, tre prej tyre, Ermonela Felaj, Arben Ahmetaj dhe Ulsi Manja janë njëherësh edhe kryetarë të komisioneve



parlamentare, si dhe vetëm deputetja Hajdari është në mandatin e saj të parë parlamentar. Nga 10 deputetët më efektivë, 6 prej tyre janë gra deputete dhe 4 të gjinisë tjetër.

Një veçori e tabelës lidhet edhe me kurbën e treguesve të efikasitetit për deputetët kryesorë. Edhe në raportin e fundit të vitit 2018 deputetja Hysi ka pasur rezultate të larta, kurse disa prej deputetëve të tjerë me rezultate të larta aktiviteti kanë pasur rezultate simbolike ose mesatare në sesionet e tjera parlamentare.

Një arsye e rëndësishme e këtij ndryshimi midis këtij sesioni dhe sesioneve të mëparshme lidhet me të paktën dy faktorë.

- I pari, fakti që opozita kryesore parlamentare nuk është më në parlament dhe për pasojë, deputetë si Jorida Tabaku e Albana Vokshi, periodikisht me nivel të lartë efikasiteti, nuk janë më konkurrues dhe as pjesë e vlerësimit.
- I dyti, deputeti më efektiv në sesionet e kaluara, Erion Braçe është zgjedhur zëvendëskryeministër në fillim të këtij sesioni parlamentar dhe për pasojë, nuk është direkt objekt i monitorimit por edhe ai vetë për shkak të funksionit ekzekutiv është subjekt i kufizuar i aktivitetit parlamentar.

KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE “TË VJETËR” SIPAS EFIKASITETIT PERIUDHA JANAR-GUSHT 2019

NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	PIKË	NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	PIKË
01	VASILIKA HYSI	PS	72	37	LINDITA NIKOLLA	PS	32,9
02	MYSLIM MURRIZI	DEM	63,6	38	MIMI KODHELI	PS	32,9
03	ILIR BEQAJ	PS	62,1	39	ANDREA MARTO	PS	32,3
04	RUDINA HAJDARI	DEM	62	40	FATMIR VELAJ	PS	32
04	ERMONELA FELAJ	PS	62	41	BUJAR ÇELA	PS	31,2
05	ARBEN AHMETAJ	PS	60,8	42	ANASTAS ANGJELI	PS	31,1
07	ANTONETA DHIMA	PS	58,4	43	XHEMAL QEFALIA	PS	30,5
08	EGLANTINA GJERMENI	PS	56,6	44	MUSA ULQINI	PS	30,2
09	BLERINA GJYLAMETI	PS	53,2	45	ILIR NDRAXHI	PS	30
10	ULSI MANJA	PS	52,8	46	DRITAN BICI	PS	29,6
11	ERVIN BUSHATI	PS	52,2	46	ROBERT BITRI	PS	29,6
12	BESNIK BARAJ	PS	51,7	48	EDLIRA BODE	PS	29,2
13	BASHKIM FINO	PS	51,6	49	TATJANA PIRO	PS	29,1
14	ALKET HYSENI	PS	50,4	50	ANDUEL XHINDI	PS	29
15	EVIS KUSHI	PS	50,2	50	RAKIP SULI	PS	29
16	ELONA GJEBREA	PS	48,6	52	FIDEL YLLI	PS	28,8
17	KLOTILDA BUSHKA	PS	48	53	XHAVIT BUSHAJ	PS	27,9
18	VULLNET SINAJ	PS	47,7	54	JURGIS CYRBJA	PS	27



19	NIKO PELESHI	PS	46,9	55	FATMIR XHAFAJ	PS	25,1
20	SENIDA MESI	PS	44,8	56	ILIR XHAKONI	PS	25
21	ADNOR SHAMETI	PS	43,8	57	LUAN DUZHA	PS	24,8
22	ISMET BEQIRAJ	PS	43	58	ILIRIAN PENDAVINJI	PS	24,7
23	ELENA XHINA	PA GRUP	41,4	59	NURI BELBA	PS	23
24	KLODIANA SPAHIU	PS	40,3	60	FLAMUR GOLEMI	PS	22
25	ADELINA RISTA	PS	39,8	61	ROLAND XHELILAJ	PS	21,1
26	FADIL NASUFI	PS	38,4	62	LUAN HARUSHA	PS	21
27	MILVA EKONOMI	PS	38,2	63	PAULIN STERKAJ	PS	20,9
28	SPARTAK BRAHO	PS	37,2	63	ARBEN KAMAMI	PS	20
29	PJERIN NDREU	PS	36	63	ARDIT KONOMI	PS	20
30	DITMIR BUSHATI	PS	35,8	66	MIRELA KUMBARO	PS	20
31	EDMOND LEKA	PS	35,7	67	SADRI ABAZI	PS	17,3
32	DAMIAN GJIKNURI	PS	35,5	68	GJETAN GJETANI	PA GRUP	17
32	VILMA BELLO	PS	35,5	68	REME LALA	PA GRUP	17
34	ALMIRA XHEMBULLA	PS	34,6	70	RRAHMAN RRAJA	PS	17
34	SADI VORPSI	PS	34,6	71	TOM DOSHI	PA GRUP	13
36	ARBEN PELLUMBI	PS	33,4	72	LEFTER KOKA	PA GRUP	11

*Shënim: Në tabelë janë përfshirë deputetët me mandat të rregullt gjatë sesionit parlamentar 2019, plus 5 deputetët e PS që dhanë dorëheqje në zgjedhjet lokale. Jashtë listës janë edhe kryetari i Kuvendit, deputetët ministra, kryeministri dhe kryetari i grupit parlamentar të PS. Ky i fundit, **Taulant Balla**, edhe për shkak të funksionit, ka angazhimin më të madh parlamentar, me 74 pikë.*

Tabela reflekton vetëm deputetët me mandat të plotë midis janarit dhe gushtit 2019, si dhe ka përfshirë (me italice) edhe pesë deputetët e PS, të cilët në fundin e muajit maj kandiduan për kryetarë bashkiake duke hequr dorë nga mandati i deputetit.

Për shkak të funksioneve në parlament dhe në qeveri, jashtë kësaj renditjeje janë lënë kryetari i Kuvendit, deputetët ministra, kryeministri, si dhe kryetari i grupit parlamentar të PS. Ky i fundit (Taulant Balla) në tabelën e përgjithshme të deputetëve ka treguesin më të lartë të efikasitetit, me 74 pikë, por shumë prej fjalimeve të tij në parlament janë më shumë qëndrime të grupit parlamentar sesa angazhime personale, ndaj edhe funksioni i tij është lënë jashtë renditjes së deputetëve të tjerë.

6.2. DEPUTETËT MË EFEKTIVË POLITIKANËT, ATA MË PAK EFEKTIVË BIZNESMENËT

Trendi i raporteve të mëparshme, sipas të cilave politikanët e karrierës kanë më shumë angazhim dhe efektivitet në aktivitetin parlamentar, sesa prurjet nga biznesi, vijon të ruhet edhe në legjislaturën aktuale dhe u konfirmua edhe në sesionin aktual parlamentar. Konkretisht, tabela paraqet 10 deputetët me nivelin më të lartë të efikasitetit gjatë sesionit parlamentar janar – gusht 2019, si dhe 10 deputetët me treguesit minimalë të efikasitetit. Në pjesën e deputetëve të suksesshëm bëjnë pjesë emra të njohur të politikës dhe asnjë prej tyre nuk vjen nga biznesi apo nga prurjet joorganike me partitë respektive politike.



Në listën e 10 deputetëve më pak aktivë në parlament, për pasojë, edhe me treguesit më minimalë të efikasitetit bëjnë pjesë së paku pesë biznesmenë të njohur, si dhe së paku katër prurje politike që nuk kanë lidhje organike me partitë e tyre politike dhe as me jetën parlamentare. Ndër deputetët më efikasë bëjnë edhe pjesë dy deputetët demokratë, Myslim Murrizi dhe Rudina Hajdari, të cilët refuzuan lënien e mandatit parlamentar dhe që gjatë kësaj periudhe ishin mjaft aktivë sidomos në debatet në seancat plenare dhe në angazhimet publike. Nga listat e suksesshme të PS bëjnë pjesë deputetë me përvojë dhe me më shumë se një mandat parlamentar, ku bën dallim angazhimi i deputetes Antoneta Dhima, prurja e vetme nga përfaqësimi periodik elektoral i PS.

Tek lista e deputetëve më pak efektivë vijojnë të jenë të njëjtët emra si edhe në raportimet e monitorimeve të kaluara të legjislaturës parlamentare, - biznesmenët Sadri Abazi, Lefter Koka, Tom Doshi, Luan Harusha, si dhe deputetja e zgjedhur në emër të PDIU më 2017 në Dibër, Reme Lala. Në pjesën fundore të listës bëjnë pjesë edhe emra që ndodhen për herë të parë në renditje negative, siç është rasti i ish-ministres së Kulturës Mirela Kumbaro. Dy deputetët e tjerë, Arben Kamani dhe Gjetan Gjetani, kanë pasur dhe vijojnë të kenë profil të ulët politik në parlament.

10 DEPUTETËT E “VJETËR” MË EFEKTIVË							
DHE 10 DEPUTETË MË PAK EFEKTIVË							
NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	PIKË	NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	PIKË
01	VASILIKA HYSI	PS	72	01	LUAN HARUSHA	PS	21
02	MYSLIM MURRIZI	DEM	63,6	02	PAULIN STERKAJ	PS	20,9
03	ILIR BEQAJ	PS	62,1	03	ARBEN KAMAMI	PS	20
04	RUDINA HAJDARI	DEM	62	04	MIRELA KUMBARO	PS	20
05	ERMONELA FELAJ	PS	62	05	SADRI ABAZI	PS	17,3
06	ARBEN AHMETAJ	PS	60,8	06	GJETAN GJETANI	PA GRUP	17
07	ANTONETA DHIMA	PS	58,4	07	REME LALA	PA GRUP	17
08	EGLANTINA GJERMENI	PS	56,6	08	RRAHMAN RRAJA	PS	17
09	BLERINA GJYLAMETI	PS	53,2	09	TOM DOSHI	PA GRUP	13
10	ULSI MANJA	PS	52,8	10	LEFTER KOKA	PA GRUP	11

6.3. PRURJET E REJA, KRYESJONË GJONI, MALIQI, ROSHI E STERJOVSKI

Gjatë sesionit aktual parlamentar rreth 45 deputetë të rinj u betuan dhe vijuan aktivitetin parlamentar. Nuk ka një numër fiks, pasi njëri prej deputetëve, (I.Hoxha) në momentin e betimit në Kuvend ndryshoi qëndrim dhe për rrjedhojë nuk është deputet, megjithëse mori mandat nga KQZ dhe u konfirmua nga struktura përkatëse në Kuvend.

Analiza e nivelit të efektivitetit për 45 deputetët e rinj është e njëjtë me deputetët “e vjetër”, me dallim të vetëm periudhën e kalkulimit të angazhimit të tyre parlamentar. Për deputetët e rinj të dhënat dhe përqindjet e treguesve të punës janë llogaritur vetëm për periudhën kur ata janë bërë deputet dhe jo gjatë pjesës tjetër kohore të punimeve të Kuvendit. Një pjesë e tyre fillimisht patën vështirësi për të



përcaktuar anëtarësinë në komisionet parlamentare dhe për rrjedhojë, kanë pasur rezultate negative edhe në vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit të tyre.

KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE “TË RINJ” SIPAS EFIKASITETIT:

NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	PIKË	NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	PIKË
01	RALF GJONI	PAV	48	24	ELIO HYSKO	PS	21
02	LEFTER MALIQI	PA GRUP	47	25	ARDIT KONOMI	PS	20
03	ARTUR ROSHI	PA GRUP	36,5	26	ARTEMIS DRALO	PS	19.1
04	VASIL STERJOVSKI	PA GRUP	34	27	EUGEN BOJAXHI	PA GRUP	19
05	ANDI PERMETI	PA GRUP	32,8	27	KRENAR RRYÇI	PA GRUP	19
06	FATJONA DHIMITRI	DEM	30	29	BESNIK TROPLINI	PA GRUP	18.1
06	LIGORAQ KARAMELO	PA GRUP	30	30	ERVIS MEÇO	PeD	18
08	NIMET MUSAJ	PAV	32	30	MAJLINDA HALILAJ	PA GRUP	18
08	ENVER ROSHI	PAV	29,5	30	NIKOLIN STAKA	PA GRUP	18
10	AURORA MARA	PAV	29	30	YLLI SHEHU	PAV	18
10	KUJTIM GJURI	PA GRUP	29	34	ELDA HOTI	PA GRUP	17.7
12	EDIOLA BRAHA	PAV	28,4	35	FLORENC SPAHO	PS	16
13	KORAB LITA	DEM	28,4	35	SUZANA TOPI	PA GRUP	16
14	EDLIRA HYSENI	PAV	28,1	37	ARLIND ÇAÇANI	DEM	15
15	ADRIATIK ALIMADHI	PED	27,8	37	KLAJDI QAMA	PA GRUP	15
16	ALBAN ZENELI	DEM	27	39	EDMOND RRUSHI	PA GRUP	14
16	KOSTAQ PAPA	PED	27	39	EDMOND STOJKU	PA GRUP	14
18	ARDIANA JAKU	PS	26	41	KOÇI TAHIRI	PeD	12
19	HALIT VALTERI	DEM	25	42	RAMAZAN GJUZI	PeD	11
20	ZEF SHTJEFNI	PED	24,5	43	ERION PICIRI	PA GRUP	10
21	ARBEN ELEZI	DEM	24,2	44	AMRA BAROVA	PAV	6
22	HALIL JAKIMI	DEM	25	45	ENADA KAPLLANI	PAV	5
23	SELAMI JENISHEHRI	PeD	22	46	INDRIT HOXHA	-	-

Shënim: Në tabelë janë përfshirë deputetët e rinj që u caktuan nga KQZ gjatë sesionit të fundit parlamentar

Një pjesë tjetër e tyre, sidomos prurjet më të reja në Kuvend, kanë relativisht rezultate të mira në raport me prurjet e tjera të reja për shkak se kanë marrë pjesë vetëm për një periudhë të shkurtër kohore në parlament, por nëse koeficienti i tyre i efikasitetit përlogaritet në tërësi me të gjithë kohën e sesionit parlamentar apo me kurbën e angazhimit të deputetëve të “vjetër” atëherë rezultatet e tyre të deritanishme do të rezultonin minimale.

Të dhënat e tabelës së klasifikimit të 45 deputetëve të rinj që hynë në parlament gjatë periudhës mars – qershor 2019, tregojnë se deputetët më efikasë në prurjet e reja janë Ralf Gjoni, Lefter Maliqi, Artur Roshi dhe Vasil Sterjovski, katër deputetë që vijnë nga prurje të ndryshme politike: i pari nga LSI, i dyti



nga PD, por i dorëhequr në periudhën zgjedhore të vitit 2017, i treti nga Balli Kombëtar dhe i katërti nga komuniteti maqedonas në Shqipëri. Për periudhën e angazhimit të tyre parlamentar ata kanë përkatësisht 48, 45, 36 dhe 34 pikë. Prej tyre vetëm Maliqi ka pasur më parë përvojë parlamentare.

Në listën vijuese janë edhe emra të tjerë me përvojë politike në partitë e mëdha ose të vogla, përfshirë Andi Permeti, ish anëtar i KK të PD që tashmë është në Bindja Demokratike, Ligorag Karamelo, i cili vite më parë ka drejtuar Lëvizjen për të Drejtat e Njeriut, etj. Në fundin e listës gjenden deputetë të rinj pa përvojë të mëparshme politike, dhe për rrjedhojë, edhe me vështirësi të mëdha në përshtatjen me praktikën parlamentare dhe me aktivitetin e dënuar parlamentar në komisione, në seancat plenare dhe në aktivitetet jashtë godinave parlamentare.

Tabela krahasuese midis pesë deputetëve të “rinj” me treguesit më pozitivë dhe më negativë të efikasitetit në aktivitetin e tyre parlamentar, vetëm sa konfirmon diferencën midis deputetëve që kanë pasur më parë edhe përvojë e poste drejtuese në parti politike me ata që kanë hyrë kryesisht në politikë përmes një sistemi tjetër vlerësimi dhe pa pasur një proces konkurrues direkt apo indirekt brenda partive të tyre.

5 DEPUTETËT E RINJ MË EFEKTIVË DHE 5 DEPUTETËT MË PAK EFEKTIVË

NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	PIKË	NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	PIKË
01	RALF GJONI	PAV	48	01	KOÇI TAHIRI	PED	12
02	LEFTER MALIQI	PA GRUP	47	02	RAMAZAN GJUZI	PED	11
03	ARTUR ROSHI	PA GRUP	36.5	03	ERION PICIRI	PA GRUP	10
04	VASIL STERJOVSKI	PA GRUP	34	04	AMRA BAROVA	PAV	6
05	ANDI PERMETI	PA GRUP	32.8	05	ENADA KAPLLANI	PAV	5

6.4. DEPUTETËT E PD: KRYESOJNË VOKSHI DHE TABAKU ME PIKË TË BARABARTA

Deputetët e opozitës (PD dhe LSI) qëndruan në parlament deri më javën e tretë të muajit shkurt dhe pas 20 shkurtit ata kishin dhënë dorëheqjen, me përjashtim të tre deputetëve që refuzuan (Myslim Murrizi, Rudina Hajdari dhe Lifter Koka), si dhe një deputeti që ndodhej jashtë vendit (Nard Ndoka).

Pavarësisht periudhës së shkurtër të aktivitetit parlamentar deri në dorëzimin e mandateve, në respekt të punës së deputetëve dhe të vijimit të metodologjisë së vlerësimit, rezultoi se edhe opozita pati një klasifikim të efikasitetit të vet parlamentare.

Konkretisht, tabela dëshmon se nga deputetët e PD dhe lista e saj proporcionale, ku bënin pjesë edhe katër kryetarë të partive të vogla) deputetët me vlerësimin më të lartë pozitiv janë Albana Vokshi dhe Jorida Tabaku, secila me 36 pikë në momentin e vlerësimit të deputetëve. Ato kanë qenë edhe deputetët më të vlerësuar në raportet e mëparshme të ISP mbi parlamentin, një tregues i qëndrueshmërisë së tyre profesionale, por edhe profesionalizmit në metodologjinë dhe vlerësimin e bërë nga ISP.



KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE TË PARTISË DEMOKRATIKE (JANAR-SHKURT 2019)

NR	EMRI DHE MBIEMRI	TOTAL	NR	EMRI DHE MBIEMRI	TOTAL
01	ALBANA VOKSHI	36	21	FATMIR MEDIU	12
01	JORIDA TABAKU	36	21	HEKURAN HOXHOLLI	12
03	ERVIN SALIANJI	23	21	LORENC LUKA	12
03	GRIDA DUMA	23	24	ALDO BUMÇI	11
05	ENKELEJD ALIBEAJ	20	24	FATBARDHA KADIU	11
06	EDMOND SPAHO	19	24	FLORJON MIMA	11
06	ENDRI HASA	19	24	LUAN BAÇI	11
08	KLEVIS BALLIU	18	28	AGRON SHEHAJ	10
09	ROMEO GURAKUQI	17	28	FLAMUR NOKA	10
10	BARDH SPAHIA	16	28	ISUF ÇELAJ	10
10	DHURATA ÇUPI	16	28	IZMIRA ULQINAKU	10
10	OERD BYLYKBASHI	16	28	NADIRE MEÇORAPAJ	10
10	XHEMAL GJUNKSHI	16	28	SALI BERISHA	10
14	LINDITA METALIAJ	15	34	ASTRIT VELIAJ	9
15	ANDON FRROKAJ	14	34	GENC POLLO	9
15	LUÇIANO BOÇI	14	34	GENT STRAZIMIRI	9
15	TRITAN SHEHU	14	34	HALIM KOSOVA	9
18	DASHAMIR SHEHI	13	34	VANGJEL DULE	9
19	ORJOLA PAMPURI	13	39	NARD NDOKA	7
20	VALENTINA DUKA	13	40	EDI PALOKA*	4

Shënim: Jashtë listës është lënë kryetari i PD Lulzim Basha, i cili nuk merr pjesë në komisionet parlamentare, si dhe deputetët që refuzuan të dorëzojnë mandatin e deputetit. Gjithashtu deputeti Edi Paloka, duke qënë i penalizuar nga Kuvendi me masë disiplinore (-5 pikë), rezultoi me rezultat negativ në vlerësimin e përgjithshëm.

Në vendet vijuese patën rritje deputetët Ervin Salianji dhe Grida Duma, secili me nga 23 pikë. Juristi Enkelejd Alibeaj vijon në klasifikim me 20 pikë, shumë afër tre deputetëve të tjerë, kryetarit të grupit Edmond Spaho, si dhe deputetëve të rinj të vitit 2017, Endri Hasa dhe Klevis Balliu. Këta të dy të fundit përfituan edhe nga vlerësimi në klasifikim për shkak të përdorimit të së drejtës për kërkesa për informim adresuar institucioneve në emër të parlamentit, praktikë që ndoqën edhe të gjithë deputetët e tjerë të mësipërm, me përjashtim të Alibeaj. Rritje në renditje shënuan dy deputetët e Shkodrës, Romeo Gurakuqi dhe Bardh Spahia, si dhe deputetja Dhurata Çupi, ish-kryetare e Aleancës së Grave deputete.



6.5. JASHTË PARLAMENTIT: TABAKU DHE VOKSHI, DEPUTETET MË AKTIVE

Në mungesë të opozitës në Kuvend, stafi i ISP monitori edhe ecurinë e aktivitetit të deputetëve të PD në jetën joparlamentare, duke marrë për bazë të dhënat zyrtare të faqes online të Partisë Demokratike gjatë periudhës shkurt – gusht 2019.

Sipas këtyre të dhënave, një pjesë e deputetëve kanë qenë shumë më aktivë sesa të tjerët, pavarësisht se vendimi për të folur në emër të PD, për të bërë deklarime publike apo për t'u promovuar në faqen zyrtare të subjektit, është më shumë një vendim politik i titullarëve të subjektit, sesa një zgjedhje personale.

Në një farë mënyrë kjo tabelë mund të lexohet jo vetëm si kontribut personal i deputetëve, por edhe si lista preferenciale e PD për prezantim publik në nivel politikanësh. Jashtë listës janë lënë fjalimet në mitingje, si dhe kryetari Lulzim Basha dhe figura të tjera të rëndësishme të kësaj partie, të cilët nuk kanë qenë deputetë dhe që janë staf i ri drejtues i saj.

Siç rezulton edhe nga tabela, ish-deputetet Jorida Tabaku (11) dhe Albana Vokshi (10) janë emrat më aktivë, më të artikuluar dhe më përfaqësues në të gjithë

listën e ish- deputetëve të kësaj partie. Ato kanë një numër të madh daljesh publike, e para për ekonominë dhe e dyta për çështjet sociale. Në vendin e tretë është ish- deputeti Ervin Salianji, i fokusuar më shumë tek çështjet e rendit, hetimeve ndaj skandaleve të ndryshme dhe problematika të zonës elektorale.

Deklarime të shumta politike kanë bërë dy nënkryetarët e PD Edmond Spaho e Edi Paloka, duke qenë së bashku në kuotat e 11 angazhimeve publike në emër të PD. Enkelejd Alibeaj ka qenë aktiv në lidhje me drejtësinë dhe çështjet e kriminalitetit, Endri Hasa dhe Luçiano Boçi vijnë të jenë të artikuluar sidomos në çështjet e arsimit, etj. Nga deputetët e "rretheve" në listë janë promovuar vetëm Izmira Ulqinaku, Agron Shehaj, Xhemal Gjunkshi dhe Dhurata Çupi. Të gjithë ish deputetët e tjerë të PD nuk kanë rekorde të daljeve publike dhe zyrtare në emër të PD dhe nuk janë përfshirë në publikimet zyrtare të PD në faqen e saj të internetit.

KLASIFIKIMI I ISH DEPUTETËVE BAZUAR NË DALJET ZYRTARE NË EMËR TË PD (MARS-GUSHT 2019)		
NR	EMRI I ISH DEPUTETIT/ES	DEKLARATA ZYRTARE
01	JORIDA TABAKU	11
02	ALBANA VOKSHI	10
03	ERVIN SALIANJI	8
04	EDMOND SPAHO	6
05	EDI PALOKA	5
06	ENKELEJD ALIBEAJ	4
07	ENDRI HASA	3
08	LUÇIANO BOÇI	3
09	ORIONA PAMPURI	3
10	IZMIRA ULQINAKU	2
11	GENC STRAZIMIRI	2
12	OERD BYLYKBASHI	2
13	GRIDA DUMA	2
14	AGRON SHEHAJ	2
15	ALDO BUMÇI	1
16	DHURATA ÇUPI	1
17	XHEMAL GJUNKSHI	1



6.6. LSI PA SURPRIZA: HIERARKIA PARTIAKE KA EFEKTIVITET MË TË LARTË

Renditja e deputetëve të LSI sipas treguesve të nivelit të efektivitetit nuk ofron surpriza, pasi në përgjithësi të njëjtit politikanë të suksesshëm edhe në renditjet e sesioneve të mëparshme, vijojnë të jenë të suksesshëm edhe në renditjen e periudhës janar-shkurt 2019. Po ashtu deputetët me vlerësim minimal vijojnë të jenë të njëjtët që janë evidentuar edhe në raportimet e mëparshme të ISP gjatë 2017-2018.

KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE TË LËVIZJA SOCIALISTE PËT INTEGRIM		
NR	EMRI DHE MBIEMRI	TOTAL PIKË
01	PETRIT VASILI	32
02	ENDRIT BRAIMLLARI	26
03	KEJDI MEHMETAJ	25
04	FLOIDA KERPAÇI	21
05	MONIKA KRYEMADHI*	18
06	KLAJDA GJOSHA	16
07	SILVA CAKA	16
08	LUAN RAMA	15
09	NORA MALAJ	15
11	EDMOND PANARITI	15
12	EDMOND HAXHINASTO	14
10	NASIP NAÇO	13
13	SEZAI ROKAJ	11
14	VIKTOR TUSHAJ	11
15	PERPARIM SPAHIU	8
16	AGRON ÇELA	5
17	VANGJEL TAVO	5

Shënim: Jashtë listës është lënë deputeti Koka, i cili refuzoi dorëzimin e mandatit, ndërkohë që kryetarja e LSI, Kryemadhi, nuk merr pjesë në komisionet e parlamentit

Konkretisht, Petrit Vasili, Endrit Braimllari dhe Kejdi Mehmetaj vijuan të ishin deputetët më aktivë në parlament gjatë periudhës janar-shkurt 2019. Ish-deputeti Vasili ka avantazhin ndaj deputetëve të tjerë sepse është i vetmi që inicioi një interpelancë parlamentare me Ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, duke marrë vlerësim maksimal në këtë komponent vlerësimi dhe duke bërë diferencën me emrat ndjekës. Gjithashtu ish-deputeti Braimllari ishte i vetmi që adresoi një kërkesë për informacion në cilësinë e deputetit, një tregues tjetër vlerësimi për aktivitetin parlamentar.

Në fund të listës, me përjashtim të deputetit Lefter Koka, i cili vijoi të ishte në parlament edhe pas largimit të partisë së tij politike, ndodhen edhe deputetët e tjerë të përhershëm, Agron Çelaj, Vangjel Tavo, Viktor Tushaj, etj, të njëjtë edhe në vlerësimet e mëparshme klasifikuese të stafit monitorues të ISP.



6.7. GRUPI “DEMOKRAT” – MURRIZI DHE HAJDARI FIGURAT DOMINUESE

Aktiviteti i dy deputetëve Myslim Murrizi dhe Rudina Hajdari gjatë sesionit të fundit parlamentar vjen në kontrast të thellë me aktivitetin e tyre të mëparshëm parlamentar. Ata kanë qenë në listën e deputetëve më aktivë në debatet parlamentare dhe publike gjatë muajve të fundit, me një kurbë angazhimi në rritje të pakrahasueshme me përvojën apo angazhimin modest parlamentar në sesionet e kaluara. Dy deputetët refuzuan vendimin politik të PD për dorëzimin e mandateve parlamentare dhe iu bashkuan apelit të disa prej partnerëve tanë kryesorë ndërkombëtar për vijimin e aktivitetit parlamentar. Ndërkohë, ata në tërësinë e tyre përbëjnë grupin politik më opozitar në parlament, sidomos gjatë ligjërimin publik në komisione dhe në seancat plenare.

Pjesa tjetër e grupit “Demokrat”, ndonëse më shumë në sasi sesa në cilësi, ka gjithashtu angazhim më të lartë se mesatarja e deputetëve të rinj, sidomos deputetët Fatjona Dhimitri e Korab Lita, të cilët mbajnë edhe funksione drejtuese përkatësisht në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit si dhe në Komisionin e Çështjeve Ligjore në Kuvend. Disa prej tyre janë edhe pjesë e komisioneve Ad Hoc të ngritura nga parlamenti, përfshirë bashkëdrejtimi i Komisionit për Reformën Zgjedhore, si dhe në Komisionin Hetimor ndaj Presidentit të Republikës.

KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE TË GRUPIT “DEMOKRAT” SIPAS EFIKASITETIT			
JANAR-GUSHT 2019			
NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	TOTAL
01	MYSLIM MURRIZI	DEM	63,6
02	RUDINA HAJDARI	DEM	62
03	FATJONA DHIMITRI	DEM	30
04	KORAB LITA	DEM	28,4
05	ALBAN ZENELI	DEM	27
06	HALIT VALTERI	DEM	25
07	ARBEN ELEZI	DEM	24,2
08	HALIL JAKIMI	DEM	25
09	ARLIND ÇAÇANI	DEM	15

6.8. DEPUTETËT PA GRUP PARLAMENTAR: VETËM 50% AKTIVË

Përbërja dhe vlerësimi i bashkimit jo zyrtar të deputetëve “pa grup” parlamentar është interesante në disa aspekte. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe deputetë me përvojë parlamentare, siç janë Lefter Koka dhe Tom Doshi, të dy të zgjedhur më 2017 përkatësisht nga LSI e PSD; deputetët Elena Xhina dhe Reme Lala, të dyja të zgjedhura më 2017 në emër të PDIU, deputeti Gjetan Gjetani, i zgjedhur nga PS më 2017. Gjithashtu në këtë kategori bëjnë pjesë edhe një numër i madh deputetësh të rinj, të ardhur për herë të parë parlament, përfshirë 6-7 kryetarë të partive të vogla politike. Pra, përbërja e tij është e larmishme dhe pa identitet politik.

Siç rezulton edhe nga tabela, në kategorinë e deputetëve pa grup parlamentar deputetët më aktivë dhe me nivel më të lartë angazhimi janë Lefter Maliqi, Elena Xhina dhe Artur Roshi. Deputeti Maliqi është i



vetmi që ka iniciuar dy interpelanca parlamentare, si dhe ka pasur angazhim të vazhdueshëm në pothuajse të gjitha mediumet e aktivitetit parlamentar. Elena Xhina ka pasur rol konstant aktiv në Komisionin e Ligjeve dhe në strukturat e tjera parlamentare, si dhe ka shënuar kurba pozitive angazhimi nga sesioni në sesion parlamentar.

Në këtë listë bëjnë pjesë edhe deputetë të rinj që kanë bërë headline në media me deklaratat publike apo ato në seancat parlamentare, por që përveç deklarimeve publike kanë arritur të kenë bilanc më të reduktuar në tërësinë e aktivitetit ligjvënës dhe parlamentar. Në fundin e listës bëjnë pjesë emra shumë të njohur në politikën shqiptare, përfshirë ish ministri Lefter Koka apo deputeti Tom Doshi, si dhe prurja e re, Erion Piciri, i cili më 2017 ishte një prej kandidatëve aspirues për postin e kryetarit të PD në zgjedhjet e brendshme të kësaj partie.

KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE "PA GRUP" SIPAS EFIKASITETIT							
JANAR-GUSHT 2019							
NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	TOTAL	NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	TOTAL
01	LEFTER MALIQI	PA GRUP	45	12	NIKOLIN STAKA	PA GRUP	18
02	ELENA XHINA	PA GRUP	41,4	13	ELDA HOTI	PA GRUP	17,7
03	ARTUR ROSHI	PA GRUP	36,5	14	GJETAN GJETANI	PA GRUP	17
04	VASIL STERJOVSKI	PA GRUP	34	15	REME LALA	PA GRUP	17
05	ANDI PERMETI	PA GRUP	32,8	16	SUZANA TOPI	PA GRUP	16
06	LIGORAQ KARAMELO	PA GRUP	30	17	KLAJDI QAMA	PA GRUP	15
07	KUJTIM GJUZI	PA GRUP	29	18	EDMOND RRUSHI	PA GRUP	14
08	EUGEN BOJAXHI	PA GRUP	19	19	EDMOND STOJKU	PA GRUP	14
09	KRENAR RRYÇI	PA GRUP	19	20	TOM DOSHI	PA GRUP	13
10	BESNIK TROPLINI	PA GRUP	18,1	21	LEFTER KOKA	PA GRUP	11
11	MAJLINDA HALILAJ	PA GRUP	18	22	ERION PICIRI	PA GRUP	10

Fakti se deputetë me përvojë parlamentare si dy emrat e mësipërm, nuk kanë bilanc pozitiv të angazhimit parlamentar është tregues sa i imazhit të deformuar sesi një pjesë e politikës e koncepton parlamentin aq edhe i karrierës së sigurt të ndërtuar në lidhjet e personalizuara me liderit politikë ose me zonat lokale bastione të tyre.



6.9. GRUPI I “PAVARUR”: DY TË TRETAT E TYRE MBTEN AKTIVË

Nga deputetët e grupit të “Pavarur”, ku bëjnë pjesë 9 deputetë të listës shumëmemërore të LSI në fushatën elektorale të vitit 2017, ka një numër deputetësh mjaft aktivë.

Përveç deputetit me treguesit më efikasë në debatin parlamentar (Ralf Gjoni), mjaft aktivë kanë qenë edhe deputetët Enver Roshi (drejtues i një komisioni parlamentar), kryetari i grupit Nimet Musaj, si dhe deputetët Aurora Mara, Ediola Braha e Edlira Hyseni, të cilat gjithashtu kanë pasur aktivitete më cilësore sesa një pjesë e mirë e grave deputete që bëjnë pjesë në parlament prej fillimit të legjislaturës në shtator 2017.

KLASIFIKIMI I GRUPIT PARLAMENTAR “I PAVARUR” 2019			
NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	TOTAL
01	RALF GJONI	PAV	48
02	ENVER ROSHI	PAV	29,5
03	NIMET MUSAJ	PAV	32
04	AURORA MARA	PAV	29
05	EDIOLA BRAHA	PAV	28,4
06	EDLIRA HYSENI	PAV	28,1
07	YLLI SHEHU	PAV	18
08	AMRA BAROVA	PAV	6
09	ENADA KAPLLANI	PAV	5





7. DEBATET PARLAMENTARE: KLASIFIKIMI DHE OBJEKTI I LIGJËRIMIT


Në aktivitetin parlamentar deputetët kryejnë disa funksione e detyra, por vendimmarrja përmes votës në parlament dhe mënyra sesi ata paraqiten në seancat e debatit, përpara publikut, merr rëndësi të veçantë. Një tregues i matshëm i këtij kriteri është angazhimi i tyre në fjalime politike dhe lidhur me to, edhe cilësia e fjalimeve, cilësia e ligjërimit dhe objekti i debateve parlamentare.

Në praktikën shqiptare seancat plenare transmetohen live në një pjesë të mirë të mediave informative, si dhe mund të shihen live edhe përmes disa mediave online. Gjatë sesionit të fundit parlamentar ka pasur 24 seanca plenare, por partitë e opozitës morën pjesë vetëm në seancat e periudhës janar-shkurt 2019. Ka seanca, të cilat kanë një objekt vendimmarrje procedurale, e cila nuk lejon një numër të madh deputetësh diskutantë.

Stafi i ISP ka monitoruar seancat plenare dhe ka kalkuluar numrin e fjalimeve për çdo deputet, sipas grupit dhe forcës politike që përfaqësojnë, duke përfshirë deputetët me mandat të plotë, ata që dorëzuan mandatet, ata që u dorëhoqën dhe ata që erdhën pas tyre.

7.1. FJALIMET: DOMINUESE POLITIKA E DITËS, VETËM 23 FJALIME PËR ELEKTORATIN


“Fjalime” janë konsideruar jo replikat e momentit, por fjalimet e plota dhe ndërhyrjet problematika në seancat plenare. Referuar të dhënave të mbledhur nga të gjithë deputetët e ish-deputetët e sesionit aktual parlamentar, përfshirë ministrat në qeveri, rezultojnë se 111 fjalime kanë qenë 100% brenda axhendës parlamentare dhe 35 fjalime kanë qenë 100% jashtë axhendës ditore parlamentare.



Në shumicën e fjalimeve kanë dominuar retorikat e konsumit mbi zhvillimet politike të ditës (98 raste), dhe vetëm në 20 raste deputetët kanë folur për problematika të zonës së tyre elektorale. Në 13 raste deputetët e kanë kërkuar fjalën për replika personale dhe në 8 raste për procedurën e rendit të ditës. Gjatë seancës së lirë prej 60 minutash kanë diskutuar kryesisht vetëm 14 deputetë (disa më shumë se njëherë), ndërkohë që në 21 raste ka pasur akuza politike rivalëve në sallë ose jashtë saj, si dhe në 5 raste të fjalimeve ka pasur fyerje e sharje personale midis deputetëve.

Kurba e fjalimeve ka ndryshuar në varësi nga ndryshimet në përbërjen e parlamentit. Gjatë prezencës së opozitës në parlament, dominuese ishin fjalimet akuzuese dhe denigruese ndaj palëve politike, por me dorëzimin e mandateve nga opozita, parlamenti nuk shënoi asnjë rast të masës disiplinore ndëshkuese për gjuhën e përdorur në parlament nga deputetët e vjetër dhe ata të rinj. Në një rast, kryetari i seancës kritikoi ligjërimin e një deputeti të opozitës së re ndaj familjes së Presidentit, kritikë që u pranua më pas edhe nga vetë deputeti. Ndërkohë, shumica e fjalimeve në parlament, sidomos në rastet e replikave apo fjalimeve kundërvënëse politike, janë bazuar në raportimet e medias, zhvillime politike të ditës, raporte ndërkombëtare apo histori politike, në tërësi brenda një kuadri të pranueshëm etik komunikimi.

Mbetet interesant fakti se gjatë sesionit të kaluar parlamentar më shumë ka pasur debate për statutet në rrjetet sociale të kryeministrit apo kryetarit të opozitës e ish-kryeministrit, sesa debate mbi nivelin e varfërisë në vend dhe rrugëzgjdhjet e mundshme të saj. Interesant është gjithashtu fakti se ndonëse PD dhe LSI nuk janë të pranishme në parlament dhe as në pushtetin lokal, mazhoranca parlamentare vijon t'i dedikojë rreth 30% të diskutimeve dhe fjalimeve të tyre replikave e sulmeve ndaj opozitës jashtë parlamentit.



Gjatë muajve të fundit të sesionit parlamentar pati përpjekje të shumta të deputetëve të rinj për të qenë aktivë në debatet në seancat plenare, kryesisht edhe për shkak të rëndësisë vizive dhe publike të këtyre seancave, siç pati edhe akuza midis tyre në mediat e ndryshme mbi të qenit opozitë reale apo joreale. Në ndarjen e fjalimeve politike në seancat plenare sipas grupeve parlamentare rezulton se secili prej tri grupeve kryesore, PS, DEMOKRAT dhe I PAVARUR kanë pasur deputetë që kanë folur si individë dhe si

përfaqësues të grupimit. E drejta e përfaqësimit të grupimit është e lidhur me procedurat parlamentare dhe sigurohet në Rregulloren e Kuvendit. Nga tabela rezulton se tek PS ka pasur 58 nga 290 fjalime politike në emër të grupit/komisionit, tek grupi “Demokrat” ka pasur 4 nga 57 fjalime, tek grupimi i pavarur ka pasur 4 nga 30 fjalime politike. Tek grupimi më i ri, ai i Partive të Djathta nuk ka pasur fjalime politike në emër të grupimit, ndërkohë që në rreth 22 deputetët pa grup parlamentar është e pritshme të mos ketë identifikim politik dhe për pasojë, as fjalime politike në emër të grupimit.

7.2. REKORD FJALIMESH NË SEANCË: BALLA, MURRIZI DHE DHIMA

Tabela e fjalimeve të deputetëve gjatë seancave plenare janar - korrik 2019, tregon se 12 deputetë kanë pasur më shumë se 10 fjalime, nga të cilët, deputetët kryesues të listës janë kreu i grupit të PS Taulant Balla me 19 fjalime, nga të cilat 5 në emër të grupit dhe 14 individuale; ish deputeti i PD tashmë zëvendëskryetar i Kuvendit Myslim Murrizi me 15 fjalime, ku të gjitha janë fjalime individuale, si dhe deputetja e PS Fier Antoneta Dhima me 14 fjalime, nga të cilat 10 janë në emër personal dhe 4 fjalime në emër të grupit të saj parlamentar.

RENDITJA E DEPUTETËVE SIPAS NUMRIT TË FJALIMEVE NË SEANCAT PLENARE			
<i>NUMRI RENDITJA</i>	<i>EMRI DHE MBIEMRI</i>	<i>GRUPI POLITIK</i>	<i>FJALIME NË TOTAL (NË EMËR TË GRUPIT)</i>
01	TAULANT BALLA	PS	19 (5)
02	MYSLYM MURRIZI	DEM	15 (0)
03	ANTONETA DHIMA	PS	14 (4)
04	KLOTILDA BUSHKA	PS	12 (5)
05	RUDINA HAJDARI	DEM	11 (4)
06	ERVIN BUSHATI	PS	11 (1)
07	EVIS KUSHI	PS	11 (2)
08	KORAB LITA	DEM	10 (0)
09	BLERINA GJYLAMETI	PS	10 (1)
10	ELONA GJEBREA	PS	10 (1)
11	ILIR BEQAJ	PS	10 (0)
12	VASILIKA HYSI	PS	10 (3)
13	ARBEN AHMETAJ	PS	9 (1)
14	HALIT VALTERI	DEM	8 (0)
15	ANDI PERMETI	PA GRUP	8 (0)
16	KUJTIM GJUZI	PA GRUP	8 (0)
17	LEFTER MALIQI	PA GRUP	8 (0)
18	ENVER ROSHI	PAV	8 (1)
19	RALF GJONI	PAV	8 (0)
20	ALKET HYSENI	PS	8 (2)
21	BESNIK BARAJ	PS	8 (5)
22	ERMONELA FELAJ	PS	8 (1)
23	SENIDA MESI	PS	8 (1)



Në listën vijuese të deputetëve më me shumë fjalime (mbi 8 fjalime) bëjnë pjesë edhe Klotilda Bushka (PS), e cila ka 12 fjalime nga të cila 5 në emër të grupit parlamentar, Rudina Hajdari me 11 fjalime, nga të cilat 4 në emër të grupit, si dhe Evis Kushi e PS me 11 fjalime, nga të cilat vetëm 2 janë në emër të grupit. Deputeti Ilir Beqaj ka 10 fjalime individuale, pa fjalime në emër të grupit, kurse Elona Gjebrea, Blerina Gjylameti e Vasilika Hysi kanë gjithashtu nga 10 fjalime, por respektivisht me 2 dhe 3 fjalime në emër të grupit.

Interesant është fakti se në listën e deputetëve më aktivë në fjalimet parlamentare bëjnë pjesë Korab Lita (10 fjalime), Halit Valteri (8 fjalime), Andi Përmeti (8 fjalime), Kujtim Gjuzi (8 fjalime), Enver Roshi (8 fjalime), Lefter Maliqi (8 fjalime) dhe Ralf Gjoni (8 fjalime), të gjithë prurje të reja në parlament gjatë periudhës mars-qershor 2019, pra në pamundësi për të qenë pjesëmarrës në 24 seancat plenare, si pjesa tjetër e deputetëve në listën e më aktivëve në parlament.

Lista e deputetëve me më shumë fjalime, të bashkuara si fjalime individuale dhe fjalime në emër të grupeve, është e pasqyruar më e plotë në tabelën e mëposhtme. Pjesë e klasifikimit janë vetëm deputetët e mazhorancës dhe ata të rinj, përfshirë 3 deputetët e opozitës që nuk dorëzuan mandatin parlamentar. Në grupin e mazhorancës janë përfshirë edhe deputetët që në mesin e muajit maj dhanë dorëheqje për shkak se kandiduan në zgjedhjet lokale për kryetar bashkie.

7.3. DEPUTETËT QË NUK FLASIN: LISTA E PLOTË ME 22 EMRAT E “HESHTUR”

Krahas listës së deputetëve më aktivë në debatet parlamentare, merr vlerë edhe lista e deputetëve më pak aktivë, dhe konkretisht, lista e deputetëve që nuk kanë mbajtur asnjë fjalim në 24 seancat plenare ku kanë marrë pjesë plotësisht apo pjesërisht.

Në listë bëjnë pjesë kryesisht deputetë të rinj të ardhur rishtas në parlament dhe pa përvojë parlamentare, por bie në sy dukshëm ekzistenca në listë e disa deputetëve me më shumë se dy mandate parlamentare, të cilët bëjnë pjesë tek “të heshturit” në parlament gjatë 2019. Të tillë janë sidomos deputetët Tom Doshi e Lefter Koka, Ylli Shehu e Anduel Xhindi, Paulin Sterkaj e Andrea Marto, si dhe “prurjet” e reja të PS më 2017, deputetët Rrahman Rraja e Ilir Ndraxhi dhe Gjetan Gjetani.

Nga deputetët e rinj të ardhur gjatë pranverës në parlament gjenden kryesisht emra pa përvojë parlamentare, por me përvojë në partitë e vogla politike ose në angazhime të tjera ekzekutive dhe publike. Midis emrave bën pjesë edhe deputeti Adriatik Alimadhi, i cili ka pasur një replikë në parlament, por që zyrtarisht figuron si deputet pa fjalime në parlament.

DEPUTETËT QË NUK FOLËN NË SEANCAT PLENARE TË VITIT 2019			
NUMRI RENDITJA	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	FJALIME NË TOTAL (NË EMËR TË GRUPIT)
01	ALBAN ZENELI	DEM	0 (0)
02	EDMOND RRUSHI	PA GRUP	0 (0)
03	EDMOND STOJKU	PA GRUP	0 (0)



04	EUGEN BOJAXHI	PA GRUP	0 (0)
05	GJETAN GJETANI	PA GRUP	0 (0)
06	LEFTER KOKA	PA GRUP	0 (0)
07	NIKOLIN STAKA	PA GRUP	0 (0)
08	TOM DOSHI	PA GRUP	0 (0)
09	AMRA BAROVA	PAV	0 (0)
10	ENADA KAPLLANI	PAV	0 (0)
11	YLLI SHEHU	PAV	0 (0)
12	ADRIATIK ALIMADHI	PeD	0 (0)
13	KOÇI TAHIRI	PeD	0 (0)
14	RAMAZAN GJUZI	PeD	0 (0)
15	ANDREA MARTO	PS	0 (0)
16	ANDUEL XHINDI	PS	0 (0)
17	ARDIT KONOMI	PS	0 (0)
18	ARTEMIS DRALO	PS	0 (0)
19	ELIO HYSKO	PS	0 (0)
20	ILIR NDRAXHI	PS	0 (0)
21	PAULIN STERKAJ	PS	0 (0)
22	RRAHMAN RRAJA	PS	0 (0)

7.4. FJALIMET NË EMËR TË GRUPEVE, SI SPONSORIZIM POLITIK

Në praktikat e punës së grupeve parlamentare disa prej deputetëve përzgjidhen për t'u promovuar publikisht. Kjo bëhet e mundur përmes caktimit të relatorëve të nismave të ndryshme, sidomos atyre politike, si dhe delegimi i të drejtës për të folur në seancë plenare në emër të grupit ose të komisionit parlamentar.

Tradicionalisht praktika të tilla ndihmojnë deputetët në nisje të karrierës për t'u promovuar, si dhe për të krijuar një imazh të kontrolluar pozitiv publik për partinë respektive. Në rastin tonë, në mungesë të opozitës parlamentare, fjalimet në emër të grupeve parlamentare nuk kanë më rëndësinë dhe vlerën e duhur mediatike, megjithatë na ndihmojnë të krijojmë trendin e vlerësimit brenda grupeve më të mëdha parlamentare.

Konkretisht, tabela paraqet rastet kur deputetët kanë mbajtur fjalime në emër të grupeve parlamentare, pra fjalime politike në emër të forcës politike që përfaqësojnë në parlament. Në listë kryeson kryetari i grupit të PS me 5 fjalime në emër të grupit të tij, por po kaq kanë edhe dy deputetë të tjerë të mazhorancës, Klotilda Bushka dhe Besnik Baraj. Në vijim, krahas deputetes Rudina Hajdari, e cila drejton tashmë një grupim të ri parlamentar, të promovuar në emër të grupit të PS janë edhe deputetët Antoneta Dhima e Sadi Vorpsi me nga 4 fjalime, Englantina Gjermeni e Vasilika Hysi me nga 3 fjalime, si dhe Evis Kushi, Alket Hyseni, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Ardiana Jaku e Robert Bitri me nga 2 fjalime.

Ndonjë prej tyre ka mbajtur gjithsej vetëm aq fjalime sa i janë caktuar në emër të grupit, pra nuk ka arritur si individ të mbajë fjalime personale. Në listë bën pjesë edhe kreu i grupit të tretë parlamentar, grupit të "Pavarur", Nimet Musaj, me 3 fjalime në emër të grupit për një periudhë gati 2-3 mujore.



Tabela bashkëngjitur paraqet diferencat midis përqindjes së fjalimeve të deputetëve si individë me përqindjen e fjalimeve në emër të grupit parlamentar ose partisë politike përkatëse.


Siç shihet nga të dhënat, 85% e fjalimeve kanë qenë fjalime individuale, pra meritë dhe angazhim i vetë deputetëve, ndaj vetëm 15% të fjalimeve në emër të forcës politike ose grupit parlamentar.

Në raport me sesionin e njëjtë parlamentar të vitit 2018 ku rivaliteti midis PS e PD ishte shumë më i madh dhe vetë jeta politike ishte më konfliktuale e më konkurruese, kemi 10% më shumë fjalime individuale dhe për rrjedhojë, edhe 10% më pak fjalime në emër të grupit parlamentar ose forcës politike në Kuvend.

RENDITJA E DEPUTETËVE SIPAS NUMRIT TË FJALIMEVE NË EMËR TË GRUPIT


NUMRI RENDITJA	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	NË EMËR TË GRUPIT
1	TAULANT BALLA	PS	5
2	KLOTILDA BUSHKA	PS	5
3	BESNIK BARAJ	PS	5
4	ANTONETA DHIMA	PS	4
5	RUDINA HAJDARI	DEM	4
6	SADI VORPSI	PS	4
7	EGLANTINA GJERMENI	PS	3
8	VASILIKA HYSI	PS	3
9	NIMET MUSAJ	PAV	3
10	EVIS KUSHI	PS	2
11	ALKET HYSENI	PS	2
12	ULSI MANJA	PS	2
13	XHEMAL QEFALIA	PS	2
14	ARDIANA JAKU	PS	2
15	ROBERT BITRI	PS	2

RAPORTI MIDIS FJALIMEVE INDIVIDUALE DHE ATYRE NË EMËR TË GRUPEVE



7.5. GRATË DEPUTETE: 8% - 19% MË AKTIVE SESA PËRQINDJA QË ZËNË NË KUVEND

Një tregues interesant i fjalimeve të deputetëve në parlament është edhe raporti gjinor i angazhimit. Nga të dhënat krahasuese rezulton se gratë deputete kanë shumë më tepër angazhim në rastet kur flasin në emër të grupit parlamentar ose komisionit parlamentar, sesa kur marrin nisma personale për fjalime. Në numrin total të fjalimeve gratë deputete zënë 36% nga vetëm 28% të grave deputete (pa llogaritur ministrat). Pra, gratë deputete kanë pasur 8% më shumë fjalime sesa pesha e tyre e përfaqësimit parlamentar. Në kategorinë e fjalimeve si individë, gratë deputete kanë 2% më pak angazhim sesa në numrin total të fjalimeve.



Në fjalimet në emër të grupit gratë deputete zënë përqindje më të lartë, 47%, pra 19% më shumë sesa përqindja e grave deputete në parlament. Fakti se gratë deputete preferohen më shumë nga kryetarët e grupeve për t'u besuar fjalimet në emër të grupit ose komisioneve lidhet me disa faktorë, ku më kryesori është përpjekja e partive në parlament për të promovuar gratë deputete, si dhe vetë natyra e fjalimeve të tyre, e cila dominohet më shumë nga argumenti dhe referimi në Rregullore sesa në ligjërim të ashpër politik ndaj palës tjetër politike.

7.6. FJALIMET PERSONALE: SUPRIZOJNË MURRIZI, DHIMA, BEQJA + 7 DEPUTETËT E RINJ

Duke hequr numrin e fjalimeve politike në emër të grupit, pra të fjalimeve formale që shprehin një pikëpamje kolektive të porositur më parë, tabela më poshtë paraqet numrin e fjalimeve individuale në parlament, pra nismat personale të deputetëve për të folur në seancat plenare.



Nga tabela rezulton se katër emra përbëjnë surprizë dhe ndryshim nga bilanci i mëparshëm parlamentar: deputeti Myslim Murrizi me 15 fjalime, Antoneta Dhima me 14 fjalime, si dhe Korab Lita e Ilir Beqja me nga 10 fjalime. Deputetët e tjerë Taulant Balla, Ervin Bushati, Evis Kushi, Elona Gjebrea, Blerina Gjylameti, Arben Ahmetaj, etj, kanë pasur bilanc të lartë të angazhimeve në fjalime parlamentare edhe në sesionet e tjera të legjislaturës aktuale.

Në listën surprizë të klasifikimit të deputetëve me fjalime individuale, bëjnë pjesë edhe disa deputetë të tjerë të rinj, si Halit Valteri, Andi Përmeti, Kujtim Gjuzi, Lefter Maliqi e Ralf Gjoni, secili me nga 8 fjalime.

Pavarësisht se fjalimet nuk janë tregues direkt i bilancit parlamentar dhe aftësisë së deputetëve për të përmbushur përgjegjësitë e tyre politike e publike, fakti se deputetë krejt pa përvojë politike dhe parlamentare brenda pak muajsh kanë

krijuar bilanc numerik shumë më të lartë se një numër i madh deputetësh me përvojë të gjatë politike, është tregues jo i meritës individuale, por edhe i nevojës së vetë Kuvendit për të promovuar “zërat e rinj”, si një formë e opozitës së re në parlament.

7.7. FJALIMET E PD? BASHA DHE BERISHA ISHIN FOLËSIT KRYESORË

Tabela mbi numrin e fjalimeve që mbajtën deputetët e opozitës në periudhën e shkurtër janar-shkurt 2019, tregon se liderit kryesorë politikë vijuan të ishin edhe oratorët kryesorë. Kështu, kryetari i PD Lulzim Basha ka 4 fjalime, një më shumë se ish kryetari Sali Berisha dhe aleati i tij në PR, Fatmir Mediu. Pas tyre janë 15 deputetë me nga 2 fjalime, përfshirë edhe kreu i grupit parlamentar Edmond Spaho dhe aleati politik Dashamir Shehi.

Vetëm tre deputetë kanë nga një fjalim në parlament gjatë seancave të pakta plenare të janarit dhe të shkurtit, ndërkohë që pjesa tjetër e deputetëve nuk ka fjalime në parlament.

RENDITJA E DEPUTETËVE SIPAS NUMRIT TË FJALIMEVE INDIVIDUALE			
NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI	FJALIME
1	MYSLYM MURRIZI	DEM	15
2	TAULANT BALLA	PS	14
3	ANTONETA DHIMA	PS	10
4	ERVIN BUSHATI	PS	10
5	KORAB LITA	DEM	10
6	ILIR BEQAJ	PS	10
7	EVIS KUSHI	PS	9
8	BLERINA GJYLAMETI	PS	9
9	ELONA GJEBREA	PS	9
10	ARBEN AHMETAJ	PS	8
11	HALIT VALTERI	DEM	8
12	ANDI PERMETI	PA GRUP	8
13	KUJTIM GJUZI	PA GRUP	8
14	LEFTER MALIQI	PA GRUP	8
15	RALF GJONI	PAV	8



NUMRI I FJALIMEVE TË DEPUTETËVE TË PD
(JANAR – SHKURT 2019)

NR	EMRI & MBIEMRI	GRUPI	FJALIME	NR	EMRI & MBIEMRI	GRUPI	FJALIME
1	LULZIM BASHA	PD	4	22	AGRON SHEHAJ	PD	0
2	FATMIR MEDIU	PD	3	23	ASTRIT VELIAJ	PD	0
3	SALI BERISHA	PD	3	24	DHURATA ÇUPI	PD	0
4	ALBANA VOKSHI	PD	2	25	EDI PALOKA	PD	0
5	ANDON FRROKAJ	PD	2	26	ENDRI HASA	PD	0
6	BARDH SPAHIA	PD	2	27	FATBARDHA KADIU	PD	0
7	DASHAMIR SHEHI	PD	2	28	FLORJON MIMA	PD	0
8	EDMOND SPAHO	PD	2	29	GENC POLLO	PD	0
9	ENKELEJD ALIBEAJ	PD	2	30	GENT STRAZIMIRI	PD	0
10	ERVIN SALIANJI	PD	2	31	GRIDA DUMA	PD	0
11	KLEVIS BALLIU	PD	2	32	HALIM KOSOVA	PD	0
12	LINDITA METALIAJ	PD	2	33	HEKURAN HOXHOLLI	PD	0
13	LUAN BAÇI	PD	2	34	ISUF ÇELAJ	PD	0
14	LUÇIANO BOÇI	PD	2	35	IZMIRA ULQINAKU	PD	0
15	OERD BYLYKBASHI	PD	2	36	LORENC LUKA	PD	0
16	ORJOLA PAMPURI	PD	2	37	NADIRE MEÇORAPAJ	PD	0
17	ROMEO GURAKUQI	PD	2	38	NARD NDOKA	PD	0
18	TRITAN SHEHU	PD	2	39	VALENTINA DUKA	PD	0
19	ALDO BUMÇI	PD	1	40	VANGJEL DULE	PD	0
20	FLAMUR NOKA	PD	1	41	XHEMAL GJUNKSHI	PD	0
21	JORIDA TABAKU	PD	1				

Shënim: Në listë nuk janë përfshirë deputetët që nuk pranuan të dorëzojnë mandatin.

7.8. GRUPI I TË DJATHTËVE: ALIMADHI E PAPA, MË TË SUKSESHMIT

Tek grupi i partive të djathta, grupi më i ri në parlament, nivelin më të lartë të pikëve e kanë dy deputetë, Adriatik Alimadhi dhe Kostaq Papa, i pari kryetar i grupit dhe njëherësh edhe i PBK, i dyti kryetar i Partisë së Emigracionit. Angazhim mbi mesataren e tërësisë së deputetëve kanë pasur edhe kryetarët e partive të tjera të vogla, Zef Shtjefni dhe Selami Jenishehri, ndërkohë që në fund të listës ndodhen deputetët Koçi Tahiri dhe Ramazan Gjuzi, ky i fundit i zgjedhur deputet vetëm më 30 maj, i fundit i deputetëve zëvendësues nga listat proporcionale të PD dhe të LSI.



KLASIFIKIMI GRUPI PARLAMENTAR “PARTITË E DJATHTA” 2019			
<i>NR</i>	<i>EMRI DHE MBIEMRI</i>	<i>GRUPI POLITIK</i>	<i>TOTAL</i>
01	ADRIATIK ALIMADHI	PED	27,8
02	KOSTAQ PAPA	PED	27
03	ZEF SHTJEFNI	PED	24,5
04	SELAMI JENISHEHRI	PED	22
05	ERVIS MEÇO	PED	18
06	KOÇI TAHIRI	PED	12
07	RAMAZAN GJUZI	PED	11

7.9. FJALIMET E LSI: KRYESOJNË KRYEMADHI DHE VASILI

Analiza e numrit të fjalimeve të mbajtura nga deputetët e LSI gjatë seancave të zhvilluara në janar-shkurt 2019, nuk bëjnë dallim nga analiza e përgjithshme e kësaj partie. Figurat kryesore drejtuese, kryetarja Monika Kryemadhi dhe kreu i grupit parlamentar Petrit Vasili janë edhe folësit kryesorë, secili me nga 4 fjalime. Pas tyre janë një politikan me përvojë në parlament si Luan Rama dhe një deputete e përfshirë legjislativë e kaluar në politikë, Kejdi Mehmetaj, secili me nga 3 fjalime.

FJALIMET E DEPUTETËVE TË LSI			
NR	EMRI & MBIEMRI	GRUPI	FJALIME
1	MONIKA KRYEMADHI	LSI	4
2	PETRIT VASILI	LSI	4
3	KEJDI MEHMETAJ	LSI	3
4	LUAN RAMA	LSI	3
5	EDMOND HAXHINASTO	LSI	2
6	EDMOND PANARITI	LSI	2
7	ENDRIT BRAIMLLARI	LSI	2
8	FLOIDA KËRPAÇI	LSI	2
9	KLAJDA GJOSHA	LSI	2
10	NASIP NAÇO	LSI	2
11	SEZAI ROKAJ	LSI	2
12	SILVA CAKA	LSI	2
13	VIKTOR TUSHAJ	LSI	2
14	AGRON ÇELA	LSI	0
15	NORA MALAJ	LSI	0
16	PERPARIM SPAHIU	LSI	0
17	VANGJEL TAVO	LSI	0



Në total 9 deputetë të tjerë të LSI kanë nga 2 fjalime, një tregues i përpjekjes së tyre për t'u aktivizuar maksimalisht në debatet parlamentare dhe në jetën politike të vendit, ndërkohë që katër prej tyre nuk kanë folur gjatë seancave plenare; dy deputetë më aktiv në sesionet e kaluara si Nora Malaj e Përparim Spahia dhe dy deputetë tradicionalisht jo aktiv në jetën parlamentare si Agron Çela dhe Vangjel Tavo.

7.10. PRURJET E REJA, REKORD I VOTËS KONSENSUALE NË KUVEND

Në votimin e ligjeve dhe të akteve të tjera në Kuvend, sesioni parlamentar i vitit 2019 bën dallim të madh nga sesionet e mëparshme, për shkak të përqindjes së lartë të ligjeve të kaluara në mënyrë konsensuale.

VOTIMI I LIGJEVE NË KUVEND: KRAHASIMI 2017-2019					
SESIONI	ME 2/3	ME 3/5	71 VOTA	36 VOTA	ME KONSENSUS
2017 (I)	0	0	7	17	9
2018 (I)	0	0	26	29	8
2018 (II)	0	0	22	36	0
2019 (I)	0	5	18	34	29

Në total, nga 9 ligje konsensuale në katër muajt e vitit 2017 dhe vetëm 8 ligje gjatë gjithë vitit 2018, në gjashtë muajt e vitit 2019 janë votuar 29 ligje konsensuale. Edhe në votimin me shumicë të kualifikuar e të gjithë deputetëve, 84 nga 120 votat e deputetëve, gjatë 2019 u shënuan pesë votime, ndërkohë që gjatë 2017-2018 nuk ka pasur asnjë rast të tillë. Cilësimi “konsensual” nuk do të thotë se ka një klimë të re bashkëpunimi midis mazhorancës dhe opozitës, përkundrazi, thjesht kanë ndryshuar aktorët.

Opozita kryesore parlamentare ka dorëzuar mandatet dhe vendin e saj e kanë zënë deputetë të rinj nga listat proporcionale, pjesa më e madhe e të cilëve, duke qenë edhe refuzues të vendimit politik për dorëzimin e mandateve, kanë vendosur të jenë më luajalë në aktivitetin e tyre të ri parlamentar. Nën presionin e opozitës (PD e LSI) nga jashtë parlamentit dhe nën presionin publik për të pasur zëra ndryshe në parlament, ata kanë zgjedhur të jenë aktivë në debate publike por nga ana tjetër, të votojnë një pjesë të madhe të ligjeve në mbështetje të qëndrimit edhe të mazhorancës. Në kategorinë e ligjeve me votim të thjeshtë (36 vota nga 71 në total), numri i ligjeve të miratuara mbetet

VOTAT NDRYSHE NGA GRUPI?

Janë raste minimale dhe kryesisht janë ish-ministra kritikë me politikën e pasuesve të tyre ose vota personale për çështje të veçanta apo abstenime, siç është:

- rasti i deputetit Fatmir Xhafaj për ndryshimet në ligjin e vetingut në polici;
- rasti i deputetit Ilir Beqaj për ndryshime në ligjin për kujdesin shëndetësor dhe rasti për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit;
- rasti i deputetëve Bashkim Fino e Alket Hyseni për komisionin hetimor për MPJ;
- rasti i deputetit Spartak Braho për një shkarkim ministri dhe ligjin për Kadastrën;
- rasti i deputetit Dashamir Shehi për ligjin për



thuajse i njëjtë me periudhën e vitit 2018, midis 34, 29 dhe 36 ligje, ndërkohë që për votimin me 71, pra të shumicës së votave të të gjithë deputetëve, gjatë 2019 kemi 18 raste votimi, 8 më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

7.11. KRYEMINISTRI VOTOI VETËM 12% TË LIGJEVE TË QEVERISË SË TIJ


Të dhënat e votave për ligjet dhe aktet ligjore në parlament gjatë periudhës janar-gusht, sidomos ato të periudhës kur parlamenti mbeti pa opozitë institucionale, tregojnë se deputetët e mazhorancës në tërësinë e tyre votuan rregullisht në seancat plenare. Vota kolektive u bë e detyrueshme edhe nga nevoja për të pasur kuorum të vazhdueshëm, por edhe për të treguar se parlamenti është funksional dhe legjitim të aktivitetin e tij. Megjithatë në tërësinë e të dhënave për votat në parlament, bën përshtypje vota e kryeministrit.

Konkretisht,

- gjatë muajit janar 2019 kryeministri ka votuar 18 nga 24 aktet e kuvendit, ku pjesa më e madhe janë votimet për shkarkim dhe emërim ministrash në kabinetin qeveritar.
- gjatë muajit shkurt 2019 kryeministri ka votuar vetëm 1 nga 12 aktet e kuvendit, ratifikimin për hyrjen e Maqedonisë së Veriut në NATO.
- gjatë muajit mars 2019 kryeministri ka votuar 4 nga 16 aktet totale.

BERISHA & BASHA: VOTË PËR MAQEDONINË NË NATO

Ish-kryeministri Berisha ka qenë prej kohësh një deputet që nuk merr pjesë në votimin e akteve të Kuvendit. Më 14 shkurt 2019, vetëm disa ditë përpara dorëzimit të mandatit, ish-kryeministri mori pjesë në votimin në bllok të opozitës pro ratifikimit të Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në të njëjtin rast është shënuar edhe vota e vetme e kryetarit të PD Lulzim Basha dhe e kryetares së LSI Monika Kryemadhi në parlament gjatë këtij sesi parlamentar.



- në muajin prill 2019 kryeministri ka votuar vetëm 4 nga 13 aktet e kaluara në parlament, një rezolutë për TVSH, një rezolutë për KMSHC, ligjin mbi policinë gjyqësore dhe vendimin për komisionin e reformës zgjedhore.
- në muajin maj 2019 kryeministri nuk ka votuar asnjë prej 19 akteve të kaluara në parlament.
- gjatë muajit qershor kryeministri ka votuar vetëm 1 nga 19 akte në parlament, rezolutën për Presidentin.
- gjatë muajit korrik 2019 kryeministri ka votuar vetëm 2 nga 20 aktet e Kuvendit, konkretisht komisionin hetimor për Presidentin dhe vendimin për raportin e Komisionit të Ligjeve për Presidentin.

Në total, duke hequr dekretet për ministrat, rezulton se kryeministri votoi vetëm 12 nga 99 akte të Kuvendit, pra 12% të të gjitha akteve të miratuara nga mazhoranca e drejtuar prej tij.

7.12. SIPAS MUAJVE: DEPUTETËT QË NUK VOTUAN ASNJË AKT PARLAMENTI

Në praktikat parlamentare votimi i akteve në parlament tregon se çfarë përfaqëson një deputet, cili është identiteti i tij politik dhe mbi të gjitha, cili është pozicioni i tij ndaj çështjeve që diskutohen dhe problematikave që trajtohen nga vendimmarrja politike.

Në parlamentet bashkëkohore çdo deputeti i numërohen çështjet për të cilat ka votuar pro apo kundër, për të krijuar profilin e tij politik. Në rastin tonë është gati e pamundur të ndodh ky rankim cilësor i deputetëve. Kjo për arsye se ka deputetë, si Lefter Koka (ish LSI), i cili nuk ka votuar asnjë akt parlamenti dhe nuk merr pjesë rregullisht në seancat plenare të këtij sesiioni apo të sesioneve të mëparshme. Gjithashtu ka deputetë që nuk kanë marrë pjesë në votime për muaj të tërë, kryesisht për shkaqe personale apo si qëndrime politike.

Të dhënat nominale janë si më poshtë: në janar 2019 shumica absolute

deputetëve të opozitës nuk votuan asnjë prej 16 akteve në Kuvend,

në shkurt 2019 deputetët që nuk votuan asnjë akt parlamentar

janë Vangjel Dule (PBDNJ), Kejdi Mehmetaj, Lefter Koka e

Agron Çela (LSI), Nard Ndoka (PDK) dhe Vangjel Tavo (LSI).

Në mars 2019 nuk kanë votuar asnjë akt deputetët Lefter

Koka (ish LSI) dhe Rudina Hajdari (ish PD), si ndonjë nga

deputetët e rinj të pranuar në seancën e fundit të muajit.

Në prill 2019 nga deputetët e “vjetër” Lefter Koka (ish-LSI)

vijoi të mos votojë asnjë akt të Kuvendit, gjithashtu figurojnë

jovotues edhe disa nga deputetët e rinj, si Elda Hoti, Alban

Zeneli, Amra Barova, Adriatik Alimadhi. Në maj 2019 nuk morën

pjesë në asnjë votim të akteve të parlamentit Famir Velaj (PS), Lefter Koka

(ish-LSI)

dhe deputeti i ri Erion Piciri. Në qershor 2019 gjithashtu figurojnë me 0 vota në aktet parlamentare

Fatmir Velaj (PS), Lefter Koka (ish- LSI), si dhe deputetët e ardhur të rinj Amra Barova, Suzana Topi, Erion

Piciri dhe Vasil Sterjovski. Në korrik 2019 gjithashtu nuk janë votues të asnjë akti parlamentar deputetët

Fatmir Velaj (PS), Lefter Koka (ish -LSI) dhe Erion Piciri e Amra Barova nga deputetët e rinj.

Vlen të theksohet se në seancën e 31 janarit opozita dërgoi disa deputetë në parlament në funksion të nismës së saj për komisionin hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore në pajisjen e Z.Gent Cakaj me “certifikatë të

ME 0 VOTA NË KUVEND?

Ka deputetë, si Lefter Koka (ish LSI), i cili nuk ka votuar asnjë akt parlamenti dhe nuk merr pjesë rregullisht në seancat plenare të këtij sesiioni apo të sesioneve të mëparshme.



sigurisë” dhe zbatimimi i ligjit për administrimin dhe përpunimin e informacioneve pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument në cilësinë e tij si zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, apo detyra të tjera shtetërore”. Deputetët që morën pjesë dhe votuan janë Enkelejd Alibeaj, Xhemal Gjunksi, Indrit Braimllari dhe Ervin Salianni.

7.13. QEVERIA: REKORD FJALIMESH SPIROPALI E GJONAJ

Të dhënat e aktivitetit parlamentar janar-gusht 2019 tregojnë se ministrat më aktivë në debatet parlamentare kanë qenë Elisa Spiropali dhe Etilda Gjonaj, secila me nga 11 fjalime. Në rastin e zonjës Spiropali kemi të bëjmë me Ministre përgjegjëse për raportet me Parlamentin dhe zëdhënëse të Qeverisë, ndaj angazhimi i saj në parlament është sa zgjedhje personale aq edhe detyre zyrtare e partiake, kurse në rastin e Ministres së Drejtësisë kemi të bëjmë më shumë me synimin e saj personal për t’u angazhuar në politikën qendrore sesa me një përgjegjësi për shkak të postit. Për shembull, edhe krye-tema e viteve të fundit, reforma në drejtësi, nuk i njeh kompetenca të theksuara Ministrisë së Drejtësisë dhe jetësimi i saj cilësor apo sasior gjithashtu nuk është përgjegjësi dhe as bilanc i vetë kësaj ministrie. Megjithatë, Etilda Gjonaj e ka përdorur në maksimum rastin e reformës në drejtësi për sukses në ligjërimin e saj politik në parlament.

Ministrat Sander Lleshaj dhe Belinda Balluku gjithashtu kanë pasur nga 9 fjalime në parlament, një shifër relativisht e pritshme për një parlament me 24 seanca plenare, por angazhimi i tyre është lidhur edhe me interpelancat e kërkuara nga deputetë të ndryshëm në drejtim të fushave të përgjegjëseve të tyre. Kryetemat për

ministrin Sander Lleshaj kanë qenë incidentet politike me opozitën dhe rastet e krimit të organizuar apo trafikut, kurse për rastin e ministres Belinda Balluku kryetemat vijojnë të jenë praktikatat e kontestuara të Partneritetit Publik – Privat dhe projektet e infrastrukturës.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ka gjithashtu një nivel të lartë angazhimi në debatet në parlament, duke qenë në kuotë të njëjtë me ministren e Financave Anila Denaj. Në praktikatat e mëparshme financa ka pasur shumë më tepër angazhime dhe debate sesa mbrojtja, ndaj ky rezultat lidhet më shumë me tre elementë specifikë; fakti se Anila Denaj ka mungesë të eksperiencës politike dhe ndaj edhe i shmanget protagonizmit politik, fakti se në axhendë ka pasur disa vendime specifike që lidhen me fushën e mbrojtjes, dhe fakti se Olta Xhaçka ka pozita të larta drejtuese në PS dhe për pasojë, është një figurë politike në konkurrim “me të vetët” në qeveri dhe në parti.

NUMRI I FJALIMEVE TË MINISTRAVE JANAR-GUSHT 2019

NR	KABINETI QEVERITAR	FJALIME
1	EDI RAMA	14
2	ELISA SPIROPALI	11
3	ETILDA GJONAJ	11
4	SANDER LLESHAJ	9
5	BELINDA BALLUKU	9
6	OLTA XHAÇKA	7
7	ANILA DENAJ	7
8	OGERTA MANASTIRLIU	5
9	BLEDI ÇUÇI	5
10	BESA SHAHINI	5
11	BLENDI KLOSI	4
12	ERION BRAÇE	4
13	ELVA MARGARITI	3
14	PANDELI MAJKO	2
15	EDUARD SHALSI	2



Ministrat më me pak fjalime dhe angazhime parlamentare janë Pandeli Majko dhe Eduard Shalsi, dy politikanë karriere, por njëherësh dy ministri simbolike në kabinetin qeveritar. Arsyet e këtij bilanci janë të dyfishta dhe lidhen sa me preferencat personale për të luajtur rol protagonizmit në një mjedis ku mungon opozita reale konkurruese, aq edhe nga fakti se ata kanë preferuar më shumë të investohen për të kaluar nismat ligjore të sektorëve të tyre në Kuvend sesa të investohen në ligjërimit politik të ditës.

7.14. MINISTRAT MË EFEKTIVË NË RAPORT ME AKTET LIGJORE

Në aktivitetin e një ministri nuk janë tregues efektiviteti fjalimet në parlament dhe as numri i konferencave të shtypit, i intervistave apo i botimeve speciale që prodhojnë pa fund institucionet që ata drejtojnë. Ka disa tregues të tjerë shumë më cilësorë, dhe një prej tyre është edhe përgjegjësia e ministrave për të respektuar matricën e ligjeve të institucionit të tyre në raport me Këshillin e Ministrave dhe me Kuvendin. Të gjitha ministratë paraqesin propozimet për angazhimet e tyre vjetore, të cilat më pas kalojnë për miratim në Këshillin e Ministrave duke u shndërruar në dokument zyrtar referues. Dokumenti quhet “Programi i Përgjithshëm Analitik i Projekt-akteve për vitin 2019” dhe botohet edhe në Fletoren Zyrtare.

Duke analizuar këtë dokument, në angazhimet që lidhen vetëm për katërmujorin e parë (janar-prill 2019), pasi katërmujori i dytë përfundon në ditët që ky raport është duke u shkruar, mund të bëhet edhe një vlerësim më i saktë i nivelit të efektivitetit të ministrave në ushtrim të detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

Siç rezulton edhe nga tabela, një pjesë e akteve janë realizuar (50% e tyre kanë kaluar në Këshillin e Ministrave, por nuk kanë kaluar ende në parlament), ndërkohë që ka ministri, si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, etj, që nuk kanë arritur ende të kalojnë aktet e tyre në Këshillin e Ministrave dhe për pasojë, as të jenë në axhendën parlamentare.

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2019	MINISTRI PËRGJEGJËS	BILANCI 4 MUJOR
<i>Projektligj "Për shtetësinë"</i>	MPB	I realizuar
<i>Projektligj "Për Shërbimin e Provës"</i>	MPB	I realizuar
<i>Projektligj "Për funksionimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve"</i>	MD	I pa realizuar
<i>Projektligj - Për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare</i>	MEPJ	I realizuar
<i>Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"</i>	MFE	I realizuar
<i>Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", i ndryshuar</i>	MFE	I realizuar
<i>Projektligj" për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 7703, date 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë</i>	MFE	I pa realizuar
<i>Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në lgjin nr. 9636 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar</i>	MSHMS	I realizuar
<i>Projektligj "Për produktet plehëruese"</i>	MBZHR	I pa realizuar



<i>Projektligj "Për mbrojtjen civile"</i>	MM	I realizuar
<i>Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit"</i>	MM	I realizuar
<i>Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352 datë 18.11.2010 "Për artin dhe Kulturën"</i>	MK	I pa realizuar
<i>Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616 datë 27.09.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë"</i>	MK	I pa realizuar
<i>Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar</i>	MIE	Pjesërisht
<i>Projektligj "Për Rininë"</i>	MASR	Pjesërisht
<i>"Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar</i>	MTM	I realizuar
<i>Projektligj "Për ndryshimet klimatike"</i>	MTM	I pa realizuar
<i>Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar</i>	MTM	I pa realizuar



8. SHTOJCA ME TË DHËNA TË DETAJUARA

8.1. TABELA ME RENDITJEN E PLOTË DHE TË DETAJUAR MBI KLASIFIKIMIN E EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE NË SESIONIN PARLAMENTAR 2019

Të dhënat e tabelës përmbledhin kontributin e të gjithë deputetëve aktualë në parlament, (gusht 2019) mbi bazën e kriterëve të klasifikimit dhe efektivitetit. Treguesit janë nxjerrë nga kontributi i tyre në parlament dhe në aktivitetin parlamentar. Përlllogaritja e pikëve është bërë mbi bazën e përqindjes. Për deputetët e rinj është zbatuar përlllogaritja vetëm nga momenti kur ata janë bërë deputetë.

RENDITJA ME TREGUESIT E DETAJUAR TË EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE 2019											
NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	NISME LIGJORË	AMEN -DIM	PR+DISK KOMIS.	PR+DISK SEANCË	KËRKESË INFORM	INTER- PELANCË	VOTIM LIGJEVE	PUBLIK ZONË	TOTAL 100
1	TAULANT BALLA	PS	5	5	16	19	10	0	10	9	74
2	VASILIKA HYSI	PS	5	10	18	10	10	0	10	9	72
3	MYSLIM MURRIZI	DEM	5	10	10,6	15	0	5	9	9	63,6
4	ILIR BEQAJ	PS	10	10	15,1	10	0	0	10	7	62,1
5	RUDINA HAJDARI	DEM	5	10	15	11	0	5	9	7	62
6	ERMONELA FELAJ	PS	5	4	16	8	10	0	10	9	62
7	ARBEN AHMETAJ	PS	7	10	16,8	9	0	0	10	8	60,8
8	ANTONETA DHIMA	PS	0	2	14,4	14	10	0	10	8	58,4
9	EGLANTINA GJERMENI	PS	5	5	14,6	5	10	0	10	7	56,6
10	BLERINA GJYLAMETI	PS	5	7	12,2	10	0	0	10	9	53,2
11	ULSI MANJA	PS	5	7	18,8	7	0	0	10	5	52,8
12	ERVIN BUSHATI	PS	5	6	12,2	11	0	0	9	9	52,2
13	BESNIK BARAJ	PS	5	8	14,7	8	0	0	8	8	51,7
14	BASHKIM FINO	PS	5	10	17,6	3	0	0	10	6	51,6
15	ALKET HYSENI	PS	5	5	15,4	8	0	0	10	7	50,4
16	EVIS KUSHI	PS	5	5	12,2	11	0	0	10	7	50,2
17	ELONA GJEBREA	PS	5	2	13,6	10	0	0	10	8	48,6
18	RALF GJONI	PAV	0	7	15	8	0	5	8	5	48
19	KLOTILDA BUSHKA	PS	5	2	13	12	0	0	9	7	48
20	VULLNET SINAJ	PS	0	8	15,7	6	0	0	10	8	47,7
21	LEFTER MALIQI	PA GRUP	0	2	12	8	0	10	10	5	47
22	NIKO PELESHI	PS	0	7	17,9	3	0	0	10	9	46,9
23	SENIDA MESI	PS	5	5	10,8	8	0	0	9	7	44,8
24	ADNOR SHAMETI	PS	5	5	15,8	1	0	0	10	7	43,8
25	ISMET BEQIRAJ	PS	5	5	16	4	0	0	8	5	43



26	ELENA XHINA	PA GRUP	5	5	15,4	2	0	0	9	5	41,4
27	KLODIANA SPAHIU	PS	5	5	9,3	5	0	0	10	6	40,3
28	ADELINA RISTA	PS	0	5	12,8	5	0	0	10	7	39,8
29	FADIL NASUFI	PS	5	0	14,4	3	0	0	10	6	38,4
30	MILVA EKONOMI	PS	0	0	17,2	7	0	0	9	5	38,2
31	SPARTAK BRAHO	PS	5	5	11,2	2	0	0	10	4	37,2
32	ARTUR ROSHI	PA GRUP	0	0	10,5	7	0	10	7	2	36,5
33	PJERIN NDREU	PS	0	2	12	0	0	10	5	7	36
34	DITMIR BUSHATI	PS	0	0	16,8	3	0	0	8	8	35,8
35	EDMOND LEKA	PS	5	0	9,7	5	0	0	10	6	35,7
36	VILMA BELLO	PS	5	0	10,5	3	0	0	10	7	35,5
37	DAMIAN GJIKNURI	PS	5	0	12,5	4	0	0	7	7	35,5
38	SADI VORPSI	PS	0	0	13,6	6	0	0	9	6	34,6
39	ALMIRA XHEMBULLA	PS	0	5	9,6	5	0	0	10	5	34,6
40	VASIL STERJOVSKI	PA GRUP	0	0	11	5	0	5	8	5	34
41	ARBEN PELLUMBI	PS	0	0	13,4	5	0	0	10	5	33,4
42	MIMI KODHELI	PS	5	0	9,9	4	0	0	9	5	32,9
43	LINDITA NIKOLLA	PS	0	0	9,9	6	0	0	10	7	32,9
44	ANDI PERMETI	PA GRUP	0	0	6,8	8	0	5	8	5	32,8
45	ANDREA MARTO	PS	5	0	12,3	0	0	0	10	5	32,3
46	FATMIR VELAJ	PS	5	5	9	2	0	0	6	5	32
47	BUJAR ÇELA	PS	0	0	11,2	4	0	0	10	6	31,2
48	ANASTAS ANGJELI	PS	5	0	10,1	1	0	0	8	7	31,1
49	XHEMAL QEFALIA	PS	0	0	9,5	5	0	0	9	7	30,5
50	MUSA ULQINI	PS	0	0	10,2	3	0	0	10	7	30,2
51	LIGORAQ KARAMELO	PA GRUP	0	0	11	5	0	0	9	5	30
52	ILIR NDRAXHI	PS	0	0	15	0	0	0	10	5	30
53	FATJONA DHIMITRI	DEM	0	0	18	3	0	0	7	2	30
54	ROBERT BITRI	PS	0	0	12,6	2	0	0	10	5	29,6
55	DRITAN BICI	PS	0	0	13,6	1	0	0	10	5	29,6
56	ENVER ROSHI	PAV	0	0	12,5	8	0	0	7	2	29,5
57	EDLIRA BODE	PS	0	0	11,2	3	0	0	9	6	29,2
58	TATJANA PIRO	PS	0	0	9,1	5	0	0	10	5	29,1
59	KUJTIM GJUZI	PA GRUP	0	0	8	8	0	0	9	4	29
60	RAKIP SULI	PS	0	0	10	0	0	10	2	7	29
61	AURORA MARA	PAV	5	0	13	2	0	0	7	2	29
62	ANDUEL XHINDI	PS	0	0	14	0	0	0	10	5	29
63	FIDEL YLLI	PS	0	0	13,8	1	0	0	9	5	28,8



64	KORAB LITA	DEM	0	0	6,4	10	0	0	8	4	28,4
65	EDIOLA BRAHA	PAV	5	0	4,4	2	0	5	10	2	28,4
66	EDLIRA HYSENI	PAV	0	0	7,1	4	0	5	8	4	28,1
70	NIMET MUSAJ	PAV	0	0	9	7	0	5	8	3	32
71	XHAVIT BUSHAJ	PS	0	0	10,9	1	0	0	10	6	27,9
72	ADRIATIK ALIMADHI	PED	0	0	17,8	0	0	0	5	5	27,8
73	KOSTAQ PAPA	PED	0	0	13	3	0	0	9	2	27
74	JURGIS CYRBJA	PS	5	0	5	2	0	0	10	5	27
77	ALBAN ZENELI	DEM	0	0	12	0	0	5	5	5	27
78	ARDIANA JAKU	PS	0	0	7	2	0	0	10	7	26
79	FATMIR XHAFAJ	PS	0	0	7,1	3	0	0	9	6	25,1
80	ILIR XHAKOLLI	PS	0	0	8	0	0	10	1	6	25
81	HALIT VALTERI	DEM	0	0	7	8	0	0	8	2	25
82	LUAN DUZHA	PS	0	0	9,8	1	0	0	10	4	24,8
83	ILIRIAN PENDAVINJI	PS	0	0	7,7	2	0	0	10	5	24,7
84	ZEF SHTJEFNI	PED	0	0	10,5	5	0	0	7	2	24,5
85	ARBEN ELEZI	DEM	0	0	7,2	2	0	5	8	2	24,2
86	HALIL JAKIMI	DEM	0	0	5	6	0	5	7	2	25
87	YLLI SHEHU	PAV	0	0	6	0	0	5	5	2	18
88	NURI BELBA	PS	0	0	8	0	0	9	0	6	23
89	SELAMI JENISHEHRI	PED	0	0	9	3	0	0	8	2	22
90	FLAMUR GOLEMI	PS	0	0	5	0	0	9	2	6	22
91	ROLAND XHELILAJ	PS	0	1	3,1	2	0	0	10	5	21,1
92	LUAN HARUSHA	PS	0	0	8	1	0	0	7	5	21
93	ELIO HYSKO	PS	0	0	9	0	0	0	8	4	21
94	PAULIN STERKAJ	PS	0	0	7,9	0	0	0	8	5	20,9
95	MIRELA KUMBARO	PS	0	0	4	1	0	0	10	5	20
96	ARDIT KONOMI	PS	0	0	7	0	0	0	9	4	20
97	ARBEN KAMAMI	PS	0	0	6	1	0	0	9	4	20
98	ARTEMIS DRALO	PS	0	0	6,1	0	0	0	8	5	19,1
99	KRENAR RRYCI	PA GRUP	0	0	7	1	0	0	9	2	19
100	EUGEN BOJAXHI	PA GRUP	0	0	4	0	0	5	8	2	19
101	BESNIK TROPLINI	PA GRUP	0	0	5,1	2	0	0	9	2	18,1
102	NIKOLIN STAKA	PA GRUP	0	0	7	0	0	0	9	2	18
103	MAJLINDA HALILAJ	PA GRUP	0	0	6	1	0	0	9	2	18
104	ERVIS MEÇO	PED	0	0	4	3	0	0	9	2	18
105	ELDA HOTI	PA GRUP	0	0	5,7	4	0	0	6	2	17,7
106	SADRI ABAZI	PS	0	0	6,3	1	0	0	6	4	17,3



107	RRAHMAN RRAJA	PS	0	0	8	0	0	0	7	2	17
108	REME LALA	PA GRUP	0	0	7	1	0	0	7	2	17
109	GJETAN GJETANI	PA GRUP	0	0	7	0	0	0	6	4	17
110	SUZANA TOPI	PA GRUP	0	0	3	2	0	0	8	3	16
111	FLORENC SPAHO	PS	0	0	4	1	0	0	9	2	16
112	KLAJDI QAMA	PA GRUP	0	0	3	1	0	0	9	2	15
113	ARLIND ÇAÇANI	DEM	0	0	4	2	0	0	7	2	15
114	EDMOND STOJKU	PA GRUP	0	0	3	0	0	0	9	2	14
115	EDMOND RRUSHI	PA GRUP	0	0	3	0	0	0	9	2	14
116	TOM DOSHI	PA GRUP	0	0	0	0	0	0	8	5	13
117	KOÇI TAHIRI	PED	0	0	3	0	0	0	7	2	12
118	RAMAZAN GJUZI	PED	0	0	0	0	0	0	9	2	11
119	LEFTER KOKA	PA GRUP	0	0	0	0	0	5	2	4	11
120	ERION PICIRI	PA GRUP	0	0	4	2	0	0	2	2	10
121	AMRA BAROVA	PAV	0	0	3	0	0	0	1	2	6
122	ENADA KAPLLANI	PAV	0	0	1	0	0	0	2	2	5



8.2. TABELA ME RENDITJEN E PLOTË DHE TË DETAJUAR MBI KLASIFIKIMIN E EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE TË OPOZITËS QË DORËZUAN MANDATET NË SHKURT 2019

Lista përfshin deputetët e opozitës që dorëzuan mandatet në fillim të sesionit parlamentar dhe jashtë saj është lënë vetëm kryetari i PD Lulzim Basha, si dhe tre deputetët që nuk pranuan të dorëzojnë mandatet, duke vijuar aktivitetin parlamentar.

RENDITJA E DEPUTETËVE QË DORËZUAN MANDATET ME TREGUESIT E DETAJUAR TË EFIKASITETIT

NR	EMRI DHE MBIEMRI	GRUPI POLITIK	NISME LIGJORE	AMEN-DIM	PR+DISK KOMIS.	PR+DISK SEANCË	KËRKESË INFORM	INTER-PELANCË	VOTIM LIGJEVE	PUBLIK ZONË	TOTAL 100
1	ALBANA VOKSHI	PD	5	5	4	2	10	0	1	9	36
-	JORIDA TABAKU	PD	0	5	5	3	10	0	4	9	36
3	PETRIT VASILI	LSI	0	5	3	9	0	10	0	5	32
4	ENDRIT BRAIMLLARI	LSI	5	0	3	6	5	0	0	7	26
5	KEJDI MEHMETAJ	LSI	5	0	3	9	0	0	0	8	25
6	ERVIN SALIANJI	PD	0	0	4	2	5	0	4	8	23
-	GRIDA DUMA	PD	0	0	3	0	10	0	3	7	23
8	FLOIDA KERPACI	LSI	5	0	3	6	0	0	0	7	21
9	ENKELEJD ALIBEAJ	PD	0	4	3	2	0	0	4	7	20
-	EDMOND SPAHO	PD	1	0	3	2	0	0	4	9	19
-	ENDRI HASA	PD	0	0	3	0	5	0	4	7	19
12	MONIKA KRYEMADHI	LSI	0	0	0	10	0	0	0	8	18
13	KLEVIS BALLIU	PD	0	0	3	2	5	0	3	5	18
14	ROMEO GURAKUQI	PD	0	0	4	2	0	0	4	7	17
15	KLAJDA GJOSHA	LSI	5	0	0	6	0	0	0	5	16
-	SILVA CAKA	LSI	5	0	0	6	0	0	0	5	16
-	BARDH SPAHIA	PD	0	0	3	2	0	0	4	7	16
-	DHURATA ÇUPI	PD	0	0	4	0	0	0	4	8	16
-	OERD BYLYKBASHI	PD	0	0	4	2	0	0	3	7	16
-	XHEMAL GJUNKSHI	PD	0	0	3	0	5	0	1	7	16
21	LUAN RAMA	LSI	0	0	0	9	0	0	0	6	15
-	NORA MALAJ	LSI	5	0	0	0	5	0	0	5	15
-	EDMOND PANARITI	LSI	0	0	4	6	0	0	0	5	15
-	LINDITA METALIAJ	PD	0	0	3	2	0	0	4	6	15



25	EDMOND HAXHINASTO	LSI	0	0	3	6	0	0	0	5	14
-	ANDON FRROKAJ	PD	0	0	3	2	0	0	4	5	14
-	LUÇIANO BOÇI	PD	0	0	3	2	0	0	3	6	14
-	TRITAN SHEHU	PD	0	0	4	2	0	0	1	7	14
29	NASIP NAÇO	LSI	0	0	0	6	0	0	0	7	13
-	DASHAMIR SHEHI	PD	0	0	4	2	0	0	3	4	13
-	ORJOLA PAMPURI	PD	0	0	3	2	0	0	3	5	13
-	VALENTINA DUKA	PD	0	0	4	0	0	0	4	5	13
33	FATMIR MEDIU	PD	0	0	3	3	0	0	1	5	12
-	HEKURAN HOXHOLLI	PD	0	0	3	0	0	0	4	5	12
35	LORENC LUKA	PD	0	0	3	0	0	0	4	5	12
-	SEZAI ROKAJ	LSI	0	0	0	6	0	0	0	5	11
-	VIKTOR TUSHAJ	LSI	0	0	0	6	0	0	0	5	11
-	ALDO BUMCI	PD	1	0	3	1	0	0	1	5	11
-	FATBARDHA KADIU	PD	0	0	3	0	0	0	1	7	11
-	FLORJON MIMA	PD	0	0	3	0	0	0	3	5	11
-	LUAN BAÇI	PD	0	0	3	2	0	0	1	5	11
42	AGRON SHEHAJ	PD	0	0	4	0	0	0	1	5	10
-	FLAMUR NOKA	PD	0	0	3	1	0	0	1	5	10
-	ISUF ÇELAJ	PD	0	0	3	0	0	0	1	6	10
-	IZMIRA ULQINAKU	PD	0	0	3	0	0	0	1	6	10
-	NADIRE MEÇORAPAJ	PD	0	0	3	0	0	0	1	6	10
-	SALI BERISHA	PD	0	0	0	3	0	0	3	4	10
48	ASTRIT VELIAJ	PD	0	0	3	0	0	0	1	5	9
-	GENC POLLO	PD	0	0	3	0	0	0	1	5	9
-	GENT STRAZIMIRI	PD	0	0	3	0	0	0	1	5	9
-	HALIM KOSOVA	PD	0	0	3	0	0	0	1	5	9
-	VANGJEL DULE	PD	0	0	2	0	0	0	0	7	9
53	PERPARIM SPAHIU	LSI	0	0	2	0	0	0	0	6	8
54	NARD NDOKA	PD	0	0	3	0	0	0	0	4	7
55	AGRON ÇELA	LSI	0	0	0	0	0	0	0	5	5
-	VANGJEL TAVO	LSI	0	0	0	0	0	0	0	5	5
57	EDI PALOKA*	PD	0	0	3	0	0	0	1	5	4

* I penalizuar me minus 5 pikë për shkak të masës disiplinore nga Kuvendi



MBI INSTITUTIN E STUDIMEVE POLITIKE

Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e demokratizimit dhe shtetit të së drejtës. Drejtor Ekzekutiv aktual është Prof. Afrim Krasniqi.

ISP është e fokusuar në monitorimin e institucioneve demokratike, si dhe në analiza profesionale mbi problematika specifike politike me progresin dhe zhvillimet politike në Shqipëri. Pjesë e ISP janë ekspertë të njohur të zhvillimeve politike, të drejtësisë dhe të marrëdhënieve publike. ISP publikon vazhdimisht raporte monitoruese dhe analiza politike mbi zhvillimet kryesore në vend.

DISA NGA PROJEKTET KRYESORE TË REALIZUARA & NË PROCES NGA ISP

- Database www.deputetim.al mbi monitorimin e Kuvendit të RSH (2017-2020)
 - Database dhe monitorimin e ligjit të dekriminalizimit (2016-2021)
 - Monitorim e institucioneve të sistemit të drejtësisë (nga 2019 dhe në vijim)
 - Monitorimin e ligjërimit politik e publik mbi reformën në drejtësi (2018 dhe në vijim)
 - Monitorimin e konfliktit të interesit në aktivitetin parlamentar (2019 -2020)
 - Monitorimin e progresit të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian (2017 dhe në vijim)
 - Monitorimi i qeverisje vendore, bashkitë e qarkut Tiranë (2018-2019)
 - Database online www.muzeuimemories.info Shqipëria në periudhën komuniste
 - Monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike (nga 2015).
 - Monitorimin e reformës zgjedhore dhe komentar (broshurë) mbi ligjin “Mbi partitë politike”
 - Monitorimi i përfaqësimit të grave në partitë politike (2017) dhe në zgjedhjet lokale 2015
 - Monitorim të Kuvendeve Kombëtare të partive kryesore. Anketime dhe raporte mbi gjetjet
 - Monitorimin e ligjit mbi të drejtën e informimit (nga 2014 dhe në vijim)
- ❖ Raporti do t’u shpërndahet në rrugë elektronike dhe të printuar të gjithë deputetëve në parlament, partive politike parlamentare, partnerëve të ISP, ekspertëve të angazhuar, si dhe mediave kryesore.
 - ❖ Të gjitha publikimet e ISP që lidhen me projekte kombëtare e ndërkombëtare (libra, studime, policy paper, raporte, etj) jepen falas për çdo të interesuar, si dhe publikohen në faqen zyrtare të ISP në formë të përmbledhur)
 - ❖ Për çdo interes, sugjerim apo informacion, mund të kontaktoni në çdo kohë ISP përmes adresës zyrtare, emailit, faqes së internetit, adresave të ISP në rrjetet sociale, etj.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Krasniqi, Afrim

Parlamenti në kohën e krizës : monitorimi i Kuvendit :
janar-gusht 2019 / drejtor projekti Afrim Krasniqi.

- Tiranë : Instituti i Studimeve Politike, 2019

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-4418-8-1

1.Parlamenti shqiptar 2.Monitorime
3.Raporte 4.Shqipëri

328(496.5) “2019”(047)



